

KOLAPSI NË KOSOVË

22 prill 2004



Raporti i ICG-së për Evropë, N° 155
Prishtinë/Beograd/Bruks

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIMET	i
I. HYRJE.....	1
II. PËRPLASJA E VIZIONEVE PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS	2
A. POLITIKA E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE	2
B. QËNDRIMET E BEOGRADIT	3
III. FËRKIMET NË RRITJE	5
A. PRIVATIZIMI.....	6
B. STRUKTURAT PARALELE	7
C. TRASHËGIMIA POLITIKE E LUFTËS	8
IV. PARALAJMËRIMI I DHUNËS	10
A. DHUNA DHE SIGURIA.....	11
B. FITILI NDEZET	14
V. DHUNË SPONTANE APO E ORGANIZUAR?	15
VI. SISTEMI I SIGURISË BUZË KOLAPSIT	19
VII. REAGIMET	25
A. SHQIPTARËT E KOSOVËS	26
B. NDËRKOMBËTARËT.....	29
C. NË TERREN	32
VIII.SHOQËRIA E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS - NEVOJA PËR RENOVIM .	33
IX. RIFORMËSIMI I PRANISË NDËRKOMBËTARE.....	38
A. NEVOJA PËR ANGAZHIM NDËRKOMBËTAR NË EKONOMI	38
B. STRUKTURAT PARALELE	41
C. KOORDINIMI NË FUSHËN E SIGURISË	42
X. RRUGA PËRPARA.....	44
SHTOJCAT	
A. KRONOLOGJI E DHUNËS: 17-19 MARS, 2004.....	46
B. HARTA E KOSOVËS	55

KOLAPSI NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIMET

Më 17 mars, 2004, themelet jostabile të një progresi gradual të arritur për katër vite e gjysmë u shkatërruan. Brenda disa orëve provincën e kishte përshkruar një rebelim anti-serb dhe anti-OKB që pati për pasojë shpërthimin e një dhune të paparë që nga viti 1999. Më 18 mars dhuna eskaloi në një pastrim etnik kundër lagjeve dhe fshatrave të tëra ku jetojnë minoritetet. Turmat e të rinjëve, ekstremistëve dhe kriminelëve shqiptarë paraqitën misionet siç janë ai i OKB-së në Kosovë (UNMIK-un) dhe forcës paqëruajtëse të NATO-së (KFOR-in) si shumë të dobëta. Institucionet e përkohëshme vetqeverisëse të Kosovës (IPVQ), mediat dhe shoqëria civile u dhanë rebeluesve leje për vazhdimin e trazirave deri në sakatosje. Bashkësisë ndërkombëtare i nevojitet urgjentisht vënja e linjave të reja të veprimit (ndryshimi i politikës) -- lidhur me statusin final dhe zhvillimin socio-ekonomik, përndryshe destabilizimi i Kosovës do të mund të përfshinte tërë rajonin.

Një tërbim i tillë pati për pasojë vdekjen e nëntëmbëdhjetë personave, gati 900 të plagosurve, shkatërrimin e më shumë se 700 shtëpive të serbëve, ashkalinjve dhe romëve, dëmtimin apo shkatërrimin e afërsisht 10 ndërtesave publike, 30 kishave serbe dhe 2 manastireve si dhe la afërsisht 4.500 persona të zhvendosur. Trazirat ishin më shumë spontane sesa të organizuara, në të cilat përfituan ekstremistët dhe grupet kriminele, sidomos në ditën e dytë. Ndjenja e dështimit dhe frikës përballë qëllimeve të bashkësisë ndërkombëtare rreth Kosovës, pa-aftësia e UNMIK-ut për të filluar zhvillimin e ekonomisë si dhe suspendimi i procesit të privatizimit, sukcesi i Beogradit gjatë muajve të fundit në tendosjen e nervave të shqiptarëve, të gjitha këto akumuluan një tension i cili u shëndërrua në një forcë eksplozive që pati për pasojë incidentet fillestare të 16 marsit.

Implikimet për sigurinë rajonale janë serioze dhe gjithëpërfshirëse. KFOR-i dhe NATO-ja kanë humbur aurën e të qenur të pacënueshëm dhe të

paaritshëm. Bindja se bashkësia ndërkombëtare është e dobët dhe nuk është e gatshme që të veprojë nuk do të fshihet nga mendjet e ekstremistëve nacionalistë në Kosovë dhe gjëkund, përfshirë këtu edhe nacionalistët e ringjitur në skenë në Beograd. Nëse shkaqet e dhunës nuk preken mënjëherë dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë -- nëpërmjet të masave politike, zhvillimore dhe të sigurisë -- Kosova rrezikon të bëhet Bregu Perëndimor i Evropës.

Shpërthimi i dhunës ka zbuluar se shoqëria e shqiptarëve të Kosovës është thellë e tronditur, se i mungojnë institucionet, liderhipi dhe kultura për të absorbuar tronditjet dhe të përmbajë pakicën e vet të dhunshme, kriminele. Në gjendjen e tanishme, kjo shoqëri do të vazhdojë që të dëbojë minoritetet e në fund do ta konsumojë edhe shtresën e hollë të intelegjencisë së saj liberale. Rinia e saj numerikisht e madhe kërcënon të «shkelë» institucionet e brishta të gjeneratave më të vjetra. Që nga viti 1999, migrimi i popullatës nga fshatrat e pazhvilluara ka përmbytur kryeqytetin dhe elementët e modernizuar të shoqërisë. UNMIK-u nuk ka arritur as për së afërmi të bëjë përmirësimin e të metave zhvillimore në Kosovë, veçanërisht në fushën e arsimit.

Struktura e UNMIK-ut dhe mandati i tij janë treguar të papërshtatshëm për të përgatitur Kosovën për tranzicion nga lufta në paqë, nga socializmi në ekonominë e tregut si dhe nga gjendja e paefinuar politike ndërkombëtare drejt statusit përfundimtar. Bashkësia ndërkombëtare e ka mashtruar veten kur ka besuar se premtimet gjysmake të nëntorit të vitit 2003 - se do të fillojë me shqyrtimin e statusit përfundimtar të Kosovës nga gjysma e vitit 2005 - paraqesin një politikë të kompletuar. Duke mos qenë në gjendje që të dakordohen rreth asaj se çfarë do të jetë statusi final, ka llogaritur në supozimin naiv se vonimi i vendim-marrjes për një çështje të tillë do të mundësonte zbutjen e pasioneve. Kjo ka bërë edhe që të mos merren me seriozitet kërcënimet për sigurinë

dhe të mos përballet me strukturat paralele dhe grupet kriminale. Kjo mungesë e vendosshmërisë ka lënë shumicën shqiptare dhe pakicën serbe të ngërthyer në një konflikt që mbahej i ndrydhur e jo i zgjidhur.

Me paqartësitë rreth statusit që largonin investitorët dhe pa një mori anterasimesh në qarqe të cilat vazhdojnë të mbeten të hapura vetëm për shtetet e formuara kombëtare, zhvillimi i Kosovës ka stagnuar nën sundimin e tashëm të OKB-së. Prodhimi i përgjithshëm kombëtar i saj (GDP-ja) - i varur nga kontributet e donatorëve që largohen para kohe dhe me vetëm 4 për qind të importeve të mbuluara nga eksportet - është paqëndrueshëm edhe për nivelin e ulët në të cilin është tani. Me shumë familje që varen nga të hollat e dërguara nga fëmijët e tyre emigrantë në vendet e tjera, Kosova është përfshirë në një luftë demografike poshtuese me Evropën Perëndimore. Derisa shqiptarët e Kosovës fshehurazi kalojnë kufinj të dhe hyjnë në tregun fuqisë punëtore në këto shtete, këto kërkojnë që t'i kthejnë ata prapa. Për më shumë se 50 për qind të fuqisë punëtore që për momentin është e papunë, duke përfshirë këtu edhe 30.000 deri 40.000 që i shtohet këtij numri çdo vit, ndihmat e tashme për Kosovën nuk mjaftojnë.

Është esenciale që të gjithë të përballen me implikimet e 17 dhe 18 marsit. Institucioneve të bashkësisë ndërkombëtare u nevoiten mënyra të reja të veprimt, në rastin e UNMIK-ut një strukturë e re me mandat të ri. Nëse nocioni i ndarjes hedhet poshtë - e ICG-ja beson se kështu edhe duhet bërë, përveç nëse nëse të dy palët e inetersuara vendosin ndryshe (që do të ishte në pajtim me Parimet e Helsinkit), që është shumë pak e mundur - kjo gjendje nuk mund të vazhdojë të mbetet më tutje jasht kontrollit dhe duke besuar se do të bëhet mirë, por vetëm politikat reja ndërkombëtare dhe sinqeriteti i shqiptarëve të Kosovës në raport me shoqërin e tyre do të bënin ndryshime që do ta bënin Kosovën një vend më të mirë për të gjitha komunitetet që jetojnë në të.

Që të bëhet kjo, duhet të vihet në vend, sa më shpejtë, një proces zhvillimor i vërtetë politik, social, ekonomik e institucional, për të absorbuar energjinë e popullatës së Kosovës. Politika e tashme e «standardeve para statusit» është vetëm një politikë gjysmake. Pasojat rajonale të vazhdimt të rrjedhave që shpiejnë në destabilizimin e Kosovës janë të paparshikueshme. Bashkësia ndërkombëtare ka një dritare shumë të vogël që të mësojë nga gabimet e veta dhe të rimarrë gjërat në duart e veta. Përndryshe, gjendja në Kosovë do të mund të bëhej e papërbalueshme në kuptimin e akumulimit të

dhunës dhe zhytjes në një rreth vicioz që do të prekte tërë Ballkanin Perëndimor.

REKOMANDIMET

Për institucionet e Kosovës duke përfshirë edhe IPVQ-në, mediat dhe shoqërinë civile:

1. Të luftohen patologjitë ekstremiste dhe jotolerante në shoqërinë shqiptare në Kosovë në vend të fajësimit të bashkësisë ndërkombëtare dhe UNMIK-ut për problemet në Kosovë.
2. Të pranohet fakti i pamohueshëm se raportimi i mediave për dhunën ka qenë i njëanshëm dhe në një formë, me rol nxitës, dhe të bashkëpunohet me Komisionerin e përkohshëm për media dhe OSBE-në për gjetjen e një mënyre të përshtatshme për të shkuar përpara duke përfshirë këtu edhe bërjen e ndryshimeve në menaxhimin dhe bordin e transmetuesit publik, RTK-së, duke kërkuar edhe asistencë të vazhdueshme teknike nga transmetues profesionistë e me përvojë evropianë.
3. Të shkohet përtej zotimeve të IPVQ-së për të ndihmuar ri-ndërtimin e shtëpive, manastireve dhe kishave që janë shkatërruar gjatë trazirave me fonde të qeverisë duke ndërmarrë një iniciativë të gjerë për mbledhjen e parave nga të katër anët e shoqërisë për këtë qëllim dhe gjithashtu duke ndërmarrë iniciativën për zhvillimin e infrastrukturës për serbët e Kosovës përfshirë arsimin dhe sistemin shëndetësor.
4. Të vazhdohet me procesin e dialogut me Serbinë, i filluar në tetor të vitit 2003.

Për vendet e Grupit të Kontaktit (SHBA, MB, Francën, Gjermaninë, Italinë dhe Rusinë) dhe anëtarë të tjerë të Bashkësisë ndërkombëtare:

5. Të riangazhohen seriozisht në çështjen e Kosovës, ashtu që:
 - (a) Të ndërmirren masa për shtimin e sigurisë për komunitetet pakicë në Kosovë, veçanërisht për serbët;
 - (b) Të fillojnë me përgatitjet për bisedimet për statusin final, duke konfirmuar se bazë legale do të jetë Rezoluta 1244; dhe

- (c) Të bëhen përpjekje substanciale dhe të vazhdueshme për zhvillim social, ekonomik dhe institucional që Kosova të bëhet gati për statusin final.
6. Të punohet nëpërmjet Këshillit të Sigurimit të OKB-së për ndryshimin e strukturës së UNMIK-ut, në mënyrë që mandati i tij të përshtatet më mirë për periudhën tranzitore deri tek statusi final dhe anëtarësimi eventual në BE, duke i dhënë prioritet zhvillimit social dhe ekonomik, prioritete këto që momentalisht mungojnë, me anë të:
- (a) Shpërbërjes së strukturës së katër shtyllave ekzistuese të UNMIK-ut;
- (b) Transferimit të përgjegjësiave sociale dhe ekonomike nga UNMIK-u tek IPVQ-ja; dhe
- (c) Ndarjes së rolit të PSSP-së në dysh, me funksione përkatëse të administratorit kryesor për Kosovën dhe negociatorin kryesor për statusin final.
7. Të reagohej me shpejtësi në kërkesën e UNMIK-ut për anagzhimin e më shumë hetuesëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve, në mënyrë që UNMIK-u të hetojë dhe ndjekë penalisht ata që me arsye dyshohet se janë përgjegjës për trazirat e dhunshme duke vepruar në kuadër të kornizës së procedurës së Kodit të ri penal.

Për UNMIK-un:

8. Të institucionalizohet dialogu në mes të liderëve dhe shoqërisë civile të shqiptarëve të Kosovës nga njëra anë, me homologët e tyre serb të Kosovës në anën tjetër për çështjet e bashkjetesës në Kosovë me planin e Këshillit të Evropës për decentralizim si pikënisje.
9. Të ri-vitalizohet privatizimi duke bërë ndryshime procedurale të nevojshme në mënyrë që të arrihet progresi i menjëhershëm; të përfitohet nga shkarkimi i ish-shefes se Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit duke dhënë shenja të vazhdueshme të të menduarit të ri, dhe akomodimit të nevojave për zhvillim shoqëror dhe ekonomik të Kosovës; dhe të kërkohen nga OKB-ja dhe Grupi i Kontaktit politika dhe resurse të nevojshme për të arritur këto.
10. Të përmirësohet struktura komanduese dhe kontrolli brenda UNMIK-ut dhe Shërbimit

Policor të Kosovës (SHPK), të përmirësohet koordinimi i veprimeve me KFOR-in (veçanërisht në grumbullimin e të dhënave për ekstremistët dhe strukturat paralele), t'i sigurohet policisë më shumë trajnim dhe paisje, dhe të përgatitet për ballafaqim me sfidat si ato të 17 e 18 marsit duke ngritur moralin e tyre të ulët.

Për NATO-n:

11. Të shtohet kapaciteti i trupave të KFOR-it që të mund të ballafaqohen me trazira të dhunshme në të ardhmen, duke i paisur, instruktuar dhe trajnuar për përdorimin gradual të forcës në raste të rreziqeve, si dhe duke bërë shtimin e sigurisë përgjatë kufirit.

Për qeverinë e Serbisë:

12. Të punojë me UNMIK-un që strukturat paralele të njihen, veprojnë sipas rregullave dhe nëse është e mundur të përkrahen nga IPVQ-ja me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe shërbimeve sociale për komunitetin serb brenda Kosovës.
13. Të vazhdojë procesin e dialogut me Prishtinën për çështje teknike.

Për qeverinë e SHBA-së:

14. Të emërojë një emisar special për të inicuar diskutimet në mes të anëtarëve të Grupit të Kontaktit, BE-së, IPVQ-së, Beogradit dhe shteteve fqinje për bazat ligjore dhe formën e bisedimeve eventuale për statusin final.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 22 prill, 2004

KOLAPSI NË KOSOVË

I. HYRJE

Kohët e fundit, bashkësia ndërkombëtare po e mashtronte veten duke besuar se premtimet gjysmake të nëntorit të vitit 2003 - se do të fillojë shqyrtimin e statusit final për provincën nëse do të plotësohen në mënyrë të kënaqshme disa standarde në qeverisje dhe përfshirjen e minoriteteve deri në mesin e vitit 2005 - kanë paraqitur një politikë të kompletuar. Pas trazirave dy-ditëshe, pjesërisht të koordinuara, të zjarrëvënies, vjedhjeve, të shtënave me armë, gjuajtjeve me gurë, me Koktejë Molotovi e hedhjeve të granatave, e që lanë 19 të vdekur, afërsisht 900 të plagosur (më shumë se njëzet prej tyre rëndë), më shumë se 700 shtëpi të serbëve, ashkalive dhe romëve, rreth 10 ndërtesa publike dhe 30 kisha serbe dhe dy manastire të dëmtuara ose të shkatërruara, dhe rreth 4,500 serb të Kosovës të zhvendosur,¹ u pa se politika e «standardeve para statusit» është gjysmake dhe se duhet të ndryshohet me shpejtësi.

Institucionet e Përkohëshme të Vet-qeverisjes së Kosovës (IPVQ) nuk mund të arrijnë që të drejtojnë dhe orientojnë shoqërinë që pretendojnë se e përfaqësojnë. Vendimi që nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës të paguhet për rindërtimin e objekteve të shkatërruara ishte vendim i mirëseardhur por këta nuk u kanë kërkuar fajle serbëve të Kosovës; në të vërtetë ata as që e kanë pranuar publikisht se cilat shtëpi janë sulmuar dhe kush janë viktimat e këtyre trazirave. Mediat shqiptare të Kosovës që në vigjilie të shpërthimit të dhunës me aq shpejtësi identifikuan fajtorët e mbyjtjes së fëmijëve tani ngurojnë të identifikojnë dhe të bashkëndiejnë me mijëra viktimat të reja. Mediat më «liberale» janë përqëndruar në dëmin politik që ka pësuar Kosova dhe kanë lënë fare pas dore dimensionet njerëzore. Të tjerët, siç është gazeta *Epoka e Re*, i prezentojnë shqiptarët si

viktimat të këtyre trazirave si dhe denoncojnë veprimet e forcave të sigurimit kundër pjesmarrësve të trazirave.

IPVQ-ja dhe shoqëria shqiptare e Kosovës në përgjithësi tani qëndrojnë në bankën e të akuzuarve të opinionit publik botëror - për dy ditë ata kanë «djegur» kapitalin moral të grumbulluar gjatë fushatës së mizorive të Millosheviqit dhe shpërnguljeve masive të ushtruara kundrejt tyre gjatë viteve 1998-1999.² A do të vendosin ata që më në fund të mobilizohen në luftë të përbashkët kundër dhunës apo do të vazhdojnë të lejojnë veprimet e papërmbytshme të fëmijëve të tyre dhe grupeve kriminale të përcaktojnë të ardhmën e Kosovës. Megjithëse shumica e shqiptarëve aspirojnë të shpallin vendin e tyre shtet, me synim integrimin në Bashkimin Evropian, lejmi i pastrimit etnik kërcënon katandisje e tyre dhe të vendit të tyre në status të të syrgjynosurit, si problem për tërë rajonin fqinjë.

Tash kur «pluhuri i ngritur është duke u hequr», misioni paqëruajtës ndërkombëtar dhe Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse të Kosovës, mediat dhe shoqëria në tërësi po tregojnë shenja të tërheqjes në realitete të ndara, që rrezikojnë thellimin e hendeqeve ndërmjet tyre. Ky raport përshkruan ngjarjet që kanë ndodhur dhe propozon hapat që duhet ndërmarrë në mënyrë që Kosova të shkojë drejt rrugës së paqës.

¹ Shih kronologjinë e dhunës së 17-19 marsit në aneksin A.

² Ngjarjet e 17-18 marsit të vitit 2004 ishin shënuar me dhunë të shqiptarëve kundër etniteteve të tjera sikurse në vitin 1999. Shih raportin e "Human Rights Watch", "Republika Federale e Jugosllavisë: Keqtrajtmet e serbëve dhe romëve në Kosovën e re", gusht 1999, në: <http://www.hrw.org/reports/1999/kosov2/>.

II. PËRPLASJA E VIZIONEVE PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS

Për shqiptarët e Kosovës, pavarësia është shpallur në tetor të vitit 1991 dhe dhymbëdhjetë vite e gjysmë është pritur pranimi i saj nga ana e Bashkësisë Ndërkombëtare dhe Serbisë. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së - që në mënyrë eksplicite u referohet bisedimeve të Rambujesë të cilat dështuan në evitimin e luftës në vitin 1999 - e forcoi edhe më idenë se vullneti i popullit do të jetë faktor me rëndësi për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Si rezultat i kësaj, 90 për qind e popullsisë së Kosovës nuk do të pranojë asgjë më pak sesa pavarësinë. Nga një pikëvështrimi i tillë, fakti se tërë pushteti mbi Kosovën, sipas ligjit ndërkombëtar, bie mbi Misionin e OKB-së në Kosovë (UNMIK), është krejtësisht irrelevant; «qeveria në hije» e viteve 1991-1999 dhe që IPVQ-ja nga viti 2002 janë ato që na shqiptarët e Kosovës janë parë si organet e vetme legjitime qeverisëse.

Mungesa e progresit rreth statusit final si dhe mungesa e ndonjë indikacioni lidhur me atë se sa mund të zgjasë mandati i UNMIK-ut ishin faktorë që ndikuan në shtimin e ndjenjës së frustrimit. Çdo veprim i ndërmarrë nga UNMIK-u, në veçanti marrëdhëniet e tij me Beogradin, janë vëzhguar me kujdes nga ana e shqiptarëve të Kosovës për të gjykuar nëse një veprim i tillë ka avansuar njohjen e pavarësisë dhe zakonisht vëzhgimet e tilla kanë konkluduar se kjo nuk është bërë. (Në mënyrë paralele, natyrisht, Beogradi ka karakterizuar çdo veprim të UNMIK-ut si qëllim të vendosjes së një sistemi të brendshëm qeveritar dhe si një hap tjetër jo legjitim dhe unilateral drejt pavarësisë.) Standardet para statusit, një proces që është vendosur nga ish-përfaqësuesi special i OKB-së, Michael Steiner, në mesin e vitit 2002, nga të dyja palët është perceptuar si një masë tjetër e përkohëshme, me disa detaje se si standardet duhet të vlerësohen dhe asnjë detaj për atë se si duhet të zgjidhet statusi përfundimtar.³

³ Shih raportin e ICG-së për Evropë, N°148, Dy për tango: Agjendë për përfaqësuesin e ri të PSSP-së, 3 shtator 2003, faqet 16-18.

A. POLITIKA E BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE

Një fazë më dinamike ka filluar më 4-6 nëntor të vitit 2003, kur nën-sekretari i SHBA-ve, Marc Grossman, gjatë vizitës që i bëri Brukselit, Prishtinës dhe Beogradit ka paralajmëruar një iniciativë të re në emër të shteteve të Grupit të Kontaktit të cilat kanë fjalën kryesore në përcaktimin e politikës për Kosovën⁴. Qe premtuar shqyrtimi i statusit përfundimtar kah mesi i vitit 2005, nëse deri atëherë IPVQ-ja do të ketë përbushur një numër të caktuar të standardeve në qeverisje dhe trajtim të minoriteteve. Një paralajmërim i tillë ndryshoi perceptimet e të ardhmes së Kosovës; kur dukej se sundimit të UNMIK-ut nuk po i shihej fundit, tani përnjëherë filluan t'i numërohen ditët. I pyetur nga një gazetar në Prishtinës se a ishte pavarësia opcion në fund të një procesi të tillë, Grossman u përgjigj: «Të gjitha opsionet janë mbi tavolinë».

Përnjëherë u duk e mundur që të bëhet kanalizimi i mosadurimit, frustrimit, dhe pasigurisë së shqiptarëve të Kosovës në proces konstruktiv. Në muajt që pasuan, puna e përbashkët në përpilimin e planit për implementimin e standardeve ka evituar përkeqësimin e marrëdhënieve mes UNMIK-ut dhe IPVQ-së.⁵ Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka miratuar planin e Standardeve për Kosovën, iniciativë kjo e Grupit të Kontaktit, e që parashikonte formimin e pesë grupeve të përbashkëta punuese, UNMIK-IPVQ, për planifikimin dhe koordinimin e përbushjes së tetë standardeve që përfshijnë funksionimin e institucioneve demokratike; sundimin e ligjit; lëvizjen e lirë dhe kthimin e qëndrueshëm, të drejta për komunitetet; ekonominë; të drejtat pronësore; dialogun në mes të IPVQ-së dhe Beogradit; dhe krijimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) si organizatë civile emergjente. Duke filluar nga maji i vitit 2004, përpjekjet e IPVQ-së për arritjen e këtyre standardeve do të vlerësoheshin nga UNMIK-u me raportet tre-mujore të prezentuara në Këshillin e Sigurimit.

Por, ngjarjet e marsit 2004 kanë bërë që të kuptohet se IPVQ-ja përfaqëson dhe gëzon besimin e

⁴ Grupin e Kontaktit e përbëjnë: SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia; pesë anëtarëve të këtij Grupi, pa Rusinë, nganjëherë iu referohen edhe si anëtarë të Quint-it.

⁵ Shih raportin e ICG-së për Evropë, N°148, Dy për tango: Agjendë për përfaqësuesin e ri të PSSP-së, 3 shtator, 2003.

shoqërisë kosovare vetëm në një shkallë të kufizuar. Numri modest i kompetencave qeverisëse që ka transferuar UNMIK-u tek këto institucione si dhe të metat e dukshme të saj -- aftësia e kufizuar, vizionet shkurtpamëse, akuzat për keqpërdorime - kanë bërë që ajo të shikohet nga shoqëria si një elitë kuislinge e e korrumpuar. Përmirësimi i raporteve UNMIK-IPVQ pas vizitës së Grossmanit nuk kishte qetësuar edhe shoqërinë e gjerë të shqiptarëve të Kosovës. Në njëfarë mënyre, këto struktura qeverisëse ndërmjet vete po ndërtonin kështjella në ajër.

Shumë gjëra në Kosovë zhvillohen jashtë jetës institucionale; përveç strukturës demografike të dominuar nga fëmijë dhe të rinjë, papunësisë në shkallë prej 50 për qind deri në 60 për qind dhe sistemi arsimor stagnant dhe joadekuat, është aty edhe një trup i madh i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët ndihen të anashkaluar, ndërsa disa prej tyre edhe janë përfshirë në organizata kriminale. Elita e re e IPVQ-së nuk arrinë deri tek masat e gjera të shoqërisë: kjo elitë vepron kryesisht përmes raporteve patron-klient të kanalizuar nëpërmjet të sistemit partiak politik. Tek njerëzit në margjina të kësaj jete institucionale, formula e statusit për Kosovën duket më e thjeshtë sesa formulimet e ndërlikuara të Grupit të Kontaktit: krijo faktet në terren, dëboi trupat e huaja, qofshinë këta serbë apo ndërkombëtarë. Nëse do të kenë sukses në këtë grupet e tilla, do të krijojnë një vend të leçitur nga të tjerët, në luftë të përhershme me fqinj të vet.

UNMIK-u nuk ka në thelb të mandatit të tij zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Kosovës. Këto detyra urgjente kanë mbetur jashtë kompromiseve politike që formësojnë rolin e tij paqësor e për ruajtjen e status quo-së. Me statusin e pazgjidhur si kusht për tërheqjen e investitorëve dhe pa një mori antarësimesh që mbeten të hapura vetëm për shtetet e formuara - që nga antarësimi në sistemin e transferit bankar ndërkombëtar, SWIFT-it, «Kartonit të gjelbër» për sigurimin ndërkombëtar të veturave, pasjes së kodit të telefonisë, pasaportës së pranuar gjithandej, të qenurit në gjendje për të marrë kredi sovraane nga bankat për zhvillim - zhvillimi i Kosovës është i frenuar nën sundimin e OKB-së. Për turmat e njerëzve të papunësuar, përfshirë këtu 30,000 deri 40,000 të rinjë që i shtohen tregut të fuqisë punëtore për çdo vit, ndihmat e tashme ndërkombëtare nuk janë të mjaftueshme.

Larg nga përmirësimi, ekonomia e Kosovës vitin e fundit regresion. Shitësit me pakicë i kanë thënë ICG-së se qarkullimi ka rënë për një të tretën afaristët

ankohen për shtim të krizës së likuiditetit. Me pakësimin e ndërkombëtarëve, industria e shërbimeve që kishte sjellur në Kosovë 1 miliard euro në vit gjithashtu po pëson rënie. Edhe niveli i tanishëm i ulët i GDP-së vështirë se mund të mbahet. Në vitin 2002, 50 për qind të tij e përbëninndihmat nga jashtë, 30 për qind nga paratë e dërguara nga diaspora - burime këto të dyja tani më të shterrura - dhe me vetëm 20 për qind të të ardhurave të siguruara nga aktivitetet ekonomike të zhvilluara brenda në vend.⁶ Në vitin 2003, eksportet kanë mbuluar një shumë prej 4 për qind të importeve.⁷

Për më keq, në përpjekje të mbijetimit ekonomik, Kosova është zënë ngusht në luftë poshtëruese demografike me Evropën Perendimore. Për shumë familje të dëshpëruara kosovare, dërgimi i një anëtari të familjes jashtë vendit për të punuar është mënyra e vetme për të mbetur gjallë. Për më shumë, vendet e Evropës Perendimore ku ata kërkojnë strehë nuk janë aspak mikpritëse: kalime e fshehta të kufinjëve, dokumente të falsifikuara, tregu i zi i vizave, martesat «për letra», punësim në sferën e ekonomisë së zezë, janë këto elementet që karakterizojnë marrëdhëniet, aspak stabile, mes tyre. Në vitin 2003, për shembull, Britania e Madhe, po kthente nga një aeroplan me shqiptarë të Kosovës në Prishtinë çdo javë edhe pse një numër edhe më i madhi tyre po e gjente rrugë për të hyrë në këtë vend.

B. QËNDRIMET E BEOGRADIT

Edhe pse kthimi i Serbisë në bashkësinë ndërkombëtare ishte mirëpritur pas rënies së Millosheviqit, në tetor të vitit 2000, shqiptarët e Kosovës nuk shohin ndonjë ndryshim në qëndrimet e Beogradit kundrejt tyre. Qeveritë serbe, pasardhëse të qeverisë së Millosheviqit kanë vazhduar politikën e krijimit të strukturave paralele dhe punën për ndarjen teritoriale të provincës në atë mënyrë që nëse ndonjëherë Kosova do t'a fitonte pavarsinë, këto ndarje de facto, do të mund të ishin baza të një ndarje reale të Kosovës. Zyrtarët serbë, që vazhdojnë të përdorin emrin «Kosovo i Metohija» me të cilin emër Millosheviqi riemëroi provincën pas heqjes së

⁶ Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës, Raporti vjetor për vitin 2002, fq.8.

⁷ "Politikat tregtare për Kosovën 2004", dokument i përbashkët i Ministrisë për tregti dhe industri dhe Shtyllës IV-të e UNMIK-ut (shtylla e BE-së), 8 prill, 2004.

autonomisë në vitin 1989,⁸ insistojnë se kompanitë serbe janë pronarë të pronës së NSH-ve të cilave u janë dhënë këto me procedura të dyshimta gjatë viteve 90-të, dhe ende angazhohen në privatizimin e ndërmarjeve në pronësi shoqërore. Zyrtarët dhe mediat e Beogradit denigrojnë shqiptarët, duke i lidhur ata me krimin e organizuar dhe terrorizëm. Pranimi i krimeve të kryera kundër shqiptarëve të Kosovës është i përciptë, sipërfaqësor dhe zakonisht arësytetohet si reagim kundër "terrorit" shqiptar. Nga ana tjetër shqiptarët mbesin të alarmuar se nuk pranohet sa duhet ky kontinuitet i politikave të Milosheviqit në kuadër të nxitimit për të rivendosur partneritetin me Serbinë pas-Milosheviqiane. Kjo frikë është bërë edhe më e shprehur pas fitores së nacionalistëve në zgjedhjet parlamentare serbe, më 28 dhjetor 2003.⁹

Serbia duket se e sheh implementimin e standardeve si rrugë drejt pavarësisë së Kosovës, gjë të cilën Beogradi zyrtar vazhdon t'a kundërshtoj fuqishëm.¹⁰ Nga përkrahja që tregoi në fillim, emisari special i Beogradit për Kosovën, zëvendës-kryeministri Coviq ashpërsroi pozicionin e tij në dhjetor të vitit 2003 lidhur me procesin e implementimit të standardeve në Kosovë, duke u ankuar se Serbia nuk ishte konsultuar paraprakisht në mënyrë adekuate. Kjo arriti kulminacionin me detyrimin e serbëve të Kosovës nga ana e Beogradit në marrjen pjesë në përpilimin e deklaratës së Ditës së Shën Nikolës, më 19 dhjetor, sipas të cilës ata do të bojkotonin procesin dhe do të bënin thirrje për ndarje të etniteteve serbe dhe shqiptare.

Kryeministri serb, Vojislav Kostunica, në fjalimin e tij të 2 marsit të vitit 2004 i kushtoi Kosovës një pjesë të fjalimit të tij inagurues para parlamentit serb, duke hedhur poshtë pavarësinë për Kosovën si opcion. Në vend të kësaj ai paraqiti vizionin e tij për Kosovën si një provincë autonome e Serbisë, dhe me një autonomi të serbëve të Kosovës brenda asaj autonomie. Ai deklaroi se nëse «autonomia fundamentale është formulë në bazë të së cilës Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së siguron vetqeverisje të Kosovës dhe Metohisë brenda Serbisë, atëherë autonomia fundamentale e

komunitetit serb është një formulë e re e cila do të siguronte themelet bazë për serbët e Kosovës dhe Metohisë së sotme që të vazhdojnë të mbesin atje».¹¹ Kjo "autonomi fundamentale" kishte kuptimin e "autonomisë teritoriale, ndarjen në etnitete, e që është kantonizimi i Kosovës dhe Metohisë «. Në atë kohë këto deklarata nuk ishin shumë të qarta ndërsa, përdorimi i termit «ndarje» alarmoi si shqiptarët e Kosovës ashtu edhe komunitetin ndërkombëtar.

Që prej atëherë - ndoshta si rezultat i presioneve të ushtruara nga ana e BE-së dhe SHBA-ve - Kostunica ka vazhduar të elaborojë aspekte të kësaj ideje duke shtuar se kjo do të duhej të përfshinte «një autonomi të nivelit të lartë për serbët në Kosovë», e cila autonomi do të "shtrihej në ato pjesë ku janë të përqëndruar serbët dhe ku ata janë shumicë». Ai gjithashtu kishte deklaruar se kishte «përmendur disa terme - decentralizim, etnitete, kantone - duke mos dalluar asnjërin prej tyre».¹² Ai kishte pohuar «se është krejt njësoj se si do të quhet kjo autonomi, kantonizim apo decentralizim».¹³ Kostunica gjithashtu ka deklaruar se ricaktimi i kufinjëve komunalë brenda në Kosovë do të duhej t'u mundësonte serbëve që të formojnë njësi teritoriale më të mëdha dhe më kompakte.¹⁴ Ai kishte pohuar se megjithatë, qeveria e Serbisë së shpejti do të prezentonte një plan për zgjidhjen e situatës në Kosovë.¹⁵ Deri më tani ky plan nuk duket të jetë finalizuar ende.

Beogradi ka përdorur termet si kantonizim, ndarje dhe decentralizim edhe më herët ndërsa në kuptimin e diskursit politik serb, të gjitha termet duket t'i referohen të njëjtës gjë: platformës dhe ideve të Branislav Krstiqit të Qendrës Koordinuese, si model për ndarje teritoriale¹⁶. Ideja e Krstiqit nuk i definon qartë strukturat qeverisëse ose marëdhëniet dhe raportet e territoreve serbe brenda në Kosovë, me Prishtinën. Në vend të kësaj, duket se kërkojnë territore të ndara në vija etnike, ku viseve të ndara

⁸ Emri Kosovë dhe Metohi ishte përdorur deri me aprovimin e kushtetutës jugosllave të vitit 1968.

⁹ Për këto zgjedhje shih raportin e ICG-së për Evropë N° 154, "Serbia's U-Turn", 26 mars, 2004.

¹⁰ Kjo ishte parë me aktin e aprovimit të rezolutës së 26 marsit për Kosovën, të adoptuar nga Parlamenti serb, në të cilin Kosova ishte shpallur pjesë "e pandashme" e Serbisë.

¹¹ Fjalim i i plotë i Kostunicës në parlamentin serb, më 2 mars, gjendet në Web faqen e qeverisë serbe: <http://www.srbija.sr.gov.yu/cms/view.php/510.print.html>.

Shih gjithashtu "Koshtunica: katër detyrat më të rëndësishme të Serbisë", faqja në Internet e B92, 2 mars 2004.

¹² "Mes 17 dhe 31 marsit" NIN, 1 prill 2004.

¹³ "Koshtunica: nuk heqim dorë nga autonomia e serbëve për Kosovën.", B92, 4 prill, 2004.

¹⁴ "Mes 17 e 31 marsit" NIN, 1 April 2004.

¹⁵ Shih intervistën e Kostunicës në gazetën ditore *Politika*, "Uneti red u drzavu", 4 prill 2004.

¹⁶ Krstic, *Kosova: Shkaqet e konfliktit, Ripajtimi për dhënien e të drejtave*, Beograd: 2001.

shqiptare do t'u ipej një autonomi e shkallës së papërcaktuar, por gjithnjë në kuadër të Serbisë. Sipas hartave të publikuara nga mediat elektronike dhe të shtypura të Beogradit e gjithashtu edhe hartave të përgatitura nga Krstiq, viset të cilat Beogradi i lakmon dhe për të cilat pretendon të jenë pjesë e territorit serb përfshijnë jo vetëm pjesën veriore me shumicë serbe por gjithashtu edhe rajonet të cilat ishin (dhe ende janë) të banuara me shumicën shqiptare që para vitit 1999, siç janë Peja, Gjilani dhe Prishtina.

Edhe pse Beogradi rralë ka folur për projektet e UNMIK-ut për krijimin e administratës unike multi-etnike në Kosovë, deklarata e 2 marsit e bërë nga Koshtunica si dhe deklarime të tjera pasuese kanë indikuar një largim të qartë nga pajtimi me këtë politikë. Ajo që Beogradi kërkon është një zgjidhje territoriale. Që nga vitit 1999, përpjekjet për ndarje të territoreve janë mbështetur me krijimin e strukturave paralele brenda në Kosovë, jasht juridiksionit të UNMIK-ut. Beogradi nuk duket të jetë i interesuar për një jetë multi-etnike në provincë dhe Koshtunica e politikanë të tjerë kanë përsëritur se serbët dhe shqiptarët nuk mund të jetojnë së bashku dhe se ata mundën vetëm të jetojnë pranë njëri tjetrit.¹⁷ Kjo presupozon një lloj të aparteidit etno-geografik. Qëllimet serbe për Kosovën janë që ajo të mbetet brenda Serbisë me një shkallë të autonomisë vetëm pjesërisht më të zgjeruar se sa ajo e kushtetës serbe nën Millosheviqin (1992), por shumë më e mangët se sa ajo e kushtetës federale Jugosllave e vitit 1974. Në kuadër të kësaj autonomie, pjesët me shumicë serbe në Kosovë do të gëzonin autonomi të plotë nga Prishtina, përderisa do të vazhdonin të jenë nën kontroll të drejtëpërdrejtë nga Beogradi dhe se të njëjtit ende do të gëzonin të drejtën e votës në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, mund të thuhet se përdorimi i termeve siq janë «decentralizim», «kantonizim», dhe «ndarje» nga ana e Beogradit, nuk bëhet në kuptimin e saktë që kanë këto formulime.

¹⁷ "Koshtunica: pavarësia e Kosovës nuk është zgjidhje e mirë," B92, 19 mars 2004. Gjithashtu shih vërejtjet lidhur me deklaratën e parlamentit serb për Kosovën: "Qeveria e Serbisë aprovoi rezolutën për Kosovën," B92, 26 mars, 2004.

III. FËRKIMET NË RRRITJE

Botëkuptimet kontradiktore të OKB-së dhe IPVQ-së të asaj se çfarë do të bëhet në mesin e vitit 2005, janë bërë publike nga mesi i shkurtit të vitit 2004. PSSP, Hari Holkeri ka paralajmëruar me 17 mars, se nuk do të thotë se në mënyrë automatike do të fillojë procesi i caktimit të statusit final në gjysmën e vitit 2005, poqese nuk do të arrihej një përparim adekuat në përmbushjen e standardeve. Politikanët shqiptarë kanë reaguar ashpër. Se sa i lartë ishte presioni ndër shqiptarët e Kosovës tregon reagimi i kryeministrit Rexhepi - i cili konsiderohet si një nga figurat më të matura, më të arësyeshme dhe me më shumë cilësi prej burrështetasi në kuadër të spektrit shqiptar të Kosovës - i cili u shpreh:

Nuk do të dëshiroja që vera e vitit 2005 në Kosovë të jetë një verë e nxehtë. Do të kisha dëshiruar që premtimet të cilat janë bërë, për ekzistimin e vullnetit në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare për t'i thënë «po» fillimit të definimit të statusit përfundimtar të jetësohen, dhe do të kisha dëshiruar që ky premtim të mbahet në mënyrë që të mos jemi të detyruar të marrim vendime unilaterale. Ne nuk do të donim të ndërmarrim vendime unilaterale, të mbajmë referendum ose të shpallim pavarësi; por do të jemi të detyruar t'a bëjmë këtë dhe do të kemi arësytim moral për të bërë këtë hap, nëse bashkësia ndërkombëtare do të nguronte të na përkrahte.¹⁸

Megjithatë, mirëpritja e kësaj iniciative dhe qetësia relative që zgjati për disa muaj bëri Grupin e Kontaktit të mashtrohet duke besuar se premtimet e tyre gjysmake janë zëvendësim për një politikë të plotë.¹⁹ Mosgatishmëria për të bërë të qartë se çfarë

¹⁸ Zeri gazetë javore, 21 shkurt, 2004. Në vigjilie të trazirave të marsit, Rexhepi paraqiti qëllimin e tij në mënyrë më eksplicite. Në një intervistë të publikuar në The Financial Times më 19 prill, ai deklaroi: "Nëse ne do të presim deri në shtator të vitit 2005 dhe se e shohim se ata po blejnë në kohë, ndoshta neve do të lëvizim qëndrimet tona në mënyrë unilaterale drejt referendumit për pavarësi ose shpalljen e deklaratës për pavarësi."

¹⁹ Ndonëse larg nga një analogji perfekte, situata përmbanë disa tërheqje të paraleleve të kohërave të pranimit të kushtetës së re otomane turke të vitit 1908 nga ana e shqiptarëve e që janë -- euforia fillestare, disa muaj të qetësisë së suksesshme në jetën shoqërore, fazë kjo të përcjellur me de-iluzionizëm; Shih Edith Durham, Shqipëria e lashtë (e ribotuar në Londër në vitin, 1985), p. 327: "N'a

do të ndodhë në mesin e vitit 2005 ka bërë më pak atraktivë procesin e standardeve ndërsa ka ngritur deri në nivel shpërthyes pritjet e shqiptarëve të Kosovës. Veçanërisht SHBA-të duket se besonin se përcaktimi i statusit final të Kosovës do të mund të ishte i de-politizuar dhe se vlerësimi i implementimit të standardeve do të mund të ngritej gati në një shkencë objektive.

A. PRIVATIZIMI

Holkeri ia kishte dalur të ulte heshtat me IPVQ-në në fushëbetjën e standardeve²⁰ por kjo nuk qe bërë edhe në frontet tjera, veçanërisht në atë të çështjes më kruciale, privatizimit. Pas luftës, UNMIK-ut dhe partnerëve të tij u janë dashur tri vite që të përpilojnë mekanizmin komplekst të privatizimit për futjen e pasurisë së 400 ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve) në ekonominë e vendit si dhe për tërheqjen e investitorëve. Me krijimin e kompanive të reja nga asetet e NSH-ve dhe me derdhjen e të ardhurave nga privatizimi në një fond me të cilin do të sqaroheshin kontestet pronësore, UNMIK-u synonte të niste një politikë të nevojshme për zhvillimin ekonomik të Kosovës duke anashkaluar debatin tepër politik mbi çështjen e pronësisë. Kah mesi i vitit 2003, kjo politikë ka rezultuar me plane konkrete, përkundër kundërshtimeve të Çoviqit se kjo ishte vjedhje e pasurisë serbe. Por, më 6 tetor 2003, udhëheqësi i shtyllës së katërt të UNMIK-ut - përgjegjëse për rindërtim dhe zhvillim ekonomik - është tërhequr para pikëpyetjeve të shtuara rreth bazës legale sa që suspendoi këtë program. Për shqiptarët e Kosovës, kjo ishte tërheqje para Bogradit.

UNMIK-u është dashur të bëjë më tepër presion për një marrëveshje me Nju Jorkun në mënyrë që të sigurohej një mbështetje nga vendet kryesore përfaqësuese në Këshillin e Sigurimit dhe në Grupin e Kontaktit në mënyrë që të siguronte mbrojtje legale

për stafin e UNMIK-ut që do të bënte shpronësimin e NSH-ve para procesit të privatizimit.²¹

Në tetor të vitit 2003, Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) - i themeluar nga shtylla e katërt e UNMIK-ut për të menaxhuar dhe privatizuar ndërmarrjet publike dhe shoqërore - kishte marrë goditje të rënda nga OKB-së mu në dy kërkesat themelore. OKB-ja refuzoi të shtrijë imunitetin e saj mbi stafin e AKM-së si dhe refuzoi t'i shpallë të pavlefshme tri ligjet serbe për Kosovën e viteve të 90-ta me të cilat ishin bërë transformimet e pronëve në epokën e Milosheviqit. Për më tepër, kërkoi që AKM-ja të ndryshojë politikat operacionale ashtu që pronësia e çdo NSH-je të sqarohet para privatizimit. Ky ndryshim, bashkarisht me dëshirën e shefes së AKM-së, Marie Fucci,²² që të bëjë procedurën e privatizimit përgjithësisht më komplekse, bënë që procesi i privatizimit të mos shihet se do të fillojë për disa muaj por që edhe kur të rifillojë, do të ecë «si breshka».

Dështimi i UNMIK-ut në privatizim ka hidhurar shoqërinë shqiptare të Kosovës si dhe ka helmatur marrëdhëniet me IPVQ-në. Përveç ndikimit të përgjithshëm në ekonomi dhe rrezikut që shqiptarët e Kosovës të «gjejnë veten refugjatë në vendin tonë, duke jetuar në pronë të Serbisë»,²³ procesi i privatizimit ishte edhe test në të cilin do të sqaroheshin se cilin realitet të të nëntëdhjetave do ta legjitimonte bashkësia ndërkombëtare: heqjen e autonomisë së Kosovës nga Serbia apo rezistencën e shqiptarëve të Kosovës. Përderisa administrata e OKB-së më nuk përkrahte programin e privatizimit, marrëdhëniet UNMIK-IPVQ arritën në një pikë të nxehtë konfrontimi rreth fatit të shefes së AKM-së, Marie Fucci, e cila shpejt u bë një figurë e urryer nga ana e shoqërisë shqiptare të Kosovës. Përvoja e saj e mëhershme në procesin e privatizimit në Serbi, si dhe qasja e saj konfrontuese me homologët e saj shqiptarë kanë bërë të besohet se ajo po mbronte interesat serbe. Sa më shumë që udhëheqësia e UNMIK-ut e mbronte atë, duke refuzuar kërkesat e vendorëve për largimin e saj, aq më shumë krijoheshin

ishte premtuar dhënia e rrugëve të ndërtuara, shkollat, dhe mbajtja e rendit dhe aplikimi i drejtësisë. Kishin kaluar dy muaj dhe asnjëra nga këto nuk kishin ndodhur. Ne kemi dhënë besën [betimin] tek St. Dimitri, dhe se nëse asnjëra nga premtimet nuk do të ishin përmbyshur atëherë -- lamtumirë Konstitutzion"!

²⁰ Para Holkerit, në kohën e PSSP Michael Steiner, raportet në mes të UNMIK-ut dhe IPVQ ishin tendosur. Shih raportin e ICGsë, "Dy për tango", op. cit.

²¹ Kjo do të mund të ishte në pajtim me praktikën e ushtruar brenda në Serbi për pasuritë e poseduara nga republikat e tjera ish-Jugosllave Shembulli më i mirë për këtë ishte konfiskimi dhe zbatimi i privatizimit të kompanisë INA të Kroacisë. Deri më sot nuk është bërë asnjë kompenzim për INA-n.

²² Më 10 prill, PSSP Holkei bëri publik vendimin për largimin e Fuci --it si Menaxhere e AKM-së.

²³ Kryeministri Bajram Rexhepi, Intervistë e ICG-së 11 dhjetor, 2003.

bindja tek shqiptarët e Kosovës se po i bënte shërbim Beogradit duke tradhëtuar të ardhmen e tyre ekonomike.

Kështu, përkundër premtimeve edhe ashtu jo shumë të qarta se do të fillojë shqyrtimi i çështjes së tyre aty nga mesi i vitit 2005, shqiptarët e Kosovës frigoheshin se në terren po krijoheshin fakte kundër tyre që do të paracaktonin rrjedhën e bisedimeve për statusin. Kjo pasiguri shtohet edhe më nga sjella e shtuar agresive dhe e shkathtë e Beogradit që nga vitit 2003 e tutje dhe reagimet e dobëta apo joadekuate të UNMIK-ut në dy fusha të tjera: shtimin e rolit të strukturave administrative paralele të mbështetura nga Beogradi dhe perceptcionet se legjitimiteti i luftës së UCK-së ishte minuar.

B. STRUKTURAT PARALELE

Pjesa veriore e Mitrovicës dhe tri komunat veriore të dominuara me popullatë serbe kanë qenë bastione të administratës paralele të përkahur nga Beogradi që prej kohës kur KFOR-i ka konsoliduar vijën ndarëse të vënë nga serbë e Kosovës përgjatë lumit Ibër, në verën e vitit 1999.. Sidoqoftë, viti 2003 ka parë një shtrirje të strukturave paralele edhe në jug të lumit Ibër. Edhe UNMIK-u edhe KFOR-i kanë ditur, që një kohë të gjatë, se serbët ishin duke ngritur struktura paralele, pa i fshehur ato, megjithatë nuk kanë reaguar në mënyrë decisive dhe të vendosur.²⁴ Pas dështimit të UNMIK-ut - megjithëse qe deklaruar kundër - të pengojë marrjen unilaterale të qendrave shëndetësore nga strukturat paralele në Graçanicë (shtator 2002) dhe Fushë Kosovë (në vjeshtën e vitit 2003), «Qendra koordinuese për Kosovën dhe Metohinë» (CCK), e udhëhequr nga Çoviqi, filloi të përzihej edhe më shumë. Kah mesi i vitit 2003, kjo qendër kishte hapur zyrat e saj në numrin më të madh të vendbanimeve serbe, si në rajonin e Prishtinës ashtu edhe në rajonin e Gjilanit. Zyra e saj në enklavën e Graçanicës kishte krijuar departamentet e specializuara dhe i mundësonin asaj të veprojë si embrion i nyjes së qeverisë paralele në rajonin e Prishtinës. Kjo qendër «për lau» të punësuarit serb në administratën e UNMIK-ut dhe të zgjedhur në kuvendet komunale, duke premtuar «karrotën» në formë të pagave më të mëdha por edhe «shkopin»

me heqjen e të drejtës për pension për ata që do të zgjedhnin të mbesin në institucionet e Kosovës.

U shtuan thashethëmet se pjesëtarët e shërbimeve të sigurimit shtetëror serb kishin zënë vende në postet udhëheqëse të strukturave paralele. Në fillim të janarit të vitit 2004, dhe prap në fillim të shkurtit, shefi i Agjencionit të sigurimit ushtarak serb (VBA, përgjegjëse për zbulim dhe kundërzbulim ushtarak),²⁵ Momir Stojanovic,²⁶ publikisht ka provokuar shqiptarët e Kosovës dhe UNMIK-un duke pohuar se gjatë vitit që po e lëmë pas «VBA»-ja ka ri-vendosur rrjetin e agjentëve në Kosovë.²⁷ Nga roli këshilldhënës në prapaskenë, «CCK»-ja mori rol udhëheqës brenda në Kosovë. Pas një periudhe të përmirësimit gradual të raporteve, homologët e tyre shqiptarë në nivele komunale filluan t'i shkojnë përsëri me dyshimin kolegët e tyre serbë të cilët tanimë rregullisht po merrnin pjesë në takimet e shtabeve të «CCK»-së në Beograd. Kantonizimi etnik duket po ecte ashtu që ushqente shqiptarët e Kosovës me shqetësim dhe armiqësi.

Shtylla e dytë e UNMIK-ut²⁸ ishte alarmuar dhe kishte bërë përpjekje për të rivendosur rend që nga

²⁴ Shih raportin e ICG-së për Ballkan N°131, "Albatrosi Kosovar i UNMIK-ut: Ndarje me zingjirë në Mitrovicë", 3 qershor 2002.

²⁵ I njohur më herët si "KOS". Kjo ka bërë që ndër shqiptarët e Kosovës të shtohet frika nga rikthimi i ndikimit të ish-KOS-it tek minoriteti serb dhe shqiptarët e kompromituar gjatë periudhës së kolaborimit me regjimin dhe shërbimin e sigurimit të Beogradit në Kosovë gjatë viteve të 90-ta. Një gabim i pavend i bërë nga ana e UNMIK-ut gjatë një kampanje të vitit 2003, vinte në kohë shumë të papërshtatshme. Në një pano me mesazhin "Edhe unë jam kosovar", ishte përkthyer në serbisht si: "I ja sam Kosovac" - që më parë kuptohej si: "Edhe unë jam agjent i KOS-it".

²⁶ Emërimi i Stojanoviqit në krye të "VBA"-së në mars të vitit 2003, ishte ogur i zi për shqiptarët e Kosovës. Gjatë viteve 90-të ai ishte shef i "KOS"-it në Kosovë për katër vite me radhë. Si dëshmi e kësaj që thuhet më lart, në gjykatën e Tribunalit të Hagës kundër Millosheviqit në maj të vitit 2002, kishte marrë pjesë edhe dëshmitari, oficeri i ish-armatës së Jugosllavisë me emrin Stojanovic, si person përgjegjës për urdhërin për ekzekutimin e qindra shqiptarëve të Kosovës në fshatrat Korenicë dhe Mejë, më 27 prill, 1999. Shih artikullin e Institutit për raportime të luftës dhe paqes (IWPR) nga Milanka Saponja-Hadjic: "Serbia: Shefi i sigurimit i paepur në pohimet për krime të luftës", 23 maj, 2003.

²⁷ "V.I.P. Daily News Report, Kosova at a glance", 8 janar, 2004 dhe titujt e mediave të Beogradit në buletin e mediave të përpiluar nga UNMIK-u, 2 shkurt 2004.

²⁸ Struktura e UNMIK-ut është e përbërë nga katër shtylla: I) policia dhe drejtësia; II) administrata civile; III) demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve; and IV) rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik. Shtyllat I dhe II janë të udhëhequra drejtëpërdrejtë nga OKB-ja, shtylla III nga OSBE dhe shtylla e IV-të nga Bashkimi Evropian.

tetori i vitit 2003, duke paralajmëruar se punësimi paralel në «CCK» ishte në kundërshtim me kontratat e punës në shërbimet komunale. Sidoqoftë UNMIK-u kishte dështuar të reagojë në nivelet politike. Ai nuk bëri përpjekje të mbyllte nën-zyrat e reja komunale të «CCK»-së; madje as që i drejtoi një kërkesë të tillë formale zyrtare Çoviqit. Nga nëntori, shtylla e dytë tanimë ndihej e zhgënjyer me dëmin bërë themelit të brishtë të qeverisjes komunale multi-etnike. Një zyrtar i UNMIK-ut përmendi rastin e komunës së Novobërdës në rajonin e Gjilanit:

Ne patëm një situatë ideale këtu. Kryetari serb dhe nënkryetari shqiptar po punonin shumë mirë së bashku. Por tani që kryetari serb u gjet nën presionin e Beogradit, situata po përkeqësohet - dhe atë për shkak të mosangazhimit, pasivitetit dhe pranimit të presionit në heshtje nga ana jonë.²⁹

Nga pothuajse morpranimi i fenomenit të strukturave paralele UNMIK-u bëri një hap përpara kur filloi t'i bënte publike brengat e tij, atëherë kah fundi i vitit 2003. Në tetor, shtylla e III-të, e OSBE-së³⁰, botoi një raport të detajzuar të gjygjësisë paralele, administratës, sigurisë, shkollave dhe strukturave të shëndetësisë. Aty rekomandohej që këto të futeshin, me negociatave, në kuadër të administratën e unisuar të OKB-së në Kosovë pasi që shumë prej tyre vërtetë mbulonin boshllëqet në shërbime.³¹

Holkeri shtoi kritikën kundër strukturave paralele pas ndërrimit të viteve. Raporti i tij tre-mujor në Këshillin e Sigurimit, më 6 shkurt të vitit 2004, ishte

²⁹ Intervistë e ICG-së, Prishtinë, 17 nëntor, 2003.

³⁰ Përgjegjëse për demokratizim dhe ndërtim të institucioneve; shih fusnotën 28.

³¹ Në njëfarë mënyre, shqiptarët i kanë kontribuar krijimit të ambientit në të cilin Beogradi ka arritur të ngris strukturat paralele. Në nivelet komunale, gara elektorale ndërmjet partive politike të shqiptarëve të Kosovës bën që këto të mos kenë guximin të bëjnë hapa politikë që do të shihen si dhënie e një hapsire më të madhe për minoritetet. Për më shumë, resurset e pamjaftueshme, mungesa e përvojës në qeverisje, si dhe preokupimi me interesat personale nga ana e elitave vendore ka bërë të kuptohet se në tërë Kosovën, pavarësisht prej gjendjes së minoriteteve, autoritetet komunale kanë dështuar në kujdesjen për zonat periferike dhe rurale. Një komunar vendor i UNMIK-ut ka deklaruar për ICG-në në shkurt të vitit 2004: "Koncepti i multi-etnicitetit është shaka. Autoritetet komunale të shqiptarëve të Kosovës nuk çajnë kokën për një gjë të tillë fare. Për ta, kjo është një llogari e thjeshtë. Ata vetëm po luajn lojën e pritjes, po presin që të shkojnë ndërkombëtarët".

mjaft eksplicit në këtë.³² Por, për shkak se fjalët nuk u pasuan me vepra, para shqiptarëve të Kosovës UNMIK-u u duk edhe më i pafuqishëm t'i kundërvihet vendosshmërisë së Beogradit.³³

C. TRASHËGIMIA POLITIKE E LUFTËS

Moszgjidhja e statusit final për Kosovën dhe dështimi në dhënie fund luftës, në vend se ajo vetëm të «ngrihej», ka ruajtur dominimin politik të partive politike dhe figurave të cilat kanë bartur autoritetin e tyre nga koha e luftës së UÇK-së ose atyre figurave që mbështeten në mitet nacionaliste ose deklaratimet verbale për pavarësi. Në një atmosferë të tillë të gjysmë-mobilizimit, shqiptarët e Kosovës, çdo lloj cenimi të trashëgimisë së UÇK-së do t'a kuptojnë si sulm mbi shpresat e tyre për pavarësi. Që nga fundi i vitit 2002, kur u shpall dënimi i parë me burg në një proces gjygjësor të UNMIK-ut kundër figurave të UÇK-së dhe prej kur komandanti i KFOR-it, gjenerali Fabio Mini, filloi të cungonte partneritetin mes KFOR-it dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës, shumë shqiptarë të Kosovës filluan të besojnë se trashëgimia e UÇK-së po de-legjitimizohej nga misioni paqëruajtës. Në vjeshtën e vitit 2003 këto qëndrime filluan të përputhen me taktikat e shkathëta të Beogradit të tendosjes së nervave të shqiptarëve të Kosovës, të cilët e panë luftën e tyre çlirimtare të përdhoset si vepër kriminale -- e thënë edhe nga Serbia edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare.³⁴

³² Një mangësi tjetër, e madhe, e qeverisjes së UNMIK-ut është pamundësia e përfaqësimit të interesave të Kosovës në botë, veçanërisht në Serbi dhe vende të tjera fqinje. Jashtë Kosovës, UNMIK-u nuk është vetëm më shumë se një mjet raportues, me staf shërbyes nga shtetet përbërëse të OKB-së pa qëndrim në marrëdhëniet me vet këto shtete. UNMIK-ut i mungon spektri i roleve që kanë qeveritë, siq janë mbrojtja dhe punët e jashtme, gjëra këto të cilat një qeveri do të duhej t'i kishte. Gajtë vitit 2003, Beogradi e kishte tejkaluar UNMIK-un në lojën politike, për shkak se ky i fundit nuk ishte në gjendje të vepronte në shumësi nivelesh. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2003, përderisa UNMIK-u ishte i zënë në "luftën" në nivel të lartë diplomatik me Beogradin për çështje të dialogut dhe standardeve, në të njëjtën kohë Beogradi po sabotonte në mënyrë aktive UNMIK-un në nivelet komunale.

³³ Në këtë aspekt politika e veprimit të Holkerit ndryshon nga paraardhësit e tij. Sidoqoftë, paraqitja e tij në programin TV21 "Sy me Sy", më 25 shkurt të vitit 2004 (ai asokohe po vuante nga influenza, por shikuesit nuk e kishin kuptuar këtë.) si dhe intervista tjetër dhënë BBC-së, Jackie Rowland më 26 mars, nuk i kishin ndihmuar atij.

³⁴ Gjenerali Mini ka gravituar me një proces rritjeje rreth përmirësimit të raporteve të sigurisë me Serbinë. Në verë të

Elementet kriminale si rezultat i kësaj kanë shfrytëzuar këtë refleks të nervozizmit duke u mbështjellur me petkun e UÇK-së.

Gjenerali Mini, i cili ka komanduar forcat e KFOR-it nga tetori i vitit 2002 gjer në tetorin e vitit 2003, ka konsideruar rrjetin e krimit të organizuar, strukturat shoqërore tradicionale të shqiptarëve të Kosovës, UÇK-në dhe strukturën që e trashëgoi, TMK-në, si struktura që nuk mund të ndahen nga njëra tjetra,³⁵ një pikëpamje kjo që është pohuar dhe promovuar edhe nga Beogradi. Mosbesimi i tij në TMK-në ka shkaktuar tërheqjen e oficerëve trajnues të KFOR-it nga TMK-ja aty nga fundi i vitit 2002, dhe vënien e një regjimi inspektues e kontrollues. Pas aktit të pamenduar të Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH) të përpjekjes për të hedhur në erë urën hekurudhore të Llozishës, në prill të vitit 2003, me ç'rast një anëtar i organizatës, pjestarë i TMK-së, e kishte hedhur veten në erë, KFOR-i dhe UNMIK-u filluan një hetim të vazhdueshëm të personelit të TMK-së, veprim ky që rezultoi me vendimin e Holkerit, në dhjetor të vitit 2003, për suspendimin e dymbëdhjetë pjestarëve të TMK-së për gjashtë muaj, edhe pse shumica e shqiptarëve nuk ishin të bindur me dëshmitë e ofruara. Shefi i TMK-së, Agim Çeku, dhe kryeministri i Kosovës, Rexhepi, fillimisht refuzuan të pranonin këto suspendime, ndërsa Ombudspersoni i Kosovës, Marek Nowicki, karakterizoi trajtimin e oficerëve të suspenduar shkelje flagrante të të drejtave të tyre. TMK-ja njëherë ishte e hutuar, pastaj e shqetësuar dhe përfundimisht e zemëruar me KFOR-in. Në dhjetor të vitit 2003, Gjenerali Çeku u kishte thënë njerëzve të KFOR-it: «Njerëzit e mi kanë filluar t'ju gënjejnë juve», pasi që më nuk po besojnë në atë se si do t'i përdorë KFOR-i informatat e marra prej tyre.

Edhe pse Holkeri ishte përpjekur që të zbusë gjendjen e trashëguar nga Gjenerali Mini, aftësia e kufizuar e UNMIK-ut për të mbrojtur liderët e institucioneve të Kosovës që kishin lidhje me UÇK-në nga dora e zgjatur e Beogradit doli në skenë me rastet e arresimeve të Çekut në aeroportet e Evropës në tetor të vitit 2003 dhe në shkurt të vitit 2004, në

bazë të një urdhërarresti të Interpolit serb. Për shqiptarët e Kosovës çdonjëra nga këto arrestime të shkurtëra të njërës prej figurave më të popullarizuara ishte poshtërim. Arrestimet u tregonin atyre se për bashkësinë ndërkombëtare vlejné vendimet e gjyqeve të kohës së Milosheviqit të zhvendosura pas luftës në qytetet e Serbisë ndërsa se liderët kosovarë me të kaluar nga UÇK-ja janë në rrezik nga nënçmimet e tilla sa herë që të dalin jashtë vendit.

Partneriteti në fushën e sigurisë u përkeqësua edhe më nga gjuha e përdorur nga ndërkombëtarët për të përshkruar luftën dhe i shtyu ata që të «mbajnë llogari» për dënimet për krime luftime që u shpalleshin atyre. Kur një zëdhënësi i UNMIK-ut, në tetor të vitit 2003, tha se në Kosovë nuk ka pasur luftë por vetëm intervenim të armatosur, u reaguua me zemërim.³⁶ Për shqiptarët e Kosovës kjo ishte zhvlefësim i vuajtjeve të tyre dhe degradim në rolin e përfituesve pasivë të bombardimeve të NATO-s, sikur UÇK-ja të mos kishte luajtur rol fare. Kur në korrik të vitit 2003 një gjyq i UNMIK-ut e dënoi një ish-komandant të UÇK-së, Rrustem Mustafën («Komandant Remin»), me shtatëmbëdhjetë vite burg nën akuzën për ushtrim të torturës dhe vrasjeve kundrejt shqiptarëve të arrestuar gjatë luftës, shumë njerëz e krahasuan këtë me dënimin e shqiptuar nga një gjyq tjetër i UNMIK-ut serbit Veselin Beshoviq, i shpallur fajtor për vrasje të kryera gjatë kohës së luftës në kuadër të një grupi paramilitar serb.³⁷ Ngritja e padiasë nga ana e Tribunalit të Hagës për Krime Luftime në ish-Jugosllavi (anglisht ICTY) në shkurt të vitit 2003 kundër liderit të popullarizuar, nënkryetarit të PDK-së, Fatmir Limajt, si dhe kundër disa bashkëluftëtarëve të tij nga UÇK-ja, ishin parë nga shumë shqiptarë të Kosovës si përpjekje e bërë nga ana e Tribunalit për të shtuar bashkëpunimin me Beogradin. Krimet për të cilat ishin akuzuar Limaj dhe kolegët e tjerë shqiptarë të Kosovës ishin kuptuar si akuza të nivelit më të ulët sesa ato që paraqiteshin zakonisht në portën e Tribunalit (krimet më të vogla u ishin lënë gjyqjeve vendore).

vitet 2003, ai propozoi që sigurimi për Kosovën në të ardhmen të bëhet nga një forcë rajonale duke përfshirë këtu edhe trupat serbe. Në shtator të vitit 2003, ai i raportoi PSSP-së, Holkerit nga materiale të marrura nga shërbimet e sigurimit serb me pretendim në rrjetin kriminal të UÇK-së.

³⁵ Fabio Mini: *La Guerra Dopo la Guerra. Soldati, Burocrati e Mercenari nell'Epoca della Pace Virtuale*, Einaudi, 2003.

³⁶ Izabella Karłowicz në konferencën javore të UNMIK-ut më 31 dhjetor të vitit 2003. Komenti do të mund të kishte qenë vetëm "trëshqitje e gjuhës".

³⁷ Privatisht, UNMIK pranoi se "kjo është e paaryetueshme para publikut" -- pavarësia e tepërt e gjyqtarëve shkaktonte dallime në dënime. Disa gjyqtarë kanë marrë për bazë presedanet e ICTY-së, të tjerë nuk e kanë bërë këtë. Sistemi gjyqësor ende është i ri ndërsa UNMIK-u ka shpresuar se Gjyqi Suprem i Kosovës do të duhej të vendoste standardet gjatë procesit.

Me rastin e arrestimit të Komandantit të TMK-së për Prizren, Selim Krasniqi dhe disa oficerëve të tjerë më 16 shkurt të vitit 2004, me një akuzë të UNMIK-ut për krime lufte, UNMIK--u kishte siguruar se ky nuk ishte sulm kundër organizatës së shikuar me skepticizëm. Një aktivist vendor kishte komentuar: «Është njësoj sikurse të thuash se po forcon shtëpinë duke hequr tullat nga muret e saj».³⁸ Demonstrata ishin organizuar nga shoqatat e veteranëve të UÇK-së në Prizren, Malishevë dhe Skenderaj.

IV. PARALAJMËRIMI I DHUNËS

Nëse dhuna e 17 e 18 marsit të vitit 2004 filloi në mënyrë spontane, vazhdimi i saj e sidomos pezullimi më 19 mars zbuloi organizatat që pohonin të kenë zotëruar dhe drejtuar atë që në mënyre eufemistike e quajtën «protestë». Grupet që «bënë skena» duke lëshuar deklarata më 19 mars, siq janë tri shoqatat «e dala nga lufta» - e veteranëve të UÇK-së, invalidëve të UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve, si dhe Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës (UPSUP) - kishin qenë në ballë të protestave dhe agjitacionit anti-UNMIK për shumë muaj me rradhë.

Së bashku me partitë e vogla politike, ekstremiste, LPK dhe LKÇK, kishin filluar të binin në sy me protestat kundër UNMIK-t të mbajtura në qendër të Prishtinës në tre muajt e fundit të vitit 2003. Më 14 tetor të vitit 2003 ata kishin protestuar kundër dialogut me Beogradin, që po zhvillohej po atë ditë në Vjenë. Më 12 nëntor të vitit 2003 ata ishin paraqitur në skenë me një demonstratë kundër UNMIK-ut. Me gjithë angazhimin, ata asnjëherë nuk ishin në gjendje të tërheqin më shumë se 3.000 deri në 4.000 njerëz në demonstratat e tyre në Prishtinë, ndërsa shumica e demonstruesve ishin sjellur nga jasht qytetit. Madje, organizatorët as që dalloheshin me kohezion mes vete. Përderisa UPSUP-i dhe të tri shoqatat e dala nga lufta kishin marrëdhënie të ngushta, partitë e vogla politike nuk kishin simpati të veçanta për njëra tjetrën. Megjithatë, asnjë nga këta nuk dëshironte të mbetej jasht lojës. LKÇK-ja dallohej me armiqësi të shprehur kundër UNMIK-ut; LPK-ja dallohej me kritikë kundër IPVQ-së.

UNMIK-u dhe KFOR-i i vëzhgonte nga afër këto grupe, të brengosur se këta paraqitnin fytyrën publike të një konstelacioni të rrjeteve të ekstremistëve, studentëve më radikalë dhe komuniteteve rurale të zemëruara e të marginalizuara nga njëra anë dhe kriminelëve ekstremistë e violentë nga ana tjetër. Në tërë këtë, LPK-ja kishte tërhequr vëmendjen edhe me prezencën e përditëshme në qendër të Prishtinës, për disa javë me rradhë, gjatë muajve të fundit të vitit 2003, duke mbledhur nënshkrime për një peticion me të cilin kërkohesh bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet.

Tre mujori i fundit i vitit 2003 kishte parë politikanët shqiptarë të Kosovës të shfrytëzojnë elementët ekstremistë si leva në negociatat e tyre me

³⁸ Intervistë e ICG-së me Bexhet Shalën, Drejtor ekzekutiv i OJQ-së "Këshilli për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut", Prishtinë, 20 shkurt, 2004.

bashkësinë ndërkombëtare. Duke komentuar demonstratat e 14 tetorit 2003 në Prishtinë, kryeministri Rexhepi kishte thënë: «Nuk dëshirojmë të shohim protesta dhe parulla të tilla, por nëse UNMIK-u vazhdon të injorohet nevojat tona, nëse refuzon të transferojë më shumë pushtet në ne, atëherë ndërkombëtarët këtu do të ballafaqohen me demonstrata më të mëdha dhe çdonjëri nga pjesëmarrësit do të kërkojë 'UNMIK shko në shtëpi'». ³⁹ Në fund të shtatorit, presidenti Rugova paralajmëroi se nëse pavarësia e Kosovës nuk do të pranohej sa më shpejt, munt të pritej nga ekstremistët që të provonin të formonin një shtet të bashkuar shqiptar. ⁴⁰

IPVQ-ja tani shikonte kah ekstremistët duke nxjerrur në shesh ndjenjën e pasigurisë së saj se do të shihej si bashkëpunëtorë e dominimit të UNMIK-ut në Kosovë, qëndrim ky të cilin e mbante në jetë iniciativa e nëntorit 2003 e Grupit të Kontaktit.

Një kriter që tregon shtimin e potencialit për ekstremizëm në vitin 2003 ishte edhe fenomeni i Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH). Ajo ishte aktive kryesisht në Maqedoninë Veriore dhe Serbinë Jugore, ⁴¹ përveç një veprimi të saj të pamatur në Kosovë - vendosja e eksplozivit në urën e linjës hekurudhore afër Mitrovicës - por që tani i dha një emër, një slogan, një pikë referuese kriminelëve dhe të pakënaqurve e rinisë rebeluese. AKSH-ja u përhap në formë të mbishkrimeve në stacione të autobusëve nëpër fshatra por edhe si kërcënim që e përdornin kriminelët për të grabitur para. ⁴²

A. DHUNA DHE SIGURIA

Me apo pa një akronim, gjatë viteve 2003 dhe vitit 2004, ekstremistët kanë vazhduar të kenë në shënjestër serbët e Kosovës duke ngritur pasigurinë e këtij komuniteti, përkundër trendeve të prëgjithshme të rënies së krimit të përgjithshëm dhe atij ndër-etnik. Komuniteti ortodoks serb në Kosovë ka deklaruar se kishat dhe manastiret e tij kanë qenë

vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike në shënjestër. Shumë prej tyre ishin shkatërruar gjatë periudhës që daton nga hyrja e trupave të NATO-s në provincë në qershor të vitit 1999 deri në fillim të vitit 2000. Mëpastaj, deri më 17 mars të vitit 2004, sulmet ishin më shumë sporadike. Dy ditë para trazirave, pikërisht më 15 mars, peshkopi Artemije, në një letër të drejtuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kishte shkruar lidhur me atë se si shqiptarët kishin shkatërruar ose seriozisht kishin dëmtuar 112 kisha ortodokse serbe në Kosovë, 33 prej të cilave datonin nga Serbia e mesjetës së herëshme, e shekujve XIV-XVI. ⁴³ Shumë serbë kishin fituar përshtypjen se shqiptarët ishin duke provuar të largojnë çdo shenjë që tregonte se serbët ndonjëherë kishin jetuar në Kosovë.

Sulmet kundër individëve kanë përcjellur ato kundër pasurisë. Në fillim të qershorit të vitit 2003, një çift i vjetër dhe djali i tyre ishin keqtrajtuar dhe prerë për vdekje ndersa shtëpisë së tyre i ishte vënë zjarri në qytetin e Obiliqit. Një vrasje tjetër tronditëse kishte ndodhur më 13 gusht të vitit 2003, kur me gjasë dy sulmues të fshehur në kaçuba kishin shtënë me automatikë kallashnikovë në fëmijë dhe të rinj serbë që po laheshin në lumin Lumbardhi i Pejes, në mes të fashatit serb Gorazhdec dhe fshatit shqiptar Zahaqit. Dy kishin mbetur të vrarë dhe katër të plagosur. Vrasësit me siguri kanë ikur në strehën e përgatitur më herët në Zahaq. Sulmi shkonte në vijë me paragjykimet serbe se shqiptarët janë vrasës të fëmijëve, ⁴⁴ duke tërhequr kështu një masë të madhe të vëmendjes së mediave serbe dhe duke nxitur emocione në Serbi. Një vrasje tjetër provokative kishte ndodhur në mbrëmjen e 19 shkurtit të vitit 2004. Dy serbë të

³⁹ Helena Smith: "Kosovarët e nervozuar thërrasin OKB-në forcë 'koloniale', kërkojnë të largohet", *The Observer*, 19 tetor, 2003.

⁴⁰ Agjencioni i lajmeve Beta, Beograd, 19 shtator 2003, ka cituar një intervistë dhënë radios çeke më 18 shtator, 2003.

⁴¹ Shih raportin e ICG-së për Evropë No. 152, "Paqja e Brishtë në Serbinë Jugore", 9 dhjetor 2003.

⁴² Shih raportin e ICG-së No. 153, "Pan-Shqiptarizmi: Sa është kërcënim për stabilitetin në Ballkan?", 25 shkurt 2004.

⁴³ Qendra koordinuese gjithashtu kishte mbledhur dokumente të detajizuara të titulluara "Spomenici kulture na Kosovu i Metohiji" që jep detaje të hollësishme rreth çdo kisha të shkatërruar.

⁴⁴ Një stereotip fatkeq që serbët dhe shqiptarët kanë për njëri tjetrin. Çdo komunitet thotë për tjetrin se është në gjendje të instrumentalizojnë fëmijët e tyre për të nxirë reputacionin e komunitetit tjetër. Shumë shqiptarë të Kosovës ishin të gatshëm të besojnë se agjensionet e sigurimit serb qëndronin prapa vrasjeve në Gorazhdec. Për rastin mbytjes së tre fëmijëve shqiptarë në lumin e Ibrit më 16 mars, Çoviqi kishte deklaruar se dy nga fëmijët e vrarë ishin bijtë e Kadri "Luli" Veselit, ish-pjestar i UÇK-së dhe se ai kishte punuar në mënyrë aktive për të instrumentalizuar djemët e tij. Në gazetën "Bota Sot", më 8 prill 2004, aktivisti për të drejtat e njeriut, Halit Berani, pohoi se: "Serbët janë të talentuar dhe qysh në vitin 1980 ata keqpërdorën fëmijët e tyre të vdekur si dhe dhunuan një grua të vjetër serbe duke ua lënë fajin për një gjë të tillë shqiptarëve".

Kosovës ishin vrarë në Lipjan kur afërsisht 50 plumba ishin shkrepur në veturën e tyre. Ishte raportuar se një të shtëna ishin dëgjuar në një lokacion tjetër në afërsi, pak para vrasjes së dyfishtë, sigurisht për të tërhequr forcat e sigurimit nga vendi i ngjarjes. Edhe Beogradi edhe serbët e Kosovës ishin ankuar zëshën, duke i bërë thirrje KFOR-it që të bënte më shumë në përmirësimin e gjendjes së sigurisë.

Çdonjëra nga këto vrasje ishte përcjellur me zemërim dhe organizim të demonstratave nga serbët e Kosovës, madje edhe me sulme fizike kundër shqiptarëve që kalonin nëpër enklavat serbe. Tensionet e ngritura nga vrasjet e tilla kanë bërë që të gjitha aktet e pasqaruara të dhunës të presupozohen të jenë të motivuara etnikisht ndërsa kjo ka shtuar shqetësimet e opinionit publik. Përleshje të mëdha mes fshatrave fqinje shqiptare e serbe kishin shpërthyer kur një i ri serb nga fshati Suhodoll/Suvido, afër të Lipjanit, ishte qëlluar dhe plagosur gjatë kremtimeve të vitit të ri ortodoks, në javën e dytë të janarit të vitit 2004. Edhe pse organet e sigurisë dyshojnë se ai e kishte qëlluar veten aksidentalisht, për plagosjen e tij ai kishte fajësuar persona që kishin shtënë nga një veturë. Serbë reagues me bllokimin e rrugës, duke lënë të shkëputura fshatra shqiptare, të cilat mëpastaj luftuan për të hapur rrugët.

Ashtu siç kanë toleruar strukturat paralele serbe në veri të Mitrovicës dhe në tri komunat në veri të Lumit Ibër që të kenë monopol mbi dhunën, nga mesi i vitit 2003 KFOR-i dhe UNMIK-u dhanë sinjale të qarta se do të mbesin të heshtur edhe kur sfidohen nga grupet militare të shqiptarëve të Kosovës. Në verën e vitit 2003, shoqatat rajonale të veteranëve të UÇK-së vërshuan qytetin e Prizrenit dhe vendosën statujat e dy komandantëve të UÇK-së të vrarë në luftë në dy sheshet kryesore historike të qytetit. Ata e bënë këtë në kundërshtim të hapur me vendimin e autoriteteve komunale të kontrolluara nga LDK-ja, policisë dhe trupave të KFOR-it, që ishte në kontrast të plotë me përpjekjet e para për t'a bërë një gjë të tillë në vitin 2001, kur e tërë tentativa ishte refuzuar vendosmërisht nga policia. Forcat e sigurisë nuk patën guxim të largojnë përmendoret duke pasur frikë nga kërcënimet implicite nga shpërthimi i dhunës. Kështu, «farat» e disfatës së policisë dhe trupave gjermane të KFOR-it në

Prizren, më 17 dhe 18 mars të vitit 2004, ishin mbjellur disa muaj më heret.⁴⁵

Muajt e fundit të vitit 2003 dhe ata të fillimit të vitit 2004, kishin parë të heqet tabuja e ushtrimit të dhunës kundër paqëruajtësve ndërkombëtarë. Trupat franceze të KFOR-it për pak kishin shpëtuar nga belaja në fshatin Prekaz, kur anëtarë të familjes Jashari, militantë të UÇK-së, ua drejtuan armët pasi që ushtarët në patrullë ishin vërtitur rreth kompleksit shtëpiak, duke hyrë edhe në oborr, më 25 tetor. Ky vend është i shenjtë ku nderohen 56 burra, gra dhe fëmijë të vrarë në një betejë dy-ditore me forcat serbe të sigurisë, që edhe shënoi fillimin e luftës në mars të vitit 1998. Tërheqja e francezëve simbolizonte humbjen e autoritetit të KFOR-it. Kjo u pa përsëri më 13 nëntor kur serbë të zhvendosur që po vizitonin shtëpitë e tyre në fshatin Mushtisht, nën përcjelljen e KFOR-it, u sulmuan me gurë nga fqinjët shqiptarë ndërsa mjete shpërthyesë u gjetën në disa nga shtëpitë e braktisura. Ditën tjetër, një epror i KFOR-it u shpreh: «Nuk mund të përshkruaj sa i brengosur jam që personat e zhvendosur janë sulmuar edhe pse ishin të përcjellur nga KFOR-i dhe me faktin se ne u desh të shtiejmë në ajër. Autoriteti i uniformës sonë përnjëherë është zhdukur.»⁴⁶

Përkundër kësaj, duke besuar propagandën e tyre për përmirësimin gradual të gjendjes,⁴⁷ KFOR-i dhe UNMIK-u kanë vazhduar «të normalizojnë» gjendjen e sigurisë në qytetin e ndarë të Mitrovicës. Më 6 nëntor të vitit 2003, KFOR-i i kishte dorëzuar përgjegjësinë për «ish»-pikën e nxehtë -- urën kryesore të Mitrovicës - policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor multi-etnik të Kosovës. Me largimin e postbloeve, barrierave dhe me heqjen e

⁴⁵ Në janar dhe shkurt 2004, komuniteti serb i Kosovës ishte ankuar në KFOR-in gjerman për përkrahje të shqiptarëve ua kishin ndërpreë përcjelljen edhe pas një incidenti që kishte ndodhur më 21 janar kur një veturë e KFOR-it gjerman ishte sulmuar derisa po barte një ekip të televizionit i cili po bënte filmimin e një kishe të shkatërruar ortodokse në Gjakovë. Shih ERP KiM Newsletter, 3 shkurt 2004: "Monks of Holy Archangels Monastery pressured by German KFOR after reporting truth about Djakovica incident".

⁴⁶ Intervistë e ICG-së, 14 nëntor 2003.

⁴⁷ Edhe debaklet, si ai i shtatorit të vitit 2003, për amnestinë e armëve nuk lëkundin besimin e autoriteteve se gjendja e sigurisë po përmirësohej. Duke synuar grumbullimin e mijëra armëve, programi për amnesti kishte regjistruar vetëm 155 armë të zjarrit të dorëzuara, që demonstroi mungesën e besimit të komuniteteve shqiptare dhe serbe në pohimin e gjeneralit Mini kur thoshte se "armët e kanë vendin në muze". Filmimet televizive të liderëve kosovarë nuk kishin treguar efekt.

prezencës vizibile të KFOR-it, UNMIK-ut dëshironte të thoshte se «Policia e re e Kosovës është në gjendje t'a marr kontrollin... Njerëzit e Mitrovicës nga të dyja anët e lumit Ibër, kanë mbështetur këtë kalim të përgjegjësive».⁴⁸ Masat e «normalizimit» bënë që shumë banorë, në veçanti serbët e Mitrovicës, të ndihen më pak të sigurtë. Një serb i Mitrovicës në nëntor të vitit 2003 kishte deklaruar për ICG-në se tërheqja e KFOR-it nxiste ndjenjë të njëjtë pasigure sikur edhe shpërbërja e «Rojëve të Urës»⁴⁹, duke thënë se:

Nuk kam pasur guxim të shkoj me birin tim në Dolce Vita [një resoran pranë urës] në tre muajt e fundit. Nuk do ta dërgoj as 100 metra afër urës tani... SHPK-ja në veri është sikurse Partia e të Gjellbërve në Londër. Ata nuk kanë forcë as të mbrojnë vetveten. Është vetëm çështje kohe se kur do të ndodhë ndonjë krim ose tragjedi në veriu e Mitrovicës. Kështu më paralajmërojnë shokët e mi shqiptarë.

Një incident i shkurtë, i dhunshëm, në pjesën veriore të Mitrovicës, më 6 dhjetor të vitit 2003, kishte ilustruar këtë pasiguri por edhe kishte forcuar bindjen e shqiptarëve se UNMIK-u po privilegjonte serbët e Kosovës - duke aplikuar standardet e mirësjelljes vetëm për shqiptarët e madje edhe duke i poshtëruar ata. Kryeministri Rexhepi i ishte bashkuar për drekë një delegacioni të Bankës Botërore në një restoran në pjesën veriore të Mitrovicës. Policia vendore dukej të kishte qenë e painformuar për këtë rast, ndërsa rojet e kryeministrit, që të gjithë shqiptarë, kishin zënë vend në hyrje të restorantit duke bërë roje. Me të parë

⁴⁸ "SHPK-ja trashëgon urën e famëshme ", nga Gyorgy Kakuk, Në gazetën "Kosova në focus" të UNMIK-ut, dhjetor, 2003.

⁴⁹ Strukturë paramilitare e krijuar nga serbët e Mitrovicës dhe nga personat e zhvendosur, në verën e vitit 1999, me qëllim të mbrojtjes së urës në lumin Ibër nga depërtimi i shqiptarëve të Kosovës. Sipas serbëve të Mitrovicës, "Rojet e Urës" kanë penguar spastrimin etnik të serbëve të veriut të Kosovës, posaçërisht gjatë dy muajve të pare pas marrjes nën kontroll së vendit nga forcat e NATO-s, në vitin 1999. Rojet e urës më vonë u konsoliduan dhe u financuan nga Ministria e Brendshme e Serbisë dhe nga burimet lokale. Duket se zyarisht ata janë shpërbërë pas marrëveshjes së arritur nga ish-PSSP Steiner dhe përfaqësuesi i Beogradit për Kosovë, në vitin 2002-2003. Edhe pse "Rojet e Urës" ishin të njohur për involvimin e tyre në krimin e organizuar, shumica e serbëve të Mitrovicës shprehin keqardhje për shpërbërjen e kësaj organizate pasi që sipas tyre, shumica e anëtarëve të saj kanë qenë njerëz të rëndomtë që po i mbronin familjet e tyre. Shih raportin e ICG-së, "Albatrosi Kosovar i UNMIK-ut", op. cit., për më tepër sqarime.

shqiptarët e armatosur në territorin e "tyre", reagoi refleksi mbrojtës agresiv i serbëve të Mitrovicës dhe menjëher u mblodh një turmë të armatosur me gurë. Ata sulmuan restorantin nga të dyja anët. As policia vendore e as KFOR-i nuk dolën në ndihmë. Rexhepi ishte larguar nga vendi i ngjarjes, por përlëshja kishte vazhduar duke ndjekur delegacionin e Bankës Botërore dhe autobusin e tyre deri në oborrin e spitalit. Zyrtarë rajonal të UNMIK-ut reagues me komunikatat për shtyp duke fajësuar Rexhepin për mosinformim të njaftueshme lidhur me vizitën, duke identifikuar si cak të sulmit delegacionin e Bankës Botërore e jo vet kryeministrin. Si kundër-reagim, mediat shqiptare të Kosovës shfryen mllëfin mbi UNMIK-un pse fajësonte Rexhepin dhe për shkak se po sugjeronin se ai nuk ka të drejtë të shkojë ku të dojë në Kosovë. Incidenti kishte ringjallur zemërimin e shqiptarëve me *de-facto* konsolidimin e ndarjes së Kosovës nga ana e KFOR-it përgjatë lumit Ibër. Shqiptarët gjithashtu kishin vërejtur se asnjë nga sulmuesit nuk ishte arrestuar, edhe pse kishte filmime që tregonin personat pjesëmarrës në incident. Për dallim nga kjo, policia e UNMIK-ut në fshatin Mushtisht kishte arrestuar tre shqiptarë nga ata që kishin hedhur gurë e që ishin identifikuar mu nga filmimet e ngjarjes së 13 nëntorit.

Disa nga udhëheqësit kryesorë të shqiptarëve të Kosovës kishin dënuar sulmin me gurë të fshatarëve në Mushtisht, por në një intervistë televizive më 6 dhjetor, lideri serb i Mitrovicës Oliver Ivanoviq kishte akuzuar kryeministrin Rexhepi se kishte provokuar serbët. Këto dy mëyra krejt të kundërta të reagimit duket se zbuluan se politikanët e Kosovës, duke pranuar sistemin e UNMIK-ut, ishin vënë në pozitë kur vazhdimin e vihej barra e fajit, ndërsa distanca që mbanin homologët e tyre serbë i bënte ata më të respektueshëm dhe u «jepte leje» të sillen keq pa u ndëshkuar.⁵⁰

⁵⁰ Akomodimi që UNMIK-u kishte arritur me liderin e komunitetit serb në Mitrovicën Veriore, Milan Ivanoviq, ishte rast për shqyrtim. Të dhënat e filmimeve që ishin bërë më 8 prill të vitit 2002 paraqiste atë qartë duke hedhur një granatë. Pas disa muajve të shmangjes së policisë, zëvendëskryeministri i Serbisë ishte kërcënuar për ndërprejen e kontakteve me UNMIK-ut pas përpjekjeve për arrestimin e e tij, më 8 gusht të vitit 2002. Ivanoviq ishte dorëzuar në tetorin e vitit 2002. Ai ishte akuzuar për udhëheqje të protestave të dhunëshme, ishte lejuar që të merrte pjesë në zgjedhjet komunale si dhe në vjeshtë të vitit 2003 kishte marrur një pezullim të burgimit në afat prej tre muajve.

Shqiptarët e Kosovës ishin të gatshëm të jetojnë me atë që ata e konsideronin kritikë disproporcionale ndërkombëtare brenda një partneriteti, derisa ky shpiente andej kah këta dëshironin. Sidoqoftë, sa më shumë që shihnin shenja që i bindnin se këto kritika ishin maskë e një politike që nuk ofronte asgjë më shumë se sa shtyerje dhe pajtim me Beogradin, aq më shumë shtoheshin prirja e tyre për rebelizëm. Bashkësia ndërkombëtare ka ecur një kohë të gjatë në cep të greminës, duke avokuar sigurinë dhe përfshirjen e minoriteteve në Kosovë, në një anë, dhe duke lejuar që «mantra» e multietnicitetit të degjenerojë në një mjet në dëm të shumicës shqiptare, në anën tjetër. Të dalë nga një dekadë e tërë e shtypjes së identitetit të tyre etnik në mënyrë sistematike dhe përjashtimit nga institucionet shtetërore, dhe pas përafërsisht dy dekadave me rradhë të portretizimit në mediat serbe si primitivë, agresivë, terroristë, përdhunues e madje edhe gjysëm-njerëz, shqiptarët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre politikë ishin të gatshëm që çdo kritikë ta interpretojnë si një kapitull të ri të persekutimit.

Në Prishtinë, përkeqësimi gradual i gjendjes së sigurisë shfaqej përmes mjeteve shpërthyes. Në dhjetor të vitit 2003 granata ishin vënë në dy vetura të policisë së UNMIK-ut, por ato kishin dështuar të eksplodojnë. Katër kilogram të TNT-së me mekanizëm të orës ishin zbuluar afër selisë kryesore të UNMIK-ut më 6 mars 2004, pas një paralajmërimi i cili ishte bërë policisë nëpërmjet të një thirrjeje telefonike. Kjo shënoi fillimin e fenomeneve me kërcënime të vërteta e të rrjshme me bomba; dy shpërthime të vogla më 9 mars në Prishtinë, një granatë dore e hedhur në rezidencën e Presidentit Rugova në Prishtinë më 12 mars; dhe një mjet shpërthyes i gjetur jasht shtabit të UNMIK-ut, në pjesën jugore të Mitrovicës më 13 mars.

Cikli i komemoracioneve të UÇK-së më 3 dhe 7 marsit kishte grumbulluar numër të madh njerëzish në Prishtinë dhe në Prekaz dhe kishte ripërqëndruar vëmendjen e opinionit publik në kritikën se «lufta për çlirim» nuk gëzonte respektin e merituar. Duke iu drejtuar masës, një pjesë e madhe e së cilës kishte udhëtuar nga zemra e Drenicës, në një koncert të mbajtur në stadiumin e Prishtinës, lideri i PDK-së, Hashim Thaçi, kishte deklaruar se Kosova nuk mund të jetë e lirë derisa të mos liroheshin nga burgu (për çfarëdo lloj krimi) të gjithë pjesëtarët e ish-UÇK-së. «Zëri», më 5 mars, në ballinë pyeste: «A po korritemi me Jasharët?» Aty shtrohej çështja nëse është bërë

mjaft për ndërtimin e kompleksit memorial të Jasharajve në Prekaz për të përkujtuar sakrificat e tyre për Kosovën.

B. FITILI NDEZET

Me përmirësimin e motit të dielen, më 14 mars 2004, java që pasonte ishte paraparë për demonstrata: më 16 mars ato për UÇK-në e më 18 mars ato të BSPK-së me kërkesat për rifillimin e privatizimit dhe për përjashtimin e Fuccit.

Por, në mbrëmjen e 15 marsit, një i ri serb qëllohet me armë zjarri dhe plagoset në fshatin serb, Çagllavicë, mu në të dalë të Prishtinës, në autostradën që lidhë atë me Maqedoninë. U tha se ishte edhe një rast tjetër i të shtënave nga vetura. Për serbët ky ishte edhe një incidentet tjetër i papranueshëm "terrorist" dhe prësëri ndien se KFOR-i dhe UNMIK-u nuk kujdeseshin sa duhet. Ata reguan ashtu siç edhe mund të merrej me mend, duke bllokuar rrugën.⁵¹ Në shenjë solidariteti, më 16 mars, serbët e Graçanicës e bllokuan edhe ata rrugën Prishtinë-Gjilan/Gnilane, duke shkëputur kështu lidhjen e Prishtinës me pjesën jugore të Kosovës. Shoferët shqiptarë të cilët provuan të kalojnë përmes bllokadës u rrahën nga fshatarët serbë⁵². Në Çagllavicë, turma serbe ia dha zjarrin një veture të policisë ndërsa dy ushtarë të KFOR-it u desh të shtiejnë me armë në ajër kur u sulmua një shtëpi e shqiptarëve. Mllef i shqiptarëve shtohesh edhe më shumë pasi KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut lejonin që një grusht fshatarësh serbë, me arrogancë që tregonte vetbesim të lartë, të mbanin të shkëputur një kryeqytet me më shumë se 500,000 banorë shqiptarë. Për serbët sjellja e tyre mund të jetë dukur mënyra e vetme për të tërhequr vëmendjen u UNMIK-ut por në sytë e shqiptarëve të Kosovës, ata tregonin se si një minoritet prej me pjesëmarrj prej 5 për qind në numrin e popullatës ka mbetur dominant, grupi më i favorizur etnik në Kosovë.

⁵¹ Bllokimi i rrugëve është metodë e protestimit në tërë territorin e ish Jugosllavisë. Shpesh, kjo është mënyra e vetme e qytetarëve për tërheqjen e vëmendjes të përndryshe një burokracie të papërgjegjshme të strukturave qeverisëse.

⁵² Ibrahim Makolli nga Këshilli për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut ka pohuar se 68 shqiptarë të Kosovës janë rrahur në Çagllavicë dhe Graçanicë më 16 mars, gazeta "Epoka e Re", 3 prill, 2004.

Kah mesditëa, nëpër qytetet e Kosovës u mbajtën demonstrata të "shoqatave të dala nga lufta" (ku ende shfaqej zemërimi me arrestimet për krime lufte të figurave të larta të TMK-së në Prizren, më 16 shkurt). Millefi kundër ndërkombëtarëve ishte i dukshëm. Gazeta pro-UÇK, «*Epoka e Re*», mëngjesin e së nesërme kishte botuar në ballinë një parullë që ishte hedhur në Pejë: «UNMIK mos u ngut, UCK-ja t'kallë barut!»

Në mbrëmjen e 16 marsit, RTK-ja -- kanali televiziv publik i Kosovës -- transmetoi një intervistë me një djalosh dymbëdhjetëvjeçar nga fshati shqiptar Çaber që shtrihet në bregun verior të lumit Ibër afër Mitrovicës. Edhe pse djaloshi nuk e tha këtë në mënyrë eksplicite gjatë intervistës, gazetaret raportuan se të rinjë serbë kanë ndjekur me qen atë dhe tre fëmijë tjerë që ishin me të, nëntë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë vjeç, drejt lumit. Shokët e tij ishin zhdukur, supozohej se janë mbytur (që atëherë dy trupa janë gjetur).⁵³ Atë natë janë dhënë vazhdimisht të dhëna shtesë. RTK-ja jepte një shirit me lajm që vazhdimisht sillej në ekran edhe gjatë shfaqjes së programeve të tjera duke dhënë kështu një ndjenjë të krizës. Në edicionet e lajmeve, apeli i zëdhënësit të policisë së UNMIK-ut, Tracey Becker, për t'u permbajtur nga paragjykimet, u «mbytur» nga deklarata e aktivistit për "të drejtat e njeriut", Halit Berani, i cili fajësonte "banditët serbë" për vdekjen e fëmijëve. Mëngjesin e ardhshëm, pasi «*Koha Ditore*» dhe «*Epoka e Re*» trumpetuan se serbët shkaktuan mbytjen e tre fëmijëve shqiptarë, çdo gjë ishte gati për shpërthim.⁵⁴

⁵³ Është ende shumë heret të konkludohet rreth kësaj ngjarjeje shumë të rëndë. Në intervistat me ICG-në, burimet vendore dhe ndërkombëtare kanë shprehur dydhimin lidhur me përfshirjen e serbëve ashtu siq ishte pohuar. Këto dyshime vijnë nga inkosistencat në rrëfimin e djaloshit të mbijetuar para kamerave televizive, rreth rolit të përgaditjes së djaloshit për të dhënë intervistën para televizionit nga aktivisti militant i Këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Halit Berani. Më 20 mars, trupat franceze kanë arrestuar Beranin dhe e kishte mbajtur atë për 27 orë, duke e akuzuar atë për filmim dhe marrje të shënimeve lidhur me levizjet e personelit "në Zonën e mirëbesimit" afër urës kryesore në Mitrovicë, por gjithashtu edhe për të konfiskuar këto shënime dhe video materialin.

⁵⁴ OSBE-ja kishte përgaditur kritikë të rëndë për "Rolin e mediave në ngjarjet e marsit në Kosovë", të cilin e kishte publikuar në fund të prillit të vitit 2004, i cili kishte analizuar prezentimin e incidentit nga ana e mediave kosovare në mënyrë të detajuar.

V. DHUNË SPONTANE APO E ORGANIZUAR?

Gjatë dhe menjëherë pas ngjarjeve të 17-18 marsit, zyrtarët ndërkombëtarë filluan të pohojnë se dhuna më tepër ishte e planifikuar se sa spontane. Disa edhe aluduan në ekzistimin e një organizimi qendror, tendencë kjo që u shfaq në mënyrë të hapur në Beograd nga mediat dhe qeveria. Por, e vërteta duket të jetë se ka pasur seri të eskalimeve lokale dhe aksioneve pa një planifikim qendror por me një nivel të lartë të koordinimit lokal.⁵⁵ Poashtu ka indikacione se së paku në një rajon kanë qenë të involvuar edhe qytetarë të huajt.

Të kuptuarit e shkakut të protestave, mënyrën se si ato u shpërndanë, dhe si e pse ato përfunduan atëherë kur përfunduan është me rëndësi edhe për parandalimin e rishfaqjes së tyre por edhe për të përpiluar politikat e ardhshme. Elemente të organizimit ekstremist dhe kriminal u panë qartë gjatë 17-18 marsit. Por ndikimi dhe angazhimi i tyre mund të shihet pjesërisht si realizim i kërkesës për drejtim që ka shfaqur turmave e zemëruar, e mbledhur spontanisht. Aty ku u shfaqën grupe ekstremiste, të armatosura e të organizuara, «liria» e tyre e veprimtari varen nga "mbulesa" që u ofronte «këmbësoria» e përbëra nga turma e irrituar, konfuze dhe e çorientuar. Tensioni, frika dhe zemërimi ishin forcat shtytëse. Madje, në disa raste, organizimi duhej të nxitonte të mbante hapin me çorientimin.⁵⁶

Por, ishte edhe një anë tjetër e dhunës, e koordinuar më mirë. Ekzistojnë raporte për grupe që kanë udhëtuar distanca të largëta, disa edhe me autobusë: nga Drenicës për t'iu bashkuar protestave në Prishtinë, Çagllavicë, Fushë Kosovë dhe Mitrovicë; poashtu, nga Kosova perendimore -- grupe nga Gjakova dhe Deçani duket se kanë marrë pjesë në zhvillimet në Mitrovicë dhe Prishtinë. Një lajm i policisë, më 6 prill, thoshte se këmbanat e kishës së

⁵⁵ Shumica e këtyre shpërthimeve të dhunës kanë pak dëshmi për planifikim. Specilaisti i konfliktve etnike, Donald L. Horowitz, ka bërë studime bashkëkohore të ngjarjeve të tilla duke bërë analiza krahasuese të 150 rasteve në 50 vende. Ai kishte konkluduar: "Organizimi i mirëfillt është diçka e mbivlerësuar në trazira" dhe "në mënyrë paradoksale është më vështirë të ndalohen trazirat e paorganizuara se sa ato të organizuara". Shih Horowitz "Trazirat vdekjeprurëse etnike" (Berkeley, 2001), p. 254.

⁵⁶ Ibid., 266-267.

Mitrovicës, e djegur nga turma më 18 mars, janë gjetur përafërsisht 30 kilometra më larg, në Obiliq, gjë që dëshmon këto "udhëtime". Disa udhëheqës komunalë të cilët kanë tentuar të qetësojnë turmat kanë raportuar se nuk i kanë njohur fytyrat e njerëzve në turmë. Ka shenja se elemente kriminale nga Shqipëria fqinje mund të kenë qenë të involvuara në plaçkitjet në Prizren. Por, thashethemet për disa trupa të vdekur të pidentifikuar në morgun në Rahovec, të cilat nxitën spekulime se ata mund të kenë qenë të huaj, janë hedhur poshtë; të gjithë janë identifikur si qytetarë të Kosovës.⁵⁷ Turmat shpesh janë shquar me ekzistimin e shumicës së çorientuar, të irrituar, të pavendosur dhe me një pakicë ekstremiste, agresive, të fokusuar, përcaktuar dhe të armatosur. Kur sulmonte pakica, shumica tërhiqej.

Policia e UNMIK-ut ka regjistruar 33 protesta të mëdha gjatë 17-18 marsit, me përafërsisht 51,000 pjesëmarrës, disa prej të cilëve përdorën armë ushtarake. Një koment i hershëm i dhënë nga zëdhënësi policisë së UNMIK-ut, Derek Chappell, thoshte se protestat duhet të kenë pasur «një shkallë të organizimit mbrapa tyre» pasi që ato janë shfaqur në aq shumë vende në të njëjtën kohë. Në Serbi një raport i Ministrisë së Brendshme (MUP) i publikuar më 22 mars ka konkluduar se: «Mënyra (në të cilën) dhuna dhe terrori i ekstremisëve shqiptarë të armatosur është realizuar, si është shfaqur në kohë të njëjtë nëpër enklava të populluara nga serbët, numri i madh i protestuesve dhe logjistika, tregon se aksioni ishte i organizuar dhe i koordinuar nga një qendër».⁵⁸ Deri më 22-26 mars, zyrtarët ndërkombëtar ishin orientuar kah ky mendim. Gjatë një vizite që Hari Holkeri i bëri Obiliqit për të parë dëmet e shkaktuara, më 23 mars, ai u shpreh se dhuna ishte rezultat i "një plani të gjerë për Kosovën" të paramenduar nga ekstremistët të cilët e kanë pritur shansën për të vepruar.

Sulmet ndaj serbëve, pronës së tyre, kishave dhe manastireve, shpërthyen në mbarë Kosovën në jug

të lumit Ibër -- edhe në qendra urbane e edhe nëpër fshatra. A kanë qenë ato të planifikuara e të hartuara më parë, si pjesë e - siç thotë Holkeri - "një plani të gjerë për Kosovën"? Disa vëzhgues nxituan për të konstatuar se në Kosovën qendrore, një varg vendbanimesh serbe që shtriheshin në vijën kryesore hekurudhore që i lidh ata me veriun e Mitrovicës dhe me Serbinë ishin ato që ishin vënë në shënjestër. Apo ishin sulme të rastësishme, të varura nga faktorë lokalë, nga vendndodhja? Si mund të spjegohet mungesa e dhunës në disa lokacione? Burime të SHPK-së shtrojnë çështjen se nëpër vendet ku ata kanë qenë të lejuar që të udhëheqin stacionet policore dhe të caktojnë mënyrat e veprimt, si në Kaçanik, Drenas/Glogoc, dhe në disa lagje të Prishtinës si në Kodrën e Trimeve/Vranjevac dhe në Lakrishte, ata kanë arritur që të parandalojnë dhunën në mënyrë më të suksesshme se sa në vendet ku Policia e UNMIK-ut i ka përdorur ata vetëm si vartës.⁵⁹

Eshtë intrigues fakti se tri fshatëra serbe në komunën e Lipjanit, (Dobrosin, Gushterica e Poshtëme, Gushterica e Epërme) të rrethuara nga gjashtë fshatra shqiptare, nuk kanë pasur asnjë problem, edhe pse atje ekziston një armiqësi e konsiderueshme në mes shiptarëve dhe serbëve që daton që nga viti 1999. Shumë raste të bllokimit të rrugëve dhe të gjuajtjeve me gurë të veturave kishin ndodhur këtu para tërheqjes së prezencës statike të KFOR-it, në korrik 2003, e poashtu aty ndodhën një varg incidentesh të ngjajshme nga 8 deri më 16 shtator 2003, kur supozohej se ishte tentuar që të kidnapoheshin dy fshatarë serbë.⁶⁰

OJQ-ja ndërkombëtare CARE ka udhëhequr një program për menaxhimin e konfliktit ndëretnik në 30 fshatëra në mbarë Kosovën, fshatra të cilat ose janë të përziera etnikisht ose kanë etnitete tjera pranë. Sipas informatave paraprake, gjatë tërë këtyre ngjarjeve, në këto vende nuk ka pasur konflikte. Është shumë herët të gjykohet nëse e tërë kjo mund të ketë ndodhë falë programit të OJQ-së, ose, siç ka konstatuar një zyrtar ndërkombëtar që nuk e pranonte këtë, kjo ka

⁵⁷ Gazeta e afërt me LDK-në "Bota Sot", insiton në ekzistimin e organizatorëve dhe se ata ishin agjentët e shërbimit sekret shqiptar të dërguar nga kryeministri Nano. LDK vazhdon të shikoj me armiqësi Partinë Socialiste të Nano-s "Bota Sot" gjithashtu fajëson partitë e dala nga UÇK-ja, PDK-në dhe AAK-në, për shkaktimin e dhunës pasi që këto parti sipas saj kanë lidhje të ngushta me Partinë Socialiste të Nanos.

⁵⁸ V.I.P. Raport ditor i lajmeve, 23 mars, 2004.

⁵⁹ Në Gillogoc dhe Kaçanik nuk ka ndonjë komunitet serb për të mbrojtur. Kaçaniku ka një kishë ortodokse me varrezat përreth. Në Prishtinë janë disa fshatra serbe jasht qytetit që kufizohet me vijat periferike të lagjeve si Kodra e Trimeve dhe stacioni policor I

⁶⁰ Intervistat e ICG-së me fshatarë shqiptarë dhe serbë, policë, pjestarë të KFOR-it, 19 prill, 2004.

ndodhur pasiqë këto fshatra nuk kanë qenë të përfshira në planin e gjerë të ekstremistëve.⁶¹

Shpërthimi i përnjëhershëm dhe i sinkronizuar i sulmeve që nga pasditja e deri në mbrëmjen e ditës së parë si në Fushë Kosovë e Lipjan -- mu atëherë kur forcat e policisë dhe KFOR-it po vendoseshin në Çagllavicë -- tregon për një nivel të komandës dhe kontrollit. Sigurisht se ka pasur përgatitje dhe plane rezervë ndër grupet ekstremiste dhe kriminale. Megjithkëtë, shpjegimet e tilla duket të jenë tepër ushtarake dhe rrezikojnë që të mos merren parasysh aspektet sociale të eskalimit. Pa akumulim të tensioneve dhe frustrimeve të përshkruara më lart (dhe pa lëshime në sferën e sigurisë nga ana e KFOR-it dhe UNMIK-ut), një plan i tillë si ky do të ishte i parealizueshëm.

Dy "mëkatet"⁶² e përnjëhershme të serbëve të Kosovës, të bëra më 16 mars -- bllokimi i rrugës në Çagllavicë dhe përgjegjësia e pretenduar për mbytjen e tre fëmijëve shqiptarë -- në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikuan në shtimin dhe shpërthimin e mllefrit kolektiv të shqiptarëve. Kjo siguroi sasi të mjaftueshme të "barutit" për të ndezur gjakrat që drejtuan dhunën e ditës pasuese, duke realizuar punën mobilizuese e organizative dhe duke zëvendësuar mungesën e organizimit formal.⁶³ Vrasja (e pretenduar) e fëmijëve shqiptarë është në vijë me stereotipin që shqiptarë e Kosovës kanë për serbët që nga lufta e viteve 1998-1999, se ata janë vrasës të fëmijëve.⁶⁴ Vendi ku ndodhi incidenti i mbytjes --

⁶¹ Shih Ashutosh Varshney's *"Konflikti etnik dhe jeta qytetare: Hinduizmi dhe muslimanizminë Ind"* (New Haven, 2002). Nëpërmjet të dhënave të mbledhura në gjashtë qytete me popullsi të përzier indiane dhe muslimane, Varshney tregon se si në disa qytete trazirat ndërmjet të dy etniteteve janë më pak të mundëshme ndërsa në disa të tjara me shumë të mundëshme.

⁶² Kjo tregon se çka nuk duhet të bëjnë të huajt me etnitet tjetër, pa u ndëshkuar, Horowitz, *"Trazirat etnike vdekjeprurëse"*, op. cit., p. 268.

⁶³ Shih Thomas C. Schelling, *Strategjia e konfliktit* (Cambridge, 1960), p. 90. Ai zbulon se si aktet nxitëse veprojnë si shenjë që dërgohet tek çdo anëtar kundër komunitetit tjetër dhe kjo siguron se çdo anëtar i komunitetit do të jetë mjaft i mllefosur sa të reagojë me dhunë, duke mobilizuar për dhunë numër të mjaftueshëm individësh.

⁶⁴ Vrasja e fëmijëve nga ana e forcave serbe në vitin 1999 ka lënë vrugë të veçanta mentale në mendjet e shqiptarëve. Televizioni publik i Kosovës ka shfaqur disa herë një dokumentar të titulluar: "Kur vriten fëmijët", duke dhënë detaje dhe duke paraqitur trupa të pajetë të fëmijëve të vrarë në luftë. Gushti i vitit 2003, vrasja dhe plagosja e fëmijëve serb të Kosovës në Gorazhdevc hasi në përgjegjëjen e

Ibri, dhe fshati shqiptar në anën e "gabuar" e lumit -- kanë prekur vrragët e pasluftës të shqiptarëve të Kosovës të shkaktuara nga *de facto* ndarja e vendit dhe treguan se ku duhet të shpërthejë dhuna: në urën e Mitrovicës.

Mënyra se si reagan turmat nëpër mbarë Kosovën më 17-18 mars ishte një vorbull ku bëheshin bashkë në një anë zemërimi jokohorent që kërkonte drejtim dhe vend për t'u zbratur⁶⁵ dhe, në anën tjetër, grupet e determinuara që treguan kohezion dhe kalkulim.⁶⁶ Të dy tendencat do të manifestoheshin në lokacione të njejta. Në Prizren dëshmitarët tregojnë se turma e mbledhur në sheshin e qytetit rreth orës 3 pasdite, më 17 mars, në fillim dukej si e pa kokë. Turma së pari u nis për në rrugën e cila shpie në Prishtinë dhe Mitrovicë, 80 respektivisht 110 kilometra largë, pastaj u kthye për të gjuajtur me gurë ndërtesën e UNMIK-ut dhe më pas ndjeku një grup të vogël të cilët sulmuan ndërtesën e seminarit ortodoks⁶⁷. Por, nga pikëvështrimi i ushtarëve gjermananë që nuk ia dolën të mbrojnë kishat ortodokse, seminarin dhe manastiret në Prizren, turmave veproji në mënyrë sistematike. Një komandant batalioni vërejti se "e dinin shumë mirë se sa larg mund të shkojnë" me sulmet e tyre duke mos i provokuar ushtarët që të gjuajnë me armë.⁶⁸ Turmat dhe pengimi i qëllimshëm i komkunkacionit penguan forcave gjermane të KFOR-it që të arrijnë deri te detashmentet e gjendura në rrezik.

Në mënyrë të ngjajshme, duke folur për betejën e gjatë në Çagllavicë dhe përreth saj, burime të larta të KFOR-it e paraqitën masën e shqiptarëve të cilët tentuan për dy ditë radhazi për të hyrë në fshat si

shqiptarëve se: "Nuk është në traditat shqiptare për të mbytur fëmijë". Tregimi për hedhjen në ujë të tre fëmijëve shqiptarë të Kosovës më 16 mars ishte një goditje e drejtpërdrejtë emocionale për opinionin e gjerë të shoqërisë kosovare.

⁶⁵ Në disa lokacione kishte disa ose nuk kishte fare shënjestra të serbëve për turmat që shfryenin mllefin e tyre, gjë kjo e cila ose drejtonte ato drejt shënjestrës së "dytë të mirë" -- caqet e UNMIK-ut ose përfundonte me shpërndarje. Për shembull, më 17 mars, një turmë në Istog nuk u lodh të arrinte fshatin më të afërt të banuar me serb për arsye se nevoitej shumë kohë për të shkuar atje. Në vend të kësaj, ata kënaqën vetveten e tyre duke djegur një veturë të UNMIK-ut para ndërtesës së kuvendit komunal dhe shkuan në shtëpi. Intervistat e ICG-së, Istog, 30 mars 2004.

⁶⁶ Për detaje shih kronologjinë në aneksin A.

⁶⁷ Intervistat e ICG-së, Prizren, 28 mars, 2004.

⁶⁸ Shih: "Rekonstruktion einer Niederlage: Wie die deutschen Kfor-Soldaten in einer dramatischen Nacht die Grenzen ihrer Macht erfahren", nga Joachim Kaepfner, *Sueddeutsche Zeitung*, 29 mars 2004.

oponent që vepronte me stil ushtarak. Një pjesëtar i SHPK-së i cili kishte qenë në vijën e parë dhe kishte tentuar për të qetësuar turmën, e shihte ndryshe këtë: «Shumica prej tyre nuk ishin agresivë. Ishte një numër i vogël i atyre që vërtetë donin të kacafyteshin. Kur ata hedhnin gurë në drejtimin tonë, njerëz të tjerë nga turma i ndalonin. Më besoni, sikur e tërë turma të kishte dashur të depërtojnë në Çagllavicë, do të kishte mundur ta bëjë këtë me lehtësi».⁶⁹

Dy ditët e dhunës nuk patën organizim qendror, por ishin një vorbull në të cilin hynin dhe dilnin radikalë të ndryshëm, ekstremistë dhe struktura kriminele, një “treg” i papërgatitur i dhunës në të cilin secili kishte sjellë “produktet” e veta dhe kishte gjetur «shtandin» e vet.⁷⁰

Organizatat si tri “shoqatat e dala nga lufta” të cilat u dalluan me demonstrata ku shfaqeshin pakënaqësitë e luftëtarëve dhe të cilat me deklaratat dhe ultimatumet e bëra më 19 mars në mënyrë retrospektive u paraqitën si organizatore të protestave, nuk ndikuan në mënyrë uniforme në këto ngjarje. Në disa lokacione ata parandaluan shëndërrimin e demonstratave në pogrom.⁷¹ Mbetet vetëm në nivel të hamendjeve roli i mundshëm i strukturat paralele të sigurisë të partive politike shqiptare të cilat janë të lejuara nga UNMIK-u dhe nga KFOR-i, - SHIK-u i dalë nga UÇK-ja⁷² dhe ZKZ-ja e LDK-së. Një mundësi është që pas fillimit të protestave, këtyre organizimeve iu imponua që të bëheshin pjesë e turmave dhe të ndikonin në orientimin e tyre në mënyrë që të mos e humbnin kredibilitetin e tyre para njëri tjetrit apo para liderë të aty për atyshëm.

⁶⁹ Intervistë e ICG-së 29 mars, 2004.

⁷⁰ Shpërthimi në të gjitha pikat kujton daljen e UÇK-së në mars të vitit 1998, në formë të grupeve të armatosura pa ndonjë komandë qendrore, pas vrasjes së dhjetëra burrave, grave e fëmijëve nga forcat serbe që po përpiqeshin të shkatërrojnë filizat e UÇK-së në fshatrat e Drenicës, 2-5 mars, 1998.

⁷¹ Në Deçan, pas organizimit të demonstratës së 17 marsit, gjatë së cilës ishin djegur pesë vetura të UNMIK-ut, në ditën pasuese shoqatat bënë thirrje për një demonstratë tjetër. Të rinjë u nisën për të shkatërruar manastirin e Deqanit. Udhëheqësi vendor i shoqatës së veteranëve të UÇK-së, së bashku me kryetarin e KK-së, Ibrahim Selmanaj, arriti të kthej turmën në qytet. Policia e UNMIK-ut arrestoi Mushkolajn më 10 prill nën akuzën për rolin e tij gjatë 17 marsit. Anëtarë të shoqatave të dala nga lufta ishin të fundit që provuan të ndalin turmën e fëmijëve nga shkollat e mesme në Skënderaj më 18 mars, nga shkuarja në manastirin e Deviqit.

⁷² Shih raportin e ICG-së për Ballkan N°88, “Çfarë i ka ndodhur UÇK-së?”, 3 mars 2000, pp. 13-14.

Përhapja rapide e protestave mund të krahasohet me përhapjen e një sëmundjeje ngjitëse me infeksion të lartë -- një kolaps i përnjëhershëm dhe vet-nxitës moral dhe histeri. Edhe pse qeliza ekstremistësh po e eksploatonin, ushqenin dhe mbanin gjallë histerinë dhe dhunën e saj, ata e bënë këtë me një organizim të shthurur, të çorientuar, që shpesh kopjonte veprimet e dhunshme të cilat ishin zhvilluar nëpër lokacione të ndryshme e me lidhshmëri të ndryshëm e në garë ndërmjet veti.

Në të vërtetë ky shpjegim është më i frikshëm se sa verzioni i stilizuar i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë e gjithmë e më shumë i përkrahur edhe nga zyrtarët ndërkombëtarë ushtarakë e dhe civilë. Ky version është më i errët me implikimet e tij për sigurinë e minoriteteve dhe të prezencës ndërkombëtare në të ardhmen se sa verzioni i përmendur se e tërë kjo ka qenë e parapërgatitur mirë nga një grup ekstremistësh klandestinësh. Është e vërtetë se nocioni për një skenar të parapregaditur nga një qendër e vetme koordinuese ekstremiste ofron mundësinë që me arrestimin e një grupi të vogël njerëzish të eliminohet rreziku. Kjo poashtu e bën më të pranueshme idenë e rrezikshme se në Kosovë ekziston një rrugë e shkurtër, militare, për të siguruar stabilitetin, e poashtu e bën të pranueshme idenë se dështimi për të hartuar një kurs kredibël për zhvillim ekonomik dhe kushtetues të Kosovës është çështje sekondare. Kjo nuk do të thotë se këto grupe nuk kishin duke hartuar plane të kësaj natyre, por, nuk mund ta “mbivlerësojmë” rëndësinë dhe afërsinë e tyre për t’i arritur qëllimet e tyre pa i vënë në lojë edhe forcat sociale të dala nga politikat joadekuate ndërkombëtare udhëheqësia e ploshtë politike vendore. Forca lëvizëse prapa dhunës -- dhe rreziku për rishfaqjen e saj -- qëndron në një shoqëri jostabile, me mundësi të një kolapsi, më parë se sa në konspiracion dhe një plan të madh.

Pse protestat u shuan në ditën e tretë, më 19 mars? Gjatë dy ditëve të para, protestuesit kishin një lloj leje shoqërore, miratim apo së paku pranim të heshtur për të vepruar. Staf i të tri kanaleve televizive shqiptare në Kosovë, organizatat e shoqërisë civile siq janë Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut e Kosova Action Network (KAN) si dhe nga politianët shqiptarë u rreshtuan përkrah ankesave dhe viktimizimit të shqiptarëve të Kosovës dhe shumë të ngadalë lëvizën në drejtim të pranimit të makthit në të cilin ishin shëndruar «protestat». Nga mbrëmja e 18 marsit, gjërat filluan të ndërojnë. Kryeministri Rexhepi hyri në turmën në Veternik duke kërkuar

ndërprerjen e protestave, lideri i PDK-së, Hashim Thaçi, adresoi një apel të fuqishëm televiziv. Energjia hysterike e ditës së parë të protestave në mënyrë të dukshme filloi të ulej ndërsa ndër organizatorët formalë të demonstratave -- UPSUP-i dhe tri shoqatat e luftës -- shtohet konsenzusi për nevojën për tu ndalur. Vetpërmbytja e treguar nga serbët e Mitrovicës poashtu pati ndikim të madh në evitimin e provokimeve të reja. Liderët lokal të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së penguan përpjekjet për demonstrime të reja më 19 mars në disa lokacione. Në Prizren një njeri që mbante një flamur të madh shqiptar e që po tërhiqte rreth vetes një numër të rinjesh, ishte larguar nga vendi nga anëtarët e Shoqatës.

Duke kërkuar të përfitojnë, UPSUP-i dhe tri shoqatat e luftës kanë lëshuar një lajmërim formal për suspendimin e protestave më 19 mars, të shoqëruar me një varg kërkesash drejtuar UNMIK-ut dhe komunitetit ndërkombëtar. Thirrja për ndërprerje të protestave në mënyrë që të shihet se çfarë do të ofrojë bashkësia ndërkombëtare është përsëritur edhe më anë të një letre të hapur të botuar në një gazetë ditore të shqiptarëve të Kosovës, e shkruar nga njëfar "Snajperist Abazi", anëtar i AKSH-së dhe tanimë veteran i ri i luftimeve në Çagllavicë: «Bota e ka kuptuar porosinë, se diçka nuk është duke shkuar si duhet, eskalimet e mëtutjeshme janë krejtësisht të panevojshme». ⁷³ Lajmërimi për përforsime të forcave të KFOR-it e posaqërisht arritja e shpejtë e një batalioni këmbësorik britanik që tanimë patrullonte në rrugët e Prishtinës që në mëngjesin e 19 marsit, forcoi edhe më tepër atmosferën për vetpërmbytje.

VI. SISTEMI I SIGURISË BUZË KOLAPSIT

Në mbrëmjen e 17 marsit, UNMIK-u dhe KFOR-i për pak sa nuk e humbën Kosovën. Forcat e sigurisë ose ishin të shtrira deri në kufijt e tyre ose të mbetura jashtë zingjirit komandues, ndërsa 40 policët që kishin mbetur të siguronin selitë qendore të UNMIK-ut dhe policisë në qendër të Prishtinës, kuptuan se forcat suedeze që ruanin hyrjen prapa në bazën e tyre ishin ripozicionuar; po të ishin sulmoheshin, ata nuk do të kishin në gjendje t'i rezistonin turmës që po vërshonte qytetin në rrugën e vet prapa nga Çagllavica. Sfida e atyre dy ditëve -- 33 trazira të mëdha, me 51,000 pjesëmarrës, disa duke përdorur edhe armë ushtarake - do të kishte paraqitur problem madje edhe për një strukturë më koherente dhe më të organizuar të sigurisë. Dhuna nxori në pah të vërtetën se KFOR-i dhe UNMIK-u nuk e kishin një strukturë të tillë. Mungesa e udhëheqjes qendrore u bë shumë e evidente.

Me 30 mars, UNMIK-u deklaroi se «Trupi për Vlerësim të Menaxhimit të Krizës» (Crisis Management Review Body), do të vlerësojë se si UNMIK-u ka vepruar gjatë ngjarjeve të 17-18 marsit dhe do të shqyrtojë se cilat ishin mundësitë për reagim më adekuat⁷⁴. Fatkeqësisht, në të njëjtën kohë UNMIK-u po i detyron oficerët e policisë nëpër tërë zingjirin e vet komandues që të heshtin. Po pengohet diskutimi i hapur i lëshimeve në sistemin e sigurisë, por edhe rreth dështimeve politike dhe ekonomike që sollën një shpërthim të tillë të dhunës. Ata të cilët ose kanë folur për eprorë jokompetentë ose të cilët i kanë refuzuar urdhërat e tyre bizare janë larguar nga postet e tyre (janë «transferuar»), ose u është thënë të heshtin. Komandantët që i dhanë turmës *carte blanche* që të bëjnë rrafsh fshatrat vetëm 100 metra largë nga bazat e mëdha të KFOR-it, të cilët nuk furnizuan trupat me municion, ose të cilët i dëbuan policët nga shtabet e tyre regjionale dhe i urdhëruan që t'i digjin ato⁷⁵, morën lëvdata nga funksionarët e lartë që vizituan vendin.

Dhuna e dy ditëve ishte një zbulim i zyrtë i vendosmërisë së kufizuar të forcave të sigurisë. KFOR-i mbeti si një «tigër prej letre» dhe do ta ketë të vështirë ta përmirësojë kredibilitetin e humbur. Ai

⁷³ *Koha Ditore*, 19 mars

⁷⁴ Shqyrtimi nuk do të përfshijë edhe KFOR-in që është një strukturë e veçantë.

⁷⁵ Shih më poshtë

realisht kishte rezistuar vetëm në Çagllavicë, por edhe atje duke angazhuar shumicën e trupave të Brigadës Shumëkombëshe - Qendër, duke lënë pjesën tjetër të rajonit të Prishtinës krejtësisht të pambrojtur. Edhe pse zyrtarë të sigurisë dhe policisë pohojnë se "kanë vënë jetën para pronave" — dhe falë kësaj viktimat mbetën të pakta - kjo frazë përdoret për të mbuluar veprimet që në të shumtën e rasteve ishin kapitullim i turpshëm. Serbët, romët e ashkalinjtë janë evakuuar nga shtëpitë, kishat dhe manastiret vetëm sa për t'ua lënë këto në dorë turmave që kërkonin t'ua vënin zjarrin. KFOR-i ishte zënë i papërgatitur, pa plan në një gjendje të jashtëzakonshme. Trupat e tij nuk kishin kontinuitet të përdorimit të forcës, të zënë mes përpjekjeve të pasukseshme për t'i ndalur turmat me duart e thata dhe përdorimit të armëve kundër tyre - metoda e fundit kjo që, përsëri falë ushtarëve, është përdorur krejt pak. KFOR-i bëri një punë humanitare për çdo lavdatë, por një punë të tmerrshme ushtarake. Me përjashtim të Çagllavicës, në vendet tjera kishte përsuar disfatë.

Që të dy xixat — ura kryesore në Mitrovicë dhe bllokada e rrugës kryesore në Çagllavicë — kanë mundur të «shuhen» sikur KFOR-i dhe policia do të ishin më vigjilentë. KFOR-i fuqimisht pat penguar tentimet e mëhershme të turmave të zemëruara të shqiptarëve të Kosovës që me forcë të kalojnë urën e Mitrovicës, veçënisht në shkurt të vitit 2000. Bllokada në Çagllavicë, siq është raportuar, është mbajtur nga disa dhjetëra fashatarë serbë. Me reagime proaktive, shumë nga shkatërrimet e 17-18 marsit kanë mundur të parandalohen.

Sistemi i sigurisë i misionit paqëruajtës nuk ka poseduar kapacitete parashikuese. Edhe pse zyrtarë të lartë të UNMIK-ut kishin parandjenja se tensionet po ngriteshin qysh më 16 mars, gjërat nuk mund të lëviznin për shkak të intercionit të sistemit. Eprorë të KFOR-it individualisht kishin parashikuar gjakderdhjen në mëngjesin e 17 marsit por trupat nuk ishin dërguar për të shtuar sigurinë në urën ku pritej shpërthimi.

Zingjiri komandues u tregua të jetë i copëtuar. Dy vite të procesit të «normalizimit» kishte parë zvogëlim gradual të numrit të trupave ndërkombëtare, nga një forcë fillestare prej 45.000 trupave në 17.500 me plan për reduktime të mëtejshme, me KFOR-in të kalonte nga pozicione fikse që kërkonin shumë trupa në strategjinë e «zonave të përgjegjësive». Në të njëjtën kohë, shumë detyra paraprakisht të kryera

nga policia e OKB-së (CIVPOL) i ishin dorëzuar SHPK-së. Më 17 mars, përgjegjësitë ishin të ndara - dhe të paqarta - ndërmjet KFOR-it, CIVPOL-it dhe SHPK-së. Përderisa po ofrohej mbrëmja, koordinimi dhe koherenca e forcave po shëmbej. Policia e UNMIK-ut, për shembull, ishte reduktuar në system të menaxhimit të krizës *ad hoc* me një bërthamë të vogël të policëve nga Irlanda Veriore që po kontrollonin gjendjen.

Por, disfata më e dukshme është ajo e KFOR-it. Në përfundim të Kosovës, baza kryesore e ushtrisë italiane është një kilometër larg fshatit serb Bellopojë/Belo Polje, ku në vitin 2003 qenë kthyer kryefamiljarë për të rindërtuar shtëpitë e tyre. Kur shpërthyen trazirat më 17 mars dhe fshatarët u strehuan në kishë, trupat italiane nuk guxuan të afrohen as me veturat e tyre po i detyruan serbët që të vrapojnë tek ta nën rebeshin e gurëve dhe thikave të rinjëve shqiptarë. Sikur një polic i UNIKU-t të mos kishte shtënë, duke vrarë një pjesëtar të turmës, gjë që ndali turmën për një çast, serbët do të ishin kapur dhe sigurisht do të ishin vrarë.⁷⁶ Afërsisht të gjitha shtëpitë aty janë dëmtuar ose shkatërruar.

Dështimi i forcave franceze të KFOR-it për të mbrojtur fshatin Frashër/Svinjare, i cili shtrihet disa qindra metra larg bazës së tyre logjistike, Kampit «Belvedere», ishte lajmi më i përhapur më 18 mars.⁷⁷ Policia e UNMIK-ut dy orë më herët kishin paralajmëruar KFOR-in se turma po vinte.⁷⁸ Kur kjo arriti, duke ecur qindra metra përgjatë perimetrit të kampit dhe duke djegur shtëpinë e parë që e arriti, trupat franceze dhe policia speciale polake evakuoi banorët serb. Pas kësaj pasoi plaçkitja dhe djegia e papenguar që zgjati deri natën vonë, derisa u dogjën të gjitha shtëpitë e serbëve dhe të gjitha kafshët e tyre shtëpiake u therrën. Trupat brenda kampit, duke përfshirë këtu edhe një kompani ushtarësh grekë

⁷⁶ Informatë e ICG-së e marrë nga dy hulumtues të besueshëm të cilët kanë intervistuar në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri të zhvendosurit nga Bellopoja/Bjelo Polje dhe ushtarë italianë brenda kampit të KFOR-it "Villagio Italia".

⁷⁷ Shih raportet e mediave përfshirë "Djegia e fshatit Serb në Kosovë që shtrihej në afërsi të paqëruajtësve të NATO-s", Agjensionit France-Presse, 21 mars 2004; "Des militaires français 'organisent' l'exil des Serbes de Svinjare", *Le Figaro*, 22 mars 2004; "Djegia e Kosovës pas dhunës së trazirave", *The New York Times*, 24 mars 2004; detajet janë konfirmuar nga intervistat që ICG-ja i ka pasur me dëshmitarët e ngjarjeve.

⁷⁸ Intervistë e ICG-së me një burim të policisë.

armët e të clëve tanimë ishin dërguar në shtëpi,⁷⁹ nuk u përballën me turmën. At që dogjën u ndien aq të paprekshëm sa që shumë prej tyre madje i kishin shkruar emrat e tyre nëpër muret e shtëpive të cilat më parë i kishin djegur. Një zëdhënës i trupave franceze e arsyetoi mosdaljen e trupave duke thënë se ata ishin të pakët në numër.⁸⁰

Në Prizren, vendas thonë se një reagim më i vendosur i trupave gjermane të KFOR-it do të mund të parandalonte djegjen e kishave, manastireve dhe seminarit. Thuhet edhe se ushtarët u larguan nga pozicionet e tyre me t'u afruar turmat. Sipas disa thashethemeve, trupat e KFOR-it që po ruanin një nga ndërtesat religjioze kishin kërkuar nga turma që t'i lejonte t'i tërhiqnin mjetet e tyre para se turma ta digjte ndërtesën. Dhuna e shëndërroi "margaritarin dhe Jerusalemin e Kosovës" në një rrënojë të shëmtuar, të sakatorus e të zymtë.

Zyrtarët e SHPK-së kishin mbetur «pa kokë», pa urdhëra koherente. Megjithatë, ata treguan gjinshmëri dhe e kryen detyrën e vet me mjaft trimëri, duke shpëtuar serbë, romë dhe ashkalinj nga turmat (shpesh në të njëjtën kohë duke bindur njerëzit e rrethuar nëpër shtëpitë e tyre që të mos shtiejnë në ta derisa këta i luftonin sulmuesit) edhe pse nuk ishin të paisur me paisje për të luftuar turmën dhe me këmisha antiplumb sikur që ishin të paisur CIVPOL-i e KFOR-i. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i shpesh kanë ftuar SHPK-në që të ndihmojë për të neutralizuar situata të rrezikshme dhe ishte në gjendje më mirë se CIVPOL-i të mbrojë të evakuuarit. Sipas disa informatave madje disa pjesëtarë të Policisë së UNMIK-ut kishin veshur uniforma të SHPK-së. Megjithkëtë, ishte edhe një numër i kosiderueshëm i pjesëtarëve të SHPK-së të cilët qëndronin larg konfrontimeve me bashkëkombasit e tyre në turmë. Disa qëndruan anash kur turma u vinte zjarrin shtëpive apo sulmonte fizikisht serbët. Edhe më keq, disa prej tyre edhe iu bashkangjitën turmave. ICG ka dëgjuar për së paku dy raste kur oficerët e SHPK-së kishin hedhur Koktejtë Molotovi.

Nacionalitetet e ndryshme të pjesëtarëve të CIVPOL-it dhe bashkëpunimi i shkurtë me njëri tjetrin ka penguar zhvillimin e një fryme të përbashkët dhe kjo u bë mjaft e dukshme atëherë kur lejtnantë e rreshterë kishin vështirësi të koordinonin vartësit e tyre në reagime decitive por të rrezikshme.

⁷⁹ Shumë pjesëtarë të UNMIK-ut janë evakuuar në bazë dhe kanë qenë dëshmitarë.

⁸⁰ Intervitë e ICG-së, 14 prill.

Disa komandantë të Policisë së UNMIK-ut i kufizuan veprimet e tyre në mbrojtje të stacioneve të tyre policore. Në mbrëmjen e 18 marsit, disa nxënës të shkollave të mesme qenë në gjendje që t'ia vëjnë zjarrin kishës ortodokse në Prishtinë, edhe pse ishin në dispozicion 120 oficerë të OKB-së dhe SHPK-së si dhe njësitë me qenë i SHPK-së që ndodheshin në Shtabin qendror të policisë së UNMIK-ut. Askush me rang komandues nuk i mobilizoi të përballen me turmën. Një përjashtim është komandanti i Policisë së UNMIK-ut i stacionit të policisë në veri të Mitrovicës i cili është fotografuar në ballë të vijës së frontit në urën në Mitrovicë, duke u përballur me turmën që hedhte gurë pa mbrojtës fare.

Pikërisht në qytetin e ndarë të Mitrovicës koordinimi ndërmjet trupave dhe policisë ka arritur pikat e veta më të larta dhe më të ulëta, varësisht nga ajo se në cilën anë të lumit janë gjetur. Përforcimi dhe organizimi i shpejtë në ditën e parë ka ndihmuar që të parandalohen luftimet përgjatë urave mbi lum. Që nga 18 Mmarsi e tutje, KFOR-i, Policia e UNMIK-ut, dhe SHPK-ja në pjesën serbe në veri të qytetit kane operuar bashkarisht nga shtabi i përbashkët në Stacionin e Policisë në veri të qytetit dhe kanë pasur një koordnim mjaft të ngushtë.

Por, ishte Mitrovica jugore vendi ku koordinimi ndërmjet trupave dhe policisë ka arritur nivelin e vet më të ulët. Në fillim të përlëshjeve në mesditën e 17 marsit, policia kuptoi se trupat franceze të KFOR-it nuk mund t'i mbrojnë e as të ndalin snajperistët, pasiqë, sipas tyre ata nuk kishin municion. Në vend se të koordinohet me ta, trupat franceze të KFOR-it trajtuan Policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në si pengesa. Më 18 mars, duke reaguar ndaj një informate "absolutisht të pavërtetë"⁸¹ të marrë nga komanda qendrore e KFOR-it, se 5.000 shqiptarë të armatosur ishin nisur nga Drenica, dhe 7-10.000 të tjerë nga Peja (forca fantome që në realitet nuk kanë ekzistuar),⁸² trupat franceze urdhëruan UNMIK-un dhe policinë (Policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në) që të lëshonin qendrat e

⁸¹ Intervistë e ICG --së me zëdhënësin e trupave franceze të KFOR-it, 14 prill.

⁸² Thashethemet dhe friga ishin shpërndarë nga ndonjë invazion i mundëshëm nga forcat ushtarake të Serbisë dhe Malit të Zi, që po lëviznin përreth kufirit, se do të mund të aneksonin veriun e Kosovës përgjatë lumit Ibër. Me një qarkullim të shtuar të veturave nga Serbia për në Kosovë, grupe paramilitare dhe grupe të shërbimit të sigurimit serb po dukeshin gjithnjë e më shumë nëpër rrugët e Mitrovicës - me vetura me xhama të errët, me targa të Beogradit dhe disa prej tyre edhe me uniforma.

veta regionale në jug të Mitrovicës. Udhëzimi i komandantit të francez ishte: «Largohuni nga ndërtesa. Digjeni. Largoni ose shkatërroni kompjuterët».⁸³ Policia e UNMIK-ut u tërhoq në anën tjetër të lumit, në veri të Mitrovicës dhe Zveçan, duke marrë kompjuterët dhe shtëpizat e kompjuterëve me vete por duke u përmbajtur nga djegia e objektit. Refuzimi për djegien e objektit shpëtoi edhe pronat e qytetarëve të tjerë në ndërtesë, duke përfshirë këtu edhe dyqanet në katin e parë të ndërtesës si dhe zyret e Qendrës për punë sociale të Mitrovicës, Administratës së pensioneve, Institutin regional për shëndetësi publike, një kompanie private për konsultime për konstruktive, si dhe lokalet e krahut rinor të PDK-së.

Ditën tjetër, trupat franceze tentuan që të shpërndajnë SHPK-në në jug të Mitrovicës, duke kërkuar nga eprorët e SHPK-së një listë complete të adresave të shtëpive dhe të numrave të telefonave të pjestarëve të SHPK-së. Pasi u është dorëzuar kjo listë, KFOR-i i thirri pjestarët e SHPK-së dhe u tha atyre të mos paraqiteshin fare nëpër vendet e tyre të punës. KFOR-i pastaj mori kontrollin mbi stacionin policor të jugut të Mitrovicës dhe dëboi nga ndërtesa policët nën tytat e armëve. Një dëshmitar ka raportuar se ka parë pjestarë të KFOR-it duke e shtyrë për muri një oficerë amerikane të Policisë së UNMIK-ut që po kundërshtonte.⁸⁴ Sipas një raporti, trupat e KFOR-it

ia kishin drejtuar armët një grupi pjestarësh të SHPK-së të cilët kishin tentuar që të ktheheshin në qendër. Në mëngjesin e ardhshëm, postbllloqet e KFOR-it të vendosura në hyrjet në jug të Mitrovicës nuk i lejuan pjestarët e SHPK-së të cilët jetonin në pjesën jugore të qytetit që të shkonin në vendet e tyre të punës. Më 23 mars, UNMIK-u dhe policia ende po provonin që të rimerrnin kontrollin mbi stacionin e policisë nga trupat franceze dhe belge. Kur UNMIK-u më në fund rimori kontrollin mbi ndërtesat e veta, në javën e fundit të marsit, stafi i UNMIK-ut gjeti se po mukngonin gjëra me vlerë, paisje elektronike madje edhe orendi. Personelin e UNMIK-ut nuk ishte aspak i impresionuar me porosinë që kishte lënë KFOR-i në brendi të ndërtesës, e që thoshte:

Për punëtorët e UNMIK-ut në YUGOBANKA: Për shkak të ngjarjeve të javës së kaluar që ndodhën në Mitrovicë, ushtarët e KFOR-it është dashur që përkohësisht të jetojnë në këtë ndërtesë, për disa ditë. Disa orendi ose mjete të punës mund të jenë zhvendosur gjatë situatës emergjente. Ju dini për punën madhështore që ne e bëjmë dhe patëm kënaqësinë që të kujdesemi për Selinë rajonale të UNMIK-ut. Falemderit.

Policia e rimori kontrollin mbi Stacionin jugor, por më 31 mars, trupa franceze të KFOR-it ishin parë duke i detyruar oficerët e SHPK-së të presin në rradhë në posbllokun jasht ndërtesës. Një dëshmitar ka treguar: «Përderisa unë kalova lirshëm në një veturë të OSBE-së, ushtarët francez po iu bërtisnin katër-pesë pjestarëve të SHPK-së dhe po i sillnin ata vërdallë».⁸⁵ Një burim kompetent ka përmbledhur mendimin e disa policëve për trupat franceze të KFOR-it, duke thënë: «Njerëzit e vetëm kundër të cilëve ata janë në gjendje të luftojnë jemi ne -- mu ashtu sikur që vepruan në prill 2002».⁸⁶

⁸³ Kur ICG-ja parashtrroi këtë pyetje, ata anashkaluan ngjarjen por më vonë ata dhanë mendimin e tyre se ngjarja nuk ishte plotësisht e pavërtetë përderisa Brigada po përgatitej për mbrojtje masive të veriut të Mitrovicës pasi që sipas tyre, një forcë prej 12-15.000 shqiptarësh të armatosur ia kishin mësyre qytetit. Përderisa shumica e forcave të KFOR-it ishin koncentruar në veriun e Mitrovicës, Brigada kishte dërguar një ose dy kompani për të mbajtur nën kontroll zyrën rajonale të UNMIK-ut në jug të qytetit. Shtabi i policisë rajonale të UNMIK-ut ishte jasht parametrave defansivë përrreth ndërtesës së UNMIK-ut. Urdhëri për të djegur shtabin rajonal të policisë ka kaluar vetëm sipërfaqësisht tek opinioni i gjerë kosovar, sidomos me një artikull të shkruar nga Baton Haxhiu për gazetën "Java" (8 prill), të ribotuar prap në gazetën *Epoka e Re*. Në të vërtetë, a është dhënë një urdhër i tillë nuk është bërë ende e njohur.

⁸⁴ Intervistë e ICG-së me burime të SHPK-së. Posa u dëbuan pjestarët e SHPK-së nga stacioni policor në jug të Mitrovicës, më shumë se 100 policë u kthyen në qendrën poicore regionale e cila gjendet në afërsi, ku mbajtën një takim dhe vendosën që të vazhdojnë punën dhe të mos e pranojnë urdhërin e KFOR-it për të shkuar në shtëpi. Në kohën sa ishin duke e mbajtur takimin, tre përfaqësues nga KFOR-i erdhën dhe kërkuar nga ata që ta lirojnë ndërtesën. Sipas raporteve, ata mbanin bombola me materie të papërcaktuara, duke shkaktuar në këtë mënyrë frikë te pjestarët e SHPK-së dhe të Policisë së UNMIK-ut se do ta

digjnin ndërtesën në mënyrë që të mos e lejojnë SHPK-në të veprojë në jug të Mitrovicës. Megjithatë, SHPK-ja vazhdoi aktivitetin e saj në jug të qytetit dhe forcat e KFOR-it nuk i penguan ata të patrullonin nëpër rrugë.

⁸⁵ Intervistë e ICG-së, Prishtinë, 1 prill 2004.

⁸⁶ Kur pjestarët e Policisë së UNMIK-ut janë sulmuar me armë nga "Rojet e Urës" në Mitrovicë më 8 prill 2002, trupat franceze të stacionuara në urë nuk kanë intervenuar në mbrojtje të policëve të UNMIK-ut (kryesisht policë specialë polakë) (26 prej tyre janë lënduar) por në vend të kësaj ata i drejtuan armët kah Policët e UNMIK-ut të cilët po tentonin të kalonin urën nga ana jugore për të ndihmuar kolegët e tyre në anën veriore të urës. Policët e UNMIK-ut mëpastaj dizajnuan maica ku përshkruhej roli i KFOR-it në përlëshje, të cilat iu

Përkundër urimeve, sic ishte mesazhi përgëzues i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, gjatë vizitës së tij më 22 mars, kur tha se: «KFOR-i ishte në krye të detyrës»,⁸⁷ akuza të vogla u bënë prapa skenave ndërmjet organeve të ndryshme të rendit e sigurisë. Brenda disa ditëve konfliktet e brendëshme u vunë nën kontroll nga ana e UNMIK-ut duke shuar zërat e zyrtarëve të policisë, e posaqërisht duke shuar zërat kritik ndaj KFOR-it. Para vënies së këtij kontrolli, këta zyrtarë ishin dëgjuar të kishin thënë: «Cili është qëllimi i ekzistimit të një ushtrie e cila tërhiqet sapo të vërejë shenjën e parë të ndonjë problemi?»⁸⁸ Duke pasur në mendje fshatrat sebe të shkatërruara edhe përkundër faktit se ishin në afërsi të bazave të mëdha të KFOR-it, trupave franceze e italiane, ata pyesin nëse ndonjëri prej zyrtarëve të lartë të ushtrisë do të japë përgjegjësi për ate që ndodhi. Ata flasin për «Sindromin e Srebrenicës» («nëse nuk ke trupa të mjaftueshme atëherë dorëzohu, në vend se të jesh i gatshëm që të qëndrosh dhe të luftosh deri në ushtarin e fundit») në KFOR dhe në vështirësinë që do të kenë ata që ndonjëherë të mbështeten në një forcë mbrojtëse të dominuar nga NATO.

KFOR-i ka qëndrim diametralisht të kundërt. Jozyrtarisht ai flet për një kolaps të forcave policore gjë që i detyroi forcat e KFOR-it që të bëjnë çdo gjë nga zeroja. Besimi i tyre në SHPK-në është shkatërruar, pasi sipas tyre SHPK-ja iu është shmangur përgjegjësisë të veta dhe flet për pastrim të rradhëve apo edhe për zhveshje të pjestarëve të saj. KFOR-i ka kërkuar të rikthejë përgjegjësitë të cilat ia pat dorëzuar policisë dhe në përgjithësi të vendoset mbi strukturat e UNMIK-ut. Përbrenda strukturave të sigurisë, KFOR-it ka filluar që të dominojnë me mënyrat e veta të interpretimit të ngjarjeve.

Si shenjë që tregon për vlimet prapa skene është vendimi i 24 marsit për largimin («transferimin») e zëdhënësit të policisë së UNMIK-ut, Derek

shitën dhe me të hollat e grumbuluara u ndihmuan të plagosurit, posaqërisht policët polakë. Shih raportin e ICG-së, "Albatrosi Kosovar i UNMIK-ut". Prishja e raporteve ndërmjet KFOR-it dhe Policisë së UNMIK-ut ishte tanimë e evidente pas ngjarjeve të dhunëshme në Mitrovicë, në shkurt 2000. Shih raportin e Amnesty International, "Përcaktimi i standardeve: Reagimi i UNMIK-ut dhe KFOR-it ndaj dhunës në Mitrovicë", 13 mars 2000, të cilën mund ta lexoni në <http://web.amnesty.org/library/Index/ENGEUR700132000?open&of=ENG-YUG>.

⁸⁷ Konferenca për shtyp në qendrën e UNMIK-ut, 22 mars.

⁸⁸ Intervistë e ICG-së me burime kompetente të policisë, 23 mars 2004.

Chappell, dhe dhënien e urdhërave strikte të gjithë zëdhënësve rajonalë të policisë së OKB-së që ulën nivelin e komenteve "spontane" si dhe vënë një rregullore të re informative restriktive. Në betejën për shpjegim dhe fajësim, SHPK-ja është në fund të «piramidës së ushqimit» dhe paraqitet si humbëse -- e shikuar me dyshim për shkak të lidhjes etnike me pjesëmarrësit në trazira dhe e pa një zë që do të fliste për të. Morali në rradhët e policisë, posaqërisht SHPK-së, po dëmtohet pikërisht atëherë kur duhet të forcohet. Intervistat që ICG-ja bëri me pjesëtarë të SHPK-së, në fillim të prillit, zbuluan nivele të rrezikshme të zemërimit dhe poshtërimit: «Nëse do të ketë shpërthim përsëri dhe nëse ndërkombëtarët na trajtojnë siç po na trajtojnë tani, atëherë pjestarët e SHPK-së, thjeshtë, do të hedhin uniformën e tyre». Ekziston një bindje gjithandej se SHPK-ja po provokohet që të dështojë dhe të shpërbëhet, njësoj siç ka bërë me paraardhësen e saj Milosheviqi në fillim të viteve 1990.

Në anën tjetër, përkundër dëmit në kuadër të politikës ndërkombëtare që i bënë vetes shqiptarët e Kosovës, në terren, dhuna dy-ditëshe ka ndëruar disa gjëra në favor të shqiptarëve të Kosovës. Edhe pse vetëm një numër i vogël i tyre mori pjesë në mënyrë direkte në demonstrata e dhunë, shumica prej tyre nuk ndihen të pakënaqur që shqiptarët me forcë u treguan edhe serbëve edhe ndërkombëtarëve se ata janë komuniteti dominues të Kosovës. Deri më 17-18 mars, gara për dominim dukej të ishte një aferë tri-palëshe pa ndonjë zgjidhje në horizont, me një ndjenjë shqetësimi në rritje ndër shqiptarët se po detyroheshin që t'i nënshroheshin asaj që ata e konsideronin arrogancë dhe imponim i UNMIK-ut/KFOR-it e serbëve. KFOR-i po shihej gjithnjë e më pak si partner e gjithnjë e më shumë si kuazi-okupator. Tutela përlulëse e UNMIK-ut nuk po dërgonte askund. Duke bllokuar rrugët dhe duke i rrahur motoristët shqiptarë, serbët ende o po silleshin sikur ata të ishin të zot e vendit. Sipas shqiptarëve të Kosovës këto mardhënie tani kanë ndryshuar. Konfidenca e UNMIK-ut është lëkundur, pasi stafi i tij tash brengoset për sigurinë e vet. Disa policë ndërkombëtarë u fshehën prapa kolegëve të tyre të SHPK-së më 17 mars. Serbët e Kosovës tani janë të strukur e të shqetësuar.

Brigadat Shumëkombëshe të KFOR-it kanë reaguar në mënyrë të ndryshme në sfidave me të cilat është përballur autoriteti i tyre. Marrëdhëniet e ndryshme që pjestarët e KFOR-it kanë zhvilluar me homologët e tyre vendorë nëpër regjione të ndryshme, e ka bërë KFOR-in formë më pak unike. Dhuna krijoi një lloj kantonizimi të sigurisë ku dolën në sipërfaqe

dallimet kombëtare dhe prioritet e ndryshme të kontigjenteve të KFOR-it. Në fillim të prillit, një burim i lartë i KFOR-it në mënyrë thumbuese tha: «Nëse kjo do të ndodhë edhe një herë, ndoshta do të shkojmë një hap më tutje dhe do të fillojmë të shtiejmë në njëri-tjetrin». Më 17 prill brenga e tij u bë realitet edhe atë në formën më të tmerrshme të saj, në formë të gjaujtjeve me armë ndërmjet pjestarëve jordanezë dhe amerikanë të Policisë së UNMIK-ut ku 3 policë mbetën të vrarë dhe 11 të plagosur.⁸⁹

Gjatë protestave dhe pas tyre, në njërën anë trupat franceze të KFOR-it u gjetën në të njëjtën anë me civilët e armatosur serbë në veri të Mitrovicës. Udhëheqësitë e të dyja palëve mbajtën disa takime për menaxhim të krizës. Në anën tjetër, kriza e krijuar, në mënyrë të dukshme ka ndikuar në konsolidimin e partneritetit të ngushtë ndërmjet trupave amerikane dhe organizatës pasardhëse të UÇK-së, TMK-së, të cilët kanë patrulluar së bashku për gati një javë rresht nëpër disa rajone. Kështu trupat amerikane të KFOR-it i dhanë TMK-së rol në sigurinë publike që aq shumë e lakmonte e që vazhdimisht ia mohonte UNMIK-u dhe komanda qendrore e KFOR-it.

Në përgjithësi, 17-18 marsi ka parashtruar pyetjen nëse KFOR-i duhet të vazhdojë edhe më tutje rrugën e konfrontimit me TMK-në apo duhet të bashkërendojë me të. Në të vërtetë, kjo dilemë po paraqitet në formë të përcaktimit pro apo kundër “luftës çlirimtare” të shqiptarëve të Kosovës.

Ndër brigadat rajonale të KFOR-it, Brigada Shumëkombëshe - Qendër, evropiano-skandinave, u tregua më e vendosura që të mbajë me çdo kusht supremacinë në sferën e sigurisë. Lufta e egër që bëri në Çagllavicë ishte një dëshmi për këtë, siç ishte edhe refuzimi kategorik që të thirrnin për ndihmë TMK-në, pasi që kjo, sipas tyre, do të ishte pranim i dështimit dhe dorëzim, ndoshta pa kthim, të çështjes së sigurisë në duart e ish-rradhëve të UÇK-së. Një burim i KFOR-it ka komentuar: «Nuk kemi dashur të duket se ne nuk mund t’ia dalim në krye».⁹⁰

Brigada Shumëkombëshe - Lindje, e udhëhequr nga trupat amerikane, ka një histori të partneritetit me TMK-në dhe qelizat e rezistencës së shqiptarëve të Kosovës.⁹¹ Më 18 mars ata i ftuan eprorët e TMK-së për të ndihmuar në ndaljen e konfrontimeve në Ferizaj dhe Gjilan. Imri Ilazi, komandant i Zonës VI të TMK-së ishte sjellur në Ferizaj aty ku një turmë njerëzish i kishte rrethuar ushtarët amerikanë në kishën ortodokse për dy ditë me rradhë. Turma iu bind thirrjes së Ilazit për tu larguar (por vazhduan të sulmojnë shtëpitë dhe kishat serbe në dhe rreth Ferizajit). Në Gjilan, Kryetari i Komunës Lutfi Haziri, KFOR-i, SHPK-ja dhe TMK-ja kanë vepruar së bashku për të qetësuar turmat e njerëzve. Që nga 18 marsi, TMK-ja është vendosur të ruajë kishën ortodokse atje. Për pesë ditë pas traziarve, KFOR-i, SHPK-ja dhe TMK-ja patrulluan së bashku në komunën e Vitisë duke përfshirë këtu edhe kufirin me Maqedoninë. Në Prizren, trupat gjermane të KFOR-it nga Brigada Shumëkombëshe - Juglindje poashtu ftoi TMK-në për ndihmë në shpërndarjen e turmave më 18 mars.

Trupat franceze të KFOR-it, që udhëheqin Brigadën Shumëkombëshe - Verilindje, që u «ushqyen» me informatën shumë të ekzagjeruar për bandat e mëdha të shqiptarëve, veprimi bazuar në mosbesim latent për palën shqiptare të SHPK-së. Edhe në shprehje edhe tradia e marrëdhënieve të përzemërta me serbët në veri të Mitrovicës. Trupat franceze të KFOR-it dhe policia morën përgjegjësinë për të mbrojtur qytetin e Mitrovicës ndërsa serbët nuk u nxorën telashe duke dalur të armatosur në rrugë. Por, të gjithë e kishin kuptuar se ata ishin gati si forcë rezervë e për më tepër dihej se një numër pjestarësh të forcave speciale të Serbisë, të veshur në rroba civile kishin arritur dhe ishin bashkuar me ta. Një vëzhgues ka raportuar për ICG-në se ka parë civilët serbë duke grupuar istikame për tu pozicionuar në kodrat e Zveçanit. Komanda qendrore e KFOR-it i kishte thënë Gjeneralit Michel se nuk kishte forca për të përforcuar brigadën e tij. Po që se grupet e armatosura të shqiptarëve do të

⁸⁹ Pasojat e incidentit, dy amerikanë dhe një jordanez të vdekur; dhjetë amerikanë dhe një austriak të plagosur.

⁹⁰ Intervistë e KFOR-it me Jeta Xharrën, gazetare e IWPR--së më 19 mars, e konfirmuar më vonë në një intervistë të ICG-së me burime të KFOR-it.

⁹¹ KFOR amerikan besohet ti ketë ofruar ndihmë organizatës pasardhëse të UÇK-së, Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë Medvegjë e Bujanovc, (UÇPMB), në futjen e armëve nga Kosova në Serbinë Jugore deri në tetor 2000, si formë për minimin e sundimit të presidentit Milosheviq. Në maj 2001 i dyshuari kryesor për sulmin me bombë të autobusit të Nish - Ekspresit (ku 11 serb të Kosovës janë vrarë) ka ikur nga baza kryesore e Ushtrisë Amerikane në Kosovë, kampi "Bondstill"; ikja e tij nga një ambient me një siguri aq të lartë nuk është sqaruar. Shih artikullin e Anthony Loyd në *The Times*, "Një luftë e vogël shumë e ndyrë", 14 maj 2002.

depërtonin në pjesën veriore të Mitrovicës, KFOR-i nuk do të kishte as forca e as bazë morale të ndalonte forcat serbe të depërtonin nga kufiri në Merdare për të shpëtuar serbët e veriut të Kosovës.

Për ekstremistët dhe kriminelët, 17-18 marsi tregoi se KFOR-i mund të mundet dhe kështu krijuan rrethana për mundësi të reja të paparshikueshme. Niveli i armiqësisë i shprehur kundër UNMIK-ut tani është tepër shqetësues për personelin e tij -- posaqërisht duke pasur në mend përvojën nga Baghdadi - sa që tani shikohet si e mundur që t'i jepet një shtytje pëfundimtare misionit që të detyrohet të mbyllet e të evakuohet.

As Beogradi nuk ka lënë pa kuptuar se KFOR-i nuk është në gjendje që me çdo kusht të mbajë Kosovën dhe të garantojë siguri për serbët e Kosovës. Gjatë dhe pas ngjarjeve, shumë politikanë serbë kërkuan nga forcat serbe që të hyjnë në Kosovë për të mbrojtur popullatën serbe. Ndër këta politikanë ishin ata të Partisë Radikale Serbe (SRS), të Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), partisë së Milosheviqit, dhe ata të Partisë Demokratike të Serbisë. Duke pasur parasysh se ndryshimet e fundit në politikën e Serbisë⁹² sollën edhe largimin e Ministrit reformist të mbrojtjes, Boris Tadic, kuptohet se në armatë po ngriten në krye elementet ekstremiste që dëshirojnë kthimin në Kosovë. Nëse KFOR-it tregohet njësoj impotent në një pastrim etnik të ardhshëm apo edhe në dhunë edhe më të paktë kundër serbëve, politikanët në Beograd do të përballen me presion të fuqishëm për intervenim ushtarak.

KFOR-i tanimë nuk ka numër të mjaftueshëm të trupave në Kosovë për të qenë në gjendje që të përballlet me një intervenim të ushtrisë serbe. Pjesa më e madhe e armatimit të rëndë është zëvendësuar me armë të lehta. Shumë në KFOR dhe NATO mendojnë se Serbia nuk do të rrezikonte ardhmërinë e saj në BE duke vepruar ushtarakisht. Por, këta ndoshta nuk i kuptojnë ndërimet në skenën politike në Beograd dhe se kthimi i së paku një pjese të Kosovës nën kontrollin serb është duke fituar supremaci mbi politikën pro-Evropiane.

VII. REAGIMET

Me disa përjashtime të vogla, që janë për çdo lëvdatë, liderët e shqiptarëve të Kosovës, mediat dhe shoqëria civile në përgjithësi nuk ia kanë dalur që të kapërthejnë mendërisht në mënyrë të duhur dhe pastaj të përballen me të, të keqën e bërë më 17 e 18 mars. Ata dhe ndërkombëtarët tani ka rrezik të tërhiqen në dy botëkuptime e shpjegime të ndara të ngjarjeve brutale dhe kështu të hapin një hendek të keqkuptimit por edhe neverisë së ndërsjellë. IPVQ-ja dhe UNMIK-u janë në gjendje mohimi dhe të shkëputur nga realiteti në mënyrë alarmante. Brenda pak orëve pothuajse të gjitha institucionet vendore të ndërtuara gjatë këtyre pesë viteve nën tutelën dhe me paratë ndërkombëtare që të veprojnë si bedena të «demokratizimit» u shëmben dhe u bënë një me turmën shkatërrimtare.

Pjesa dërmuese e njerëzve në IPVQ ende nuk e kuptojnë qartë dëmin e shkaktuar. Ata janë në gjendje mohimi dhe nuk shohin se shoqëria e tyre tani përnjëherë ka humbur nurin; nuk janë në gjendje të kuptojë se në ato dy ditë të çmendura, të këqia, shqiptarët kanë humbur përgjithmonë imazhin e ëmbël të të qenurit të viktimizuar gjatë dhjetë viteve të represionit dhe një viti të krimeve monstruoze dhe tani kanë fituar statusin e të flakurit nga shoqëria, atë të të syrgjynosurit. Shumica e liderëve politikë vazhdojnë të provojnë t'ia qëllojnë se çfarë mendojnë votuesit e tyre dhe pastaj t'ua bëjnë qejfin këtyre, duke i quajtur trazirat «protesta», «revoltë» apo duke përdorur eufemizma tjerë që nuk zbulojnë kualitetin thelbësor të tyre: «një nga format më të ndyta e më shtazarake të sjelljes njerëzore: vrasja e të huajve nga turma».⁹³ Edhe atëherë kur dhuna pranohet, theksi vihen në të kërkuarit fjalje për sulmet kundër ndërkombëtarëve e kur duhet pranuar haptazi se serbët dhe monumentet kulturore e religjioze serbe janë sulmuar, atëherë kafshojnë gjuhën dhe nuk hapin gojën.

Në anën tjetër, UNMIK-u me reflekset e veta për të ruajtur dhe rimëkëmbur vetveten tenton të eliminojnë çdo mundësi për reflektime radikale dhe vlerësime kritike përbrenda misionit. Mungesa e dukshme e aftësive për të rivlerësuar vetveten po bën që, me inercion, të rivendoset politika e vjetër.

⁹² Shih Raportin e ICG-së për Evropë No. 154, "Serbias U-Turn", 26 mars 2004.

⁹³ Definicioni hyrës i Donald Horowitz në librin e tij "The Deadly Ethnic Riot" ("Trazirat e përgjakshme etnike"), op. cit, p. xiii.

Dhuna e 17 e 18 marsit ka filluar që të «paketohet» si një «shkarje» e çastit dhe UNMIK-u është duke e mashtruar veten me ëndëren e dalldisur për kontinuitetin e vet, duke menduar se çdo gjë mund të vazhdojë ashtu siç ka qenë përpara - «rikthim në binarë» - pas një krahitjeje të shpejtë. Zyrtarët ndërkombëtarë, civilë e ushtarakë, kanë përvetësuar idenë ortodokse se dhuna ka qenë e planifikuar paraprakisht dhe e organizuar nga një grup ekstremist koherent, i unifikuar e klandestin, pikëpamje kjo që me të madhe ndikon që rasti i 17 e 18 marsit të shpjegohet e mbyllet duke u vlerësuar si një anomali e shkëputur nga proceset. Në vend se të pranojnë, madje edhe të protestojnë për atë se politika dhe mandati që u ka dhënë bashkësia ndërkombëtare e brenda të cilit janë të detyruar të punojnë janë joadekuate aq sa janë bërë të rrezikshme, UNMIK-u ka filluar që përsëri «të vizatojë» realitetin ashtu që t'ia përshtasë politikave. Kjo është rrugë që shpie në bela.

A. SHQIPTARËT E KOSOVËS

Mediat, shoqëria civile dhe politikanët e shqiptarëve të Kosovës, që të gjithë u zunë të befasuar nga shpërthimi në Mitrovicë dhe përhapja e shpejtë e dhunës. Ata u gjetën të kapluar nga ngjarjet që nuk i kuptonin. Në fillim, lajmet në TV për dhunën në Mitrovicë vinin ngadalë dhe të cinguar, por shumë shpejtë kanalet filluan të transmetojnë koncerte të muzikës klasike - mënyrë klasike në Evropën Lindore për të vepruar në kohë të ngjarjeve të rënda - dhe me raporte me ton të thirrjeve për mobilizim për luftë: dehëse, ngazëllyese, krejtësisht të njëanshme dhe pa konsiderata morale. Madje edhe Kosova Action Network (KAN), organizatë «liberale» në kuadër të shoqërisë civile, që deri më 17 mars krenohej se po ndërtonte marrëdhënie me komunitetet pakicë, doli në opinion me një komunikatë që tingëllonte si ultimatum luftënxitës drejtuar UNMIKU-t.⁹⁴

⁹⁴ Komunikata e "KAN"-it thoshte, ndër të tjera: "Nuk është hera e parë pas lufte që qytetarët shqiptarë, veçanërisht ata në veri të Kosovës, por edhe qytetarët e komuniteteve tjera, kanë qenë cak i kriminelëve. Kjo ka qenë e mundur pasi Kosova qeveriset nga regjimi jodemokratik i UNMIK-ut. Tolerimi i strukturave paralele dhe veprimit të shërbimit sekret serb, që vetëm sa u bëjnë dëm edhe vet serbëve, është bërë i padurueshëm. Qytetarët e Kosovës janë ngulfatur nga pushteti hegjemonist i UNMIK-ut dhe të zhgënjyer me pushtetin kukull të institucioneve të Kosovës. Institucionet e Kosovës janë ndërtuar dhe veprojnë në kuadër të kornizave

Politikanët u gjetën të lënë prapa nga të rinjtë shqiptarë të moshës së luftës, që kishin parë se si në Kosovë në vitin 1998 dhe në Maqedoni më 2001, për disa muaj, dhuna arrinë atë që vite të tëra të politikës dhe diplomacisë së durueshme nuk ia dalin të prodhojnë; dhe tani po shpallinin aktvendimin për dështimin e pesë viteve të sundimit të UNMIK-ut dhe dy viteve të bashkëpunimit me IPVQ-në, për t'i zëvendësuar me një progres të prekshëm drejt pavarësisë. Ata (politikanët) në rangje më të ulëta, më 17-18 mars, përnjëherë vendosën që të ndërojnë preferencat e tyre për kompromise të urta të lidhshpimit të tyre të paslutës me formave më elementare të pazarllëkut që i bënte turma.

Në Asamblenë e Kosovës, politikanët bënë një thirrje formale, më tepër ceremoniale, për qetësi dhe rend, por edhe nxituan të bëjnë një listë të kërkesave dhe ankesave në drejtim të UNMIK-ut, duke përmendur dështimin në luftimin e strukturave paralele dhe «grupeve kriminale nga Serbia». Vetëm kryeministri Bajram Rexhepi reagoi me të shpejtë duke udhëtuar vet në Mitrovicë për të apeluar për qetësi. Megjithatë, edhe ai u duk sikur i mungonte vetbesimi kur adresoi mesazhin e tij në televizion. UNMIK-u dhe zyret diplomatike të vendeve kryesore, «Quint»-it, (SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania dhe Italia) u takuan me IPVQ-në dhe liderët e partive politike pasdite vonë që të dakordohen dhe të përpilojnë një apel drejtuar njerëve që të kthehen në shtëpitë e tyre, gjë që qe transmetuar në televizion. Por, Ministri i Shërbimeve Publike, Jakup Krasniqi, që përfaqësonte PDK-në në vend të Hashim Thaçit që ndodhej në SHBA, refuzoi që të nënshkruante deklaratën dhe lëshoi takimin, duke thënë se shqiptarët kanë bashkëpunuar tepër gjatë me UNMIK-un dhe nuk kanë fituar asgjë dhe se ai kishte vendosur që të qëndronte në anën e popullit. Atë pasdite, UNMIK-u shpresonte edhe se shefi i TMK-së, Agim Çeku, do t'i drejtohej popullit nëpërmjet televizionit dhe do të thoshte se mbytja e

që nuk mbrojnë interesat e qytetarëve dhe nuk përfaqësojnë vullnetin e tyre. Një sistem i këtillë politik, duke mos ofruar shansë dhe zgjidhje institucionale e demokratike, bëhet represiv dhe ai nuk mund të llogaritet më në lojalitetin e qytetarëve që nuk i respekton. Rrjedhimisht, ata që e kanë pushtetin (UNMIK-u) dhe ata që shtiren se e kanë pushtetin (institucionet e Kosovës) janë përgjegjës për ngjarjet tragjike dhe për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhemi. Tejkalimi i kësaj situatë dhe progresi i Kosovës në përgjithësi, para së gjithash, varen nga respektimi i vullnetit të qytetarëve të Kosovës që nënkupton edhe shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Moskuptimi ose mospranimi i kësaj vetëm sa do ta thellojë krizën.”

fëmijëve ka qenë një aksident dhe se në të nuk ishin të përzier serbët.⁹⁵ Në mbrëmje, Çeku bëri thirrje për qetësi por mesazhin e tij e «mbështjelli» me kritikata për strukturat paralele serbe. Në diskutimet televizive në mbrëmje, nga arsyetimet banale të dhëna nga shumica e politikanëve vendorë, vetëm Xhavit Haliti i PDK-së u veçua. Ai lavdoi punën e mirë të bërë nga UNMIK-u për Kosovën dhe fajësoi klasën e vet politike se po kontribuon në përkeqësimin e gjendjes duke drejtuar «goditje të ulëta» kundër UNMIK-ut.⁹⁶

Lajmet televizive në pasditen dhe mbrëmjen e 17 marsit paraqitnin histerinë e rrugëve. Mesazhi i tyre kryesor ishte se duhej mobilizuar, se kombi shqiptar në Kosovë po sulmohej dhe se njerëzit duhet të nxitonin ta mbronin atë. Korrespondentët në terren u identifikuan me demonstruesit dhe morrën anën e tyre. Mëngjesin e ditës së nesërme, gazetata u sollën sikur të mos kishin parë mirë dhe nuk zbulonin peshën e vërtetë të trazirave, caqet dhe viktimat. Vëmendja përqëndrohej vetëm në viktimat shqiptare.

Ditën e dytë, në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, në vend se të përqëndroheshin në ndaljen e dhunës, politikanët e shqiptarëve të Kosovës e hedhnin poshtë fajin dhe arsyetonin atë që po ndodhë. Ata konkluduan se fajin e kishte UNMIK-u dhe se zgjidhja e vetme për frustrimet e akulumuara të shqiptarëve të Kosovës ishte që sa më parë tu iplej pavarësia. Në një debat të drejtëpërdrejtë në TV, në mbrëmjen e 18 marsit, derisa të rinj e fëmijë

shqiptarë po bënin hatanë krejt afër ndërtesës së televizionit, duke u përpjekur e më në fund edhe duke ia dalur që të djegin kishën ortodokse, që ndodhej pranë, politikanë të lartë nga tri partitë kryesore të shqiptarëve të Kosovës, LDK, PDK e AAK, ziheshin me koordinatoren për strategji të UNMIK-ut, Carne Ross, duke thënë se IPVQ-ja nuk ishte përgjegjëse për dhunën sepse nuk kishte kompetenca dhe se duhej t'i iplej më tepër pushtet. Vendimi i kryeministrit atë natë që të përballë turmën në Veternik (dhe e ministrave që e shoqëruan atë) ishte e vonuar megjithatë e guximshme. Një vëzhgues i afërt me rrjedhat u shpreh se «nuk ishim të sigurtë nëse do të kthehej fare». Më vonë atë natë në TV u paraqit edhe lideri i PDK-së, Hashim Thaçi, i cili e kishte ndërprerë vizitën e tij në SHBA. Ai ishte politikani i parë kosovar që u përpoq t'i adresoj opinionit në mënyrë të drejtë për drejtë e me zë autoritativ (t'i flasë me gojën plot, siq thonë shqiptarët) - duke përkujtuar se çfarë ka bërë NATO për Kosovën. As porosia e tij nuk shkoi tepër largë - nuk pranoi në mënyrë eksplicite se serbët ishin viktima kryesore - por megjithatë ishte një hap më tutje se sa që ishin të gatshëm të shkonin politikanët tjerë. Duket se shumica kalkulonin qëndrimet e tyre duke pasur në mendje autoritetin e tyre të kufizuar ndër elektoratin dhe me këtë kufizonin veten.

Më 18 mars, lajmet televizive ende jepnin raporte të shtrembëruara në mënyrë groteske, siç ishte rasti kur RTK-ja tregonte për konfiskimin e dy armëve nga serbët në Obliq, edhe pse e vërteta ishte se shtëpitë e serbëve dhe ashkalinjve po sulmoheshin, plaçkiteshin e digjeshin. Një raport për djegien e Manastirit të Deviçit u përqëndrua në «mirësinë» e turmës që e kishte dorëzuar në polici një murgeshë të vjetër pa e prekur atë. Megjithatë, filluan të shtohen edhe thirrjet për qetësi.

Nga 19 marsi e tutje, raportimet mbetën të heshtura. Gazetat e shqiptarëve të Kosovës dhe mediat elektronike pasqyronin në mënyrë jo të plotë shkallën e dhunës dhe në pjesën më të madhe lanë pa prekur vuajtjet e serbëve. Një javë pas ngjarjeve, shqiptarët e pyetur nga ICG-ja, në Prishtinë, nuk dinin fare për shkatërrimin pothuajse të plotë të bërë në fshatin Frashër/Svinjare, kryesisht i banuar me serbë. Pamja tmerruese e 125 deri 140 shtëpive të shkatëruara nuk arriti as në TV as në gazeta deri më 28 mars, kur «Koha ditore» më në fund shkroi një artikull. Por, edhe ky rrëfim ishte i gjeneralizuar dhe kalonte në atë se si shtëpitë e shqiptarëve të këtij fshati qenë djegur nga serbët në qershor të vitit 1999. Edhe pse ishin 30 kisha ortodokse serbe dhe

⁹⁵ Ky ishte një keqkuptim përbrenda UNMIK-ut. Të martën mbrëma e para thashetheme ishte se serbet i kanë mbytur në ujë fëmijet me duart e tyre. Një zyrtar i huaji pyeti Çekun të verifikoj këtë me anëtarët e TMK-së të cilët ishin në vendin e ngjarjes duke kërkuar trupat e tre djelmohave të raportuar të humbur. Çekut i ishte thënë se kjo thashetheme ishte e pabazë, por kjo la të hapur çështjen nëse ishin ndjekur apo jo këta djemë në lumë.

⁹⁶ Kjo vlen të vërehet veçanërisht kur kihet parasyshë se Haliti ishte një nga furnizuesit kryesorë të UÇK-së me armë. Haliti është një nga figurat më kontraverse në skenën politike të shqiptarëve të Kosovës. Edhe pse flitet se ka mbajtur lidhjet e tij të kontrabandimit të armëve dhe se është udhëheqës i strukturës së sigurisë të dalë nga UÇK-ja, SHIK-u misterioz (që dyshohet për pjesëmarrje në dhunën e 17-18 marsit), në muajt e fundit Haliti është dalluar për çasjen e tij të arsyeshme, konstruktive e tolerante në një numër çështjesh të ndryshme. Për shembull, në shkurt 2004, ai ishte i vetmi politikani shqiptar që kritikoi hapur muralet me skena nga historia shqiptare me të cilat ishin mbuluar muret e Kuvendit të Kosovës nga renovuesit, e që shtyen edhe PSSP-në Holkeri edhe deputetët serbë që të bojkotojnë Kuvendin për të protestuar mesazhin mono-etnik të muraleve.

dy manastire të shkatërruara apo të dëmtuara, udhëtimi i parë i ministrit të Kulturës, Behxhet Brajshori, jashtë Prishtinës, që të shihte pësimet në trashëgimin kulturore, ishte që të shihte se çfarë i kishte bërë turma e shqiptarëve, gabimisht, shtëpisë dhe atelesë së një skulptori shqiptar në Çagllavicë. RTK-ja e mbuloi këtë vizitë me kujdes të madh.

Kur kërkohej falje, kjo bëhej për sulmet kundër ndërkombëtarëve por jo edhe për ato kundër serbëve të Kosovës. Më 19 mars, tre liderët institucionalë, kryeministri Rexhepi, presidenti Rugova dhe kryetari i Kuvendit Daci, lëshuan këtë deklaratë:

Ne theksojmë se sulmet kundër prezencës ndërkombëtare në Kosovë, ushtarake e civile, janë krejtësisht të papranueshme dhe në kundërshtim me interesat vitalë të Kosovës. Prandaj, edhe një herë theksojmë se shkatërrimi i objekteve kulturore e religjioze, i shtëpive dhe pronës private, është i papranueshëm për popullin e Kosovës dhe është gjë e dënueshme.

Më 2 prill, liderët institucionalë dhe ata politikë të shqiptarëve të Kosovës, lëshuan një letër të përbashkët me të cilën u apeloni të gjithë qytetarëve të Kosovës që të lënë prapa dhunën, urrejtjen dhe frikën dhe të ndërtojnë një Kosovë në të cilën të gjithë do të jetë të mirëpritur. Me fjalë jo shumë të qarta, kërkohehin kontrata mes serbëve e shqiptarëve dhe mes popullit e liderëve politikë e religjiozë, që të bëhej kjo. Megjithatë, edhe pse pranohej se «serbët ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre ndërsa kisha ishin djegur», letra nuk shkonte aq largë sa të kërkonte falje.

Menjëherë nën sipërfaqe vërehej një ndjenjë e shpresës, si ndër politikanë ashtu edhe ndër opinionin, se ka gjasa që dhuna të ketë hapur rrugë për të lëvizur Kosovën nga gjendja e të qenurit e ngujuar. Gazeta e re, e afërt me LDK-në, «Pavarësia» e bëri këtë mëse publike më 24 mars, duke botuar një intervistë me Arian Starovën, ish-ministër i jashtëm i Republikës së Shqipërisë dhe tani deputet në Parlamentin e Shqipërisë, me titullin «Ngjarjet e fundit kanë shkurtuar rrugën e Kosovës drejtë pavarësisë». Lideri i LDK-së në Kuvendin e Kosovës, Sabri Hamiti, dënoi presionin që vinte nga zyrtarë aq të lartë ndërkombëtarë siç është Javier Solana, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së. «Ky është diktat. Institucionet e Kosovës nuk duhet të pranojnë këtë. Disa të ashtuquajtur përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare vijnë këtu në Kosovë dhe na tregojnë se si duhet të udhëheqim Kosovën dhe

qytetarët e saj. Ata duhet të kufizojnë rolin e tyre në atë që të bashkëpunojnë me IPVQ-në.⁹⁷ Hamiti shtoi se imazhi i Kosovës nuk ishte dëmtuar.

Më 20 mars, qeveria mori një vendim të mirë, me iniciativë të veten, që të marrë përgjegjësinë për financimin e rindërtimit të shtëpive dhe objekteve tjera të shkatërruara, duke ndarë 5 milion euro për këtë qëllim. Më 27 mars filloi puna për pastrimin e dëmeve në kompleksin e banesave të «YU Programit» në lagjen Ulpiana të Prishtinës. Edhe pse ky hap është për lavdatë, qeveria ka hezitur që këtë nismë për rindërtim të shfrytëzojë si instrument publik për të inkuadruar shoqërinë e gjërë kosovare në «pastrim nga faji». Kjo veçanërisht është në kontrast me mobilizimin e qeverisë/mediave/shou-biznesit, në vitin 2003, që të grumbullojnë donacione për mbrojtjen e të akuzuarit nga Tribunali i Hagës, Fatmir Limaj. Megjithatë, apelimi të opinionin shqiptar në Kosovë që të grumbullojë para për viktimat serbe është hap përtej kurajos që kanë liderët partiakë dhe institucionalë në Kosovë. Komuniteti i OJQ-ve i shoqërisë civile kosovare, ende i vogël, i përqëndruar kryesisht në Prishtinë dhe i bazuar nga fondet e donatorëve të jashtëm, ka ngritur zërin kundër dhunës ndërsa Rrjeti i Grave të Kosovës ka themeluar një fond për të përkrahur edhe familjet e fëmijëve të mbytur edhe një familje serbe të cilës i është djegur shtëpia në Fushë Kosovë/Kosovo Polje.

Më 24 mars, një grup ad hoc i OJQ-ve kishte thirrur një demonstratë në qendër të Prishtinës edhe për të shënuar pesë vjetorin e fillimit të bombardimeve të NATO-s edhe për t'u shprehur kundër dhunës. Demonstrata tërhoqi rreth 3.000 njerëz që kishin sjellur me vete lule - një simbol i qëlluar që do të mund të ishte bërë lajtmotiv për një fushatë më të madhe. Por, deri më sot, qeveria dhe shoqëria civile nuk ia kanë dalur që të ofrojnë një platformë për mobilizim kundër turmës që tani rrezikon që të formësojë dhe definojë shoqërinë. «Thuaje me lule» nuk ia doli t'ia zë vendin asaj «thuaje me vrasje».

Çuditërisht, shqiptarët e Kosovës, si me automatizëm, kremtuan 24 marsin e vitit 1999, fillimin e bombardimeve të NATO-s kundër serbëve në emër të tyre. Xhirimet e përgatitura më parë jepnin pamje të ditëve të çlirimit më 1999 dhe atë vetëm pak ditë pasi turma kishte sulmuar në mënyrë sistematike ushtarët e NATO-s, duke plagosur shumë prej tyre; panot nëpër rrugë dhe faqet e plota në gazeta përcjellnin porosinë e përvjetorit: «Falemnderit

⁹⁷ Sesioni Kuvendit të Kosovës, më 25 mars 2004.

NATO»! Presidenti Rugova bëri një urim solemn. Përkujtimet nëpër gazeta më 24 mars ishin përplot me fotografi të fëmijëve shqiptarë (veçanërisht fëmijëve), grave e burrave të vrarë nga forcat serbe më 1999. Ishte kjo një shoqëri e tërë në mohim, duke u përpjekur me dëshprim të mos lëshojë nga dora ndjenjën e të qenurit viktimë dhe kujtimin e ditëve kur për një çast ishte e ledhatuara e tërë botës.

Mediat elektronike «mbyllën rradhët» duke refuzuar çdo kritikë që u drejtohej atyre për sjelljen e tyre më 16-18 mars, duke thënë se e tëra që ndërkombëtarët dëshirojnë të bëjnë është që të hedhin tërë fajin tek mediat shqiptare dhe të mos marrin faj mbi vete. Për shembull, zëvendës-drejtori i RTK-së, Astrit Salihu, në një debat të 2 prillit, të emituar edhe në TV, derdhi vrer mbi Komisionerin e Përkohshëm për Media, Robert Gillette, duke folur zi për profesionalizmin e tij.

B. NDËRKOMBËTARËT

UNMIK-u dhe KFOR-i, njësoj, kanë fajësuar politikanët dhe institucionet e shqiptarëve të Kosovës se kanë dështuar që të dënojnë në mënyrë të duhur dhunën, se kanë treguar me gishtin e fajtorit kah UNMIK-u si dhe për letargji derisa tentohej të ndalej dhuna që po zhvillohej. UNMIK-u është futur në mentalitet mbrojtës, i zhgënjyer me shumicën e liderëve vendorë, me shpërthimin e armiqësisë kundër tij dhe i vetëdijshëm se puna e tij deri në ditët e dhunës tani ishte në fokus të vëmendjes së të gjithëve. Ndjenjë të pakëndshme shkaktonte ndeshja e këmbënguljes që të mos duket se po bën lëshime para dhunës dhe në të njëjtën kohë të kuptuarit se politika ekzistuese nuk ishte adekuate dhe ka kontribuar në shtimin e frustrimeve që sollën deri te shpërthimi.

Më 18 mars, nga qeveritë e botës, organizata rajonale dhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së erdhi një rebesch i dënimeve të dhunës dhe apeleve për qetësi. Pjesa më e madhe e këtyre reagimeve ishin në vija të trasha dhe as nuk fajsonin ndonjë palë e as nuk etiketonin atë që kishte ndodhur me fjalë tjera përveç se e quanin «dhunë ndëretnike në shkallë të lartë». Deklarata e Këshillit të Sigurimit të OKB-së la IPVQ-në të ndihej më lehtë se sa që do të duhej. Në Serbi, dhuna gjeneroi mbulim 24 orësh në TV, emocione të ngjashme me reagimet në SHBA gjatë sulmeve të 11 shtatit 2001 dhe trazira e djegie xhamishë.⁹⁸ Gjatë vizitës së tij në Prishtinë, më 19

mars, Komandanti i NATO-s për Evropë Jugore, Admirali Gregory Johnson i Armatës Amerikane, e shpiu tutje definimin e dhunës: «Ky aktivitet paraqet pastrim etnik dhe nuk mund të vazhdojë». Dy ditë më vonë, PSSP Holkeri zemëroi Serbinë kur për radion amerikane NPR tha se cilësimi «pastrim etnik» është tepër i rëndë e sidomos kur tha se «vetëm disa» kisha janë djegur. Në fakt, karakterizimi që i bënte Holkeri dhunës lëvizte sa lart sa poshtë duke hutuar edhe stafin e tij. Më 23 mars, ai e quajti dhunën «krim kundër njerëzimit», vepër për t'u tërhequr më pas nga kjo duke thënë se ky ishte më tepër një reagim emocional i tij se sa definicion juridik.

UNMIK-u vazhdoi të merret me vlerësimin edhe ashtu të tej-zmadhuar të shkallës së «angazhimit» të liderëve vendorë në dhunë dhe asaj se sa kanë mundur «të angazhohen» në ndaljen e saj. Cinikët vërejtën se sa shpejtë kryeministri Rexhepi ia doli të bindë turmën në Veternik që të qetësohet («brenda dy minutave»). Një burim nga strukturat e sigurimit u ankua se Rexhepi vetëm sa kishte «ridrejtuar» turmën (në drejtim të caqeve në Prishtinë) në vend se ta qetësonte atë. Deklarata të ashpra që flisnin për fajsinë e IPVQ-së erdhën nga Hoop Scheffer i NATO-s dhe Solana i BE-së, të cilët qëndruan në Prishtinë mes 22 e 26 marsit. Ata thanë se dhuna ishte e organizuar dhe e koordinuar dhe vunë përgjegjësinë për këtë mbi liderët politikë të shqiptarëve të Kosovës. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s nënvizoi se: «Nëse ndonjë lider shqiptar beson se dhuna është rruga për të arritur pavarësinë, atëherë këta duhet të dijnë se janë më larg nga ky cak sepse dhuna nuk do të shpërblehet asesi».⁹⁹ Derisa lavdëroi Rexhepin, Solana u shpreh se «ata që organizuan dhunën sipas të gjitha gjasave u takojnë partive politike në Kosovë. Por, liderët e këtyre partive politike duhet ta dënojnë atë publikisht dhe të dëshmojnë se kjo nuk është e vërtetë».¹⁰⁰

Përqëndrimi në elitën politike të Prishtinës dhe supozimi për ekzistimin e organizimit paraprak, komandimin dhe kontrollimin e trazirave nga një qendër, si dhe për ekzistimin e konspiracioneve klandestine ka rezultuar me nënçmimin e rolit që në shpërthimin e dhunës kanë pasur patologjitë sociale, tensionet dhe frika - si dhe të metat e vet bashkësisë

⁹⁸ Shih Raportin e ICG-së, "Serbia's U-Turn", op. cit.

⁹⁹ VIP Daily News Report, "Kosovo at a Glance", 26 mars 2004.

¹⁰⁰ Lajmet në transmetuesit televizivë të Kosovës, më 25 mars 2005, të përmbledhura në buletin e OSBE-së në Prishtinë, më 26 mars 2004.

ndërkombëtare. Një deklaratë e Hoop Scheffer-it është shembull:

Nuk mendoj se statusi i pazgjidhur ka të bëjë me këtë. Kjo ka të bëjë me njerëz që mendojnë gabimisht, që kanë iluzione se duke kryer akte të tilla kriminale, të dhunës etnike, do të jenë më afër aspiratave të tyre. Por, ata duhet të kuptojnë se bashkësia ndërkombëtare kurrë nuk do të lejojë këtë.¹⁰¹

Tendenca e zyrtarëve ndërkombëtarë, civilë e ushtarakë, që të vëjnë epiqendrën e dhunës në një konspiracion të organizuar në një qendër, e drejtuar nga lartë, në njëfarë mënyre është përsëritje e artificialitetit me të cilin bashkësia ndërkombëtare ka ndërtuar homologun e vet, IPVQ-në. Por, shoqëria e shqiptarëve të Kosovës nuk ka një zingjir komandues me një qendër të unifikuar komanduese. Secila komponentë organizative e misionit paqeruajtës në Kosovë ka shtytës të brendshëm që e shtyejnë që të shohë në trazira elementë të veçuar organizativë. Sinkronizimi i trazirave dhe elementet e organizimit brenda tyre kanë bërë mendjet ushtarake të KFOR-it që të imagjinojnë se kanë përballë një kundërshtar ushtarak me inteligjencë organizative qendrore. UNMIK-u shpreh nevojën burokratike të reagimit sipas inercionit të organizatës që të mbyllë dhe lëjë mënjanë atë që ka ndodhur më 17 e 18 mars që të mund të rifillojë të operojë si përpara. Idea se dhuna mund të reduktohet në prodhim të një komploti të ekstremistëve kriminelë dhe se ata përgjegjës për këtë mund të izolohen dhe të hiqen nga skena është jashtëzakonisht tëheqëse. Në vijë me këtë, më 22 mars, PSSP Holkeri i siguroi serbët në Lipjan se UNMIK-u i di gati të gjithë kryesit e dhunës, se policia është duke i ndjekur dhe se shoqëria duhet t'i izolojë ata.¹⁰² Në adresimin e tij para Kuvendit të Kosovës, më 9 prill, ai shkoi edhe më larg. Në kuadër të përpjekjeve për të rivendosur partneritetin politik me IPVQ-në dhe për të dalluar audiencën e tij nga ata përgjegjës për dhunën, ai ia përshkroi atë një klike të vogël të të «tjerëve»: «E di se kjo dhunë nuk ka qenë e bëmë e tërë shoqërisë. Ishte një e bëmë e një grupi të vogël njerëzish që kanë skemën e tyre të vetën për Kosovën». Kjo bën të përfundohet se UNMIK e sheh dhe e interpreton dhunën në mënyrë tepër politike sepse ky edhe është niveli në të cilin operon vet.

Ende kuptohet shumë pak hendeku i shkaktuar nga ngecjet në zhvillim të cilën gjë 17-18 marsi e kanë nxjerrë në pah. UNMIK-u nuk e ka «lexuar» këtë sepse është oranzatë që nuk është përqëndruar në nivelin zhvillimor.

Shihen vetëm filizat e të kuptuarit, ngadalë, se ndër popullatën shumicë të Kosovës, UNMIK ka humbur besimin dhe pajtimin pa kundërshtime me punën e tij. Në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit e ka themeluar atë si një mjet paqesues, të madh e të shtrenjtë, për të qenë në vend derisa të jetë në gjendje që të përcaktojë statusin final të Kosovës - një gjë kjo për të cilën bashkësia ndërkombëtare ka treguar shumë pak gatishmëri për t'u marrë me të që nga atëherë. Më 17 e 18 mars, UNMIK-u u bë cak i armiqësisë. Flamujt e tij u hoqën, godinat e tij u sulmuan dhe së paku 70 vetura të tij u dogjën - ishte ky një nishanizim i kujdesshëm pasi nuk preku veturat e BE-së, OSBE-së apo UNHCR-së. Nëse asgjë tjetër, kjo tregon se është e nevojshme që të bëhen disa ri-përkufizime të misionit.

UNMIK-u ka marrë parasyshtë disa këshilla të vendorëve dhe ka filluar të punojë më serizisht me popullatën e jo vetëm të bazohet në bashkëdyzimin e zakonshëm të këshillimit dhe presionit të shkurtë mbi IPVQ-në. Në «Letrën personale të PSSP Harri Holkeri drejtuar popullit të Kosovës», të datës 24 mars, shpreheshin edhe lëvdata njësoj sikur edhe fajet. Ishte kjo një përpjekje për të zbutur imazhin e UNMIK-ut ndër vendorët, duke zëvendësuar kështu arrogancën e zakonshme me pranimin verbal se ndoshta e ka pasur gabim diku.

Do të mund të ecim përpara vetëm nëse mësojmë nga kjo epizodë. Të gjithë ne duhet të reflektojmë për atë se çfarë kemi mundur të bëjmë dhe çfarë duhet të bëjmë tani që të prandandalojmë dhunën dhe trazirat e mëtutjeshme, e kjo vlenë edhe për UNMIK-un. E kuptoj frustrimin me përparimin e ngadalshëm në Kosovë. OKB-ja bën gabime. Ne do të reflektojmë për atë se si mund të bëjmë më shumë.

Mbetet të shihet nëse kjo ka qenë diç më shumë se një dredhi e përkohshme mediale. Fushata e UNMIK-ut që të pakësojë gjasat që zyrtarët e policisë të ofrojnë informata më parë tregon për bllokim se sa zhvillim të debatit, reflektime dhe kërkime. Për më tepër, burime nga brenda ankohen se forca e inercionit përbrenda organizatës është e tillë sa që edhe hapat më të vegjël drejt ndërrimit të politikës kërkojnë shpenzim të koordinuar të sasive të

¹⁰¹ "Sekretari i përgjithshëm i NATO-s akuzon politikanët e Kosovës", *Koha Ditore*, përmbledhur dhe përkthyer në Analizën e mediave të bërë nga UNMIK-u, më 23 Mars 2004.

¹⁰² VIP Daily News Report, "Kosovo at a Glance", 23 Mars 2004.

jashtëzakonshme të energjisë. Nëse pranimi i gabimit nuk pasohet me ndonjë hap për t'i përmirësuar këto gabime, kjo do të sjellë vetëm përkeqësim të mëtejshëm të gjendjes. Për shembull, mbetet të shihet se çfarë do të sjellë vendimi i Holkerit, i 9 prillit, që të zëvendësojë Marie Fucci-n nga posti i menaxheres së AKM-së. Ky hap duket të jetë «gjethe dafine» që u ofrohet shqiptarëve të Kosovës, edhe pse gjëja më esenciale është nëse kjo do të rezultojë me ndërim të vërtetë të politikës së privatizimit. Largimi i saj është bërë në mënyrë aspak elegante dhe vetëm më 22 prill UNMIK-u ka bërë të qartë se ajo më nuk mban postin që ka pasur.

Tani, më shumë se kurdoherë më parë (me çështjen e sigurisë së personelit të vet në qendër të vëmendjes), UNMIK-u duhet të raportojë realitetin kosovar në New York dhe kryeqytetet e Grupit të Kontaktit dhe të avokojë për një mandat dhe kornizë politike më adekuate. PSSP Holkeri që kritikuar shumë për shëtitjet jashtë Kosovës gjatë muajve të tij të parë të «sundimit» të tij, por këto ditë të ngujohet në Prishtinë nuk do të ishte aspak me vend. Tani është koha kur ai duhet të vizitojë të gjitha kryeqytetet e rëndësishme, të alarmojë dhe të kërkojë një mandat të ri. Do të ishte ironike që thash-e-thëmet e këtyre ditëve në shtypin shqiptar në Kosovë për dorëheqjen e tij të mundshme ta bëjnë atë që të qëndrojnë në Prishtinë për shkak të rajtjes së «fytyrës».

Rishfaqja e Kosovës pas trazirave si një ndër lajmet kryesore botërore duket se në fillim nuk ka gjeneruar shtytje të mjaftueshme ndër qeveritë e Grupit të Kontaktit sa për të nxitur mendime të reja në nivelet më të larta. Ndërprerja e dhunës pas tri ditëve dhe dërgimi i 3.000 përforcimeve të KFOR-it në fillim dukej se i ka kënaqur kryeqytetet dhe i ka bërë të mendojnë se tani për tani është bërë mjaft. Kosova ka fat të tillë që të tërheqë shpenzim minimal të energjisë në kuadër të politikës ndërkombëtare. Ndjenja e urgjencës e demonstruar nga Këshilli i BE-së duke emëruar më 29 mars një të dërguar të posaçëm për Kosovë nuk është reflektuar individualisht ndër vendet anëtare të BE-së.¹⁰³

¹⁰³ Në takimin joformal të ministrave të jashtëm të BE-së dhe vendeve që do të bëhen anëtare, në Irlandë, më 16-17 prill, Sekretariati i Këshillit të BE-së prezantoi një "non-paper" për Kosovën, duke kërkuar veçanërisht mbrojtje më të mire për pakicat dhe ri-aktivizim të politikës "standarded para statusit". Thuhet se vetëm Sllovenia, Hungaria e Luxemburgu kërkuan rishikim të politikës, ndërsa vendet e Grupit të Kontaktit refuzuan të pranojnë (së paku para vendeve më të vogla) se është e nevojshme të ndërrohet kursi. Intervistë e ICG-së me një burim në Brussels, 19 prill 2004.

Megjithatë, ka shenja se kjo do të mund të ndërojë. Themelimi i «Grupit përkras» për Kosovën nga ana e Grupit të kontaktit, duke involvuar këtu BE-në dhe të tjerët, e që do të vizitojë provincën çdo gjashtë javë tani e tutje, ofron së paku shpresë për një vëmendje të përqëndruar vazhdimisht dhe gjasa që tani Kosova të fillojë të ngritet më lartë në agjendat politike. Disa vende të Grupit të Kontaktit kanë filluar që të shqyrtojnë mënyrat se si të siten opcionet për atë se çfarë do të jetë statusi final i Kosovës - ashtu që të eliminohen disa nga paqartësitë destabilizuese në ekuacionin kosovar. Shenja të të menduarit të tillë mund të shihen në prononcimet e Ministrit për Evropë të Mbretërisë së Bashkuar, Denis MacShane, në konferencën për gazetarë të mbajtur në Prishtinë, më 21 prill: «Nuk ka kthim në vitin 1999, nuk ka kthim në 1989-tën».

Në ndërkohë, Grupi i kontaktit ka rritur orientimin e vendosur në vitin 2003 - implementimi i planit për standardet, me shqyrtimin e të arriturave në mesin e vitit 2005. Nënkretari i shtetit i SHBA-së, Grossman, vizitoi Prishtinën më 29 e 30 mars që të përcjellë këtë mesazh, e në fakt duke shtyer UNMIK-un që të prezantojë planin e detajuar për implementim para se ky të ishte gati, më 31 mars, edhe pse u pranua se pjesët që kanë të bëjnë me kthimin, të drejtat e komuniteteve dhe sigurimin e lirisë së lëvizjes duhet të shqyrtohen e korigjohen tani pas dhunës. Por, kësaj politike i janë prerë krahët. Trazirat e kanë prekur aq shumë parimin dhe idenë e «standardeve para statusit» sa që është e vështirë të imagjinohet një shqyrtim pozitiv i progresit në Kosovë kah mesi i vitit 2005. Programi i legjislacionit dhe hapave të përcaktuar në plan natyrisht që mbesin të mirëseardhur dhe të dobishëm, por nga këndvështrimi më i gjërë, bindja që ende mbizotëron se kjo paraqet një politikë për një blerje të kohës e bën këtë politikë më të pakëndshme se sa kurdoherë më parë. Sjellja e gazetarëve shqiptarë në konferencën për gazetarë në të cilën u prezentua plani për implementimin e standardeve ilustron sa pak vëmendje të opinionit tërheq kjo politikë. Kur patën mundësinë që t'u shtrojnë pyetje të dy koordinatorëve, Carne Ross nga UNMIK-u dhe Ilir Deda nga IPVQ-ja, gazetarët pyetën vetëm për arrestimet dhe të dhënat për viktimat.

Porjekti i standardeve për qeverisje të përbashkët multi-etnike në Kosovë tani ka konkurrencë serioze. Nëse propozimet e mëparshme të Beogradit për ndarje apo kantonizim të Kosovës hedheheshin poshtë nga bashkësia ndërkombëtare, harbutëria e dhunshme kundër pakicës serbe në Kosovë u ka dhënë këtyre

propozimeve kredibilitet dhe vrull. Kryeministri serb Koshtunica hasi në rezistencë në Burssels kur më 23 mars zyrtarisht prezntoi para zyrtarëve të BE-së planin për ndarjen e Kosovës në disa kantone mbi baza etnike. Por, zyrtarë edhe të BE-së edhe të Grupit të Kontaktit kanë dhënë sinjale se një formë më e butë e «decentralizimit» të Kosovës është e mundur. Vërtetë, decentralizimi i qeverisjes lokale mund të jetë mjet për shtimin e efikasitetit. Një plan i tillë, aq i debatuar, i Këshillit të Evropës që publikuar në gjysmën e dytë të vitit 2003. Por, tërë koncepti që prezentuar nga ish-PSSP-ja Steiner në vitin 2002 që t'i inkurajonte serbët e Kosovës që të marrin pjesë në zgjedhje dhe kishte një nën-tekst që ofronte rrugë drejt autonomisë territoriale lokale mbi baza etnike. Që nga atëherë, shqiptarët e shikojnë me dyshim decentralizimin dhe e shohin si paraprijës të ndarjes së territorit të Kosovës; në anën tjetër Beogradi e shikon me shpresë.

Kah fundi i marsit 2004, zyrtarë të lartë ndërkombëtarë në Kosovë heshturazi por gjithnjë e më shumë pranonin se presioni nga shoqëria shqiptare në Kosovë është i tillë që çfarëdo vonese në zgjidhjen e statusit pëfundimtar të Kosovës do të dëshmohej të ketë pasoja katastrofike - status quo-ja nuk mund të mbahet. Shumica e këtyre komenteve mbesin private. Por, reagimi joadekuat i politikanëve, mediave dhe shoqërisë së shqiptarëve të Kosovës ndaj dhunës kanë demonstruar se Kosova nuk është gati për statusin final. Me thirrjet e tyre për më tepër kompetenca dhe pavarësi, politikanët e shqiptarëve të Kosovës kanë treguar lakmi për të shtënë në dorë më tepër pushtet por mospërfillje për nevojën për të pasur infrastrukturën e duhur. Për më tepër, çfarëdo zgjidhje të statusit nën ndikimin e dhunës anti-serbe ka gjasa që të rezultojë me ndarje apo coptime territoriale mbi baza etnike dhe kështu të nxisë dhunë të re dhe përpjekje për pastrim etnik.

C. NË TERREN

Në dy javët e para pas trazirave, në mikro-detajet e interaksionit të tyre social u vërejt një përkeqësim i shpejtë i marrëdhënieve mes ndërkombëtarëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Në rrugë vërehej dukshëm shtimi i sentimenteve të vrazhda e agresive. Por, shumë më shumë ka nën sipërfaqe. Tani, kur ndërkombëtarët shkëmbejnë shikimet me të rinj vendas, ato më së shpeshti zbulojnë mosbesim. Veturat e OKB-së që deri në mesin e muajit mars 2004 gëzonin përparësi, tani përjetojnë trajtim të ashpër dhe të vrazhdë nga vozitësit tjerë. Refleksi

për të rezistuar i shoqërisë së shqiptarëve të Kosovës, i rregjur gjatë dekadave të dominimit serb, tani tregon shenja të riparaqitjes, këtë herë në raport me ndërkombëtarët. Janë këto shenja alarmuese që tregojnë se ndoshta është duke u zhvilluar një proces i dehumanizimit, se ndoshta në nivel të nënvetëdijes, shumë shqiptarë të Kosovës janë duke e përgatitur veten psikologjikisht për mundësinë që stafi ndërkombëtar të mund të bëhet cak i çfarëdo vale të re të dhunës.

Simptomat e dukshme të mosbesimit rrezikojnë të provokojnë shtim të mëtutjeshëm të tij. Stafit dhe strukturat ndërkombëtare heshturazi janë duke nxjerrë nga sirtarët dhe duke i përpunuar planet për evakuim në raste nevojë. Në mbrëmje, në qendër të Prishtinës, rrugët që shpiejnë kah selia e UNMIK-ut dhe e Policisë mbyllën për komunikacion. Kjo dhe patrullat e shtuara policore janë sinjale drejtuar shqiptarëve të Kosovës se ndërkombëtarët janë sovranë në qendër të Prishtinës dhe se po e ruajnë veten nga vendorët. Kjo ngjanë, në mënyrë të pakëndshme, me bllokadat e rrugëve të bëra nga serbët që nxitën mllefin e shqiptarëve më 17 mars.

Në vend se të përmirësojnë marrëdhëniet dhe shtojnë besimin e ndërsjellë me strukturën vendore të sigurisë, SHPK-në, ushtria dhe policia ndërkombëtare, në disa instanca - veçanërisht në Mitrovicë - po demonstrojnë haptazi mospërfillje për të. SHPK-së në Mitrovicë i është hequr zëdhënësi i vet «derisa gjërat të qetësohen».

Në tërë këtë atmosferë të zymtë, të paqartësive të reja, përçarjeve e enklavizimeve të reja, një burim tjetër i tensioneve - gjendja e vështirë ekonomike e Kosovës - vetëm sa po vie e po përkeqësohet. Trazirat vetëm sa e kanë shpejtuar tatëpjetën e marrë, kanë larguar edhe më tepër investimet dhe kanë bërë që të humbasen shumë mundësi afariste. Hoteli Grand në Prishtinë i ka thënë ICG-së se 5.000 rezervime të ndryshme janë anuluar që prej trazirave.

Në anën tjetër, nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës kërkohet që të bajë barrën e rindërtimit të mbi 700 shtëpive të shkatërruara apo dëmtuara, 30 kishave e 2 manastireve. Qeveria tanimë ka shtuar shumën e parë që e kishte ndarë, prej 5 milion euro, për 11,6 milion euro të tjerë, por as kjo nuk do të mbulojë rindërtimin e shtëpive, e të mos flasim për kompenzimin e pasurisë e veçanërisht punën ekstenzive, specialiste e jashtëzakonisht të shtrenjtë të restaurimit të kishave e manastireve që ende pritet të fillojë. Shumat që i ka siguruar qeveria janë fonde të realizuara nga mbledhja e taksave dhe doganave në Kosovë e të

cilat tani nuk do të jetë në gjendje t'i shfrytëzojë për të ngritur pagat e mësuesve, punonjësve shëndetësorë, minatorëve dhe të tjerëve që kërcënuan me greva apo edhe mbajtën greva në vjeshtën e vitit 2003. Në javët që do të vijnë, tensioni mes kërkesave drejtuar buxhetit mund të ngritet - aq më tepër kur rrugët tjera për protesta sociale janë të bllokuara. Pas trazirave janë ndaluar tubimet masive dhe demonstrimet deri në fillim të muajit maj.¹⁰⁴ Kjo paraqet potencial për shpërthim, veçanërisht nëse liderët e IPVQ-së vazhdojnë t'i fryejnë zjarrit me komente çfarë ishte ai i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, i cili qe shprehur se po bëhet «presion kriminal» mbi IPVQ-në që të paguajë për rindërtimin e shtëpive serbe dhe duke krahasuar këtë me dështimin e IPVQ-së që të financojë rindërtimin e shtëpive të shqiptarëve mbas luftës¹⁰⁵

Larg nga kthimi në normalitet pas dhunës, Kosova është bërë tani një vend me paparashikueshmëri të lartë dhe në rrezik që të bie kryengul teposhtë.

VIII.SHOQËRIA E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS - NEVOJA PËR RENOVIM

Shpërthimi më 17 e 18 mars ka zbuluar se sa rëndë është e dëmtuar kjo shoqëri - ekonomikisht, politikisht dhe psikologjikisht. Represioni dhe rezistenca e përcollën në pjesën më të madhe të shekullit njëzet, me vetëm një «dekadë të mirë» në të shtatëdhjetat, kështu që shoqëria e shqiptarëve të Kosovës nuk ka pasur ende rastin që të shikohet në pasqyrë. E dalë nga represioni i dhe tmerret e luftës të viteve 1990, kjo shoqëri nuk ka nxituar, madje edhe ka ngurruar, që të shohë fytyrën e vet të vërtetë.

Është kjo një shoqëri me shumë telashe që duket se nuk është në gjendje, apo nuk dëshiron, që të mbrojë fqinjët, pakicat, madje as veten, nga ekstremistët dhe kriminelët e vet. Në këtë gjendje në të cilën është, shoqëria e shqiptarëve të Kosovës nuk ka mjaft barriera dhe mekanizma frenues për të parandaluar që ngadalë të dëbojë të gjithë trupat e huaj nga vetvetja apo në rrugën e saj - qofshin këta serbë, pakica tjera apo ndërkombëtarë. Në fund, ekziston rreziku se do të shkatërrojë apo dëbojë edhe vet pakicat shqiptare jo-konformiste (pakica katolike shqiptare qysh tani është reduktuar në masë të madhe nga emigrimi) dhe elitat e veta liberale që ende janë të pakta. Siç u shpreh një i ri shqiptar: «Kur njëherë të jenë larguar serbët, pastaj boshnjakët, ashkalinjtë dhe turqit, do të fillojmë të kërkojmë armiqë brenda nesh. Ne kemi nevojë të jemi tërë kohën në gjah për armiq».¹⁰⁶ T'u japësh institucioneve të Kosovës pushtet të plotë për të qeverisur nuk do të mjaftojë që të evitohet ky rrezik.

Shoqëria e shqiptarëve të Kosovës është relativisht e mbyllur, mundohet t'i mbajë gjërat për vete dhe nuk dëshiron të tregojë shenja të të qenurit e dobët. Deri më 17-18 mars aq shumë shqetësime mbaheshin të shtypura: aq shumë njerëz ende të traumatizuar nga ajo që kanë përjetuar; sistem shëndetësor e social i shkatërruar, traumatizimi sekondar i fëmijëve nga prindërit e tyre dhe sistemi arsimor krejtësisht i pareformuar e i kalbur që sipas një vëzhguesi vendor: «është ndërtuar mbi histori të gabuar, porosi të gabuar dhe tepër shumë poezi e këngë për heronjë. Ajo prodhon urrejtje: gjuhë të urrejtjes dhe diploma të urrejtjes».¹⁰⁷ Pranimi i heshtur nga ana e shumicës

¹⁰⁴ Zëdhënësi rajonal i policisë së UNMIK-ut, Malcolm Ashby, i intervistuar nga *Blue Sky* radio, më 19 prill.

¹⁰⁵ Komente të bëra në tryezën "Për një agjendë të re për Kosovën", mbajtur në Prishtinë, më 13 prill.

¹⁰⁶ Intervistë e bërë nga ICG-ja në Prishtinë, më 2004.

¹⁰⁷ Intervistë e ICG-së me Baton Haxhiun, më 20 tetor 2003.

së mësimdhënësve i pjesëmarrjes së nxënësve të tyre në trazira e mandje nganjëherë edhe pjesëmarrja e drejtë për drejtë në to, ka hapur perden për të gjithë për të parë se arsimi pas luftës ka dështuar të shërojë vrragët dhe se përkundrazi luan rol në ndarjen ndër-etnike dhe shtimin e frikës.

Degëdisja në turmë të dhunshme është konform me fenomenet e vërejtura edhe më parë kur rinia e tjetërsuar e shqiptarëve të Kosovës përnjëherë ngritet dhe hedhë për tokë zgjidhjet institucionale, të brishta e zakonisht me plot të meta, të ofruara nga më të vjetrit e tyre. Pas shtatë viteve të qeverisjes autonome si krahinë në RSFJ, varfëria e vazhdueshme dhe papunësia sollën shpërthimin studentor që kaloi në trazira të dhunshme në pranverën e vitit 1981, që pat për pasojë dhjetra të vdekur dhe vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Më 1 tetor dhe 30 dhjetor 1997, studentët shqiptarë në Kosovë shënuan dështimin e gjashtë apo shtatë viteve të rezistencës pasive përballë heqjes së autonomisë së krahinës nga ana e Beogradit - rezistencë kjo e udhëhequr nga LDK-ja monolitike, e më të vjetërve, që udhëhiqet nga Rugova - edhe këtë herë me demonstrata masive, duke injoruar edhe mospëlqimin e Rugovës. Posterët e përgatitur nga UPSUP-i më 1997, për të mobilizuar përkrahje për protestën, paraqitnin një fotografi nga demonstratat e vitit 1981, të përcjella me fjalinë «Është koha për të vepruar». Edhe pse vet demonstratat e vitit 1997 ishin të qeta e paqesore, ato u shpërdanë në mënyrë të dhunshme nga forcat serbe të sigurisë gjë që shpiu drejt forcimit të UÇK-së dhe zhytjes në luftë që nga marsi i vitit 1998. Gati pesë vite pasi NATO-ja kishte dëbuar forcat serbe nga Kosova, katër vite pas themelimit të Strukturave të Përbashkëta të Përkohshme Administrative dhe dy vite pas themelimit të IPVQ-së, fëmijët e Kosovës, adoleshentët dhe të rinjt, u ngritën përsëri. Demografia e shqiptarëve të Kosovës - vlerësohet se 70 për qind janë nën moshën 30 vjeçare e 50 për qind nën njëzet vjeçare - bën që ndërrimet e gjeneratave të bëhen me shpejtësi marramendëse. Ata që ishin UÇK para gjashtë apo shtatë viteve qysh tani janë duke u tejkaluar nga gjenerata tjetër pasuese, agresive, e pakënaqur dhe e si-pa-kokë.

Krahas kësaj, vlerat dhe popullata e fshatrave të pazhvilluara të Kosovës kanë vërshuar kryeqytetin që nga viti 1999. Brenda pesë viteve të fundit popullata shqiptare e Prishtinës pothuajse është trefishuar në mbi 500.000 banorë të ardhur nga zonat rurale të Llapit e Drenicës. Drenica veçanërisht ka pësuar gjatë luftës ndërsa ende mbetet pjesa më e varfër e Kosovës - prandaj banorët e saj kanë ndjerë ndaj

Prishtinës zemërim por edhe të drejtë të vendosen në të. Modernizimi i pabarabartë i Kosovës i filluar në vitet e gjashtëdhjeta e i ndërpreë dhe i vënë në tatëpjetë gjatë regjimit të Milosheviqit në të nëntëdhjetat, ishte përqëndruar në zonat urbane, duke lënë fshatrat të kapitura dhe, efektivisht, me dekada të tëra mbrapa. Tani, në vend se moderniteti të përhapet në fshatra, valë të tëra të migrantëve nga fshatrat, me arsimim e aftësim profesional të mangët, kanë përlarë «oazat» e pakta të modernizimit në Kosovë. Për një qytet të madhësisë dhe funksioneve që duhet të ketë, Prishtina është e papërgatitur edhe në aspektin arsimor edhe në atë kulturor - numri i librariëve por edhe i spektri i titujve të përkthyer është i mjerë. Skena politike është e ndarë mes më të rinjëve, elitat e reja ish-rurale të partive të dala nga UÇK-ja (PDK e AAK) dhe atyre më të vjetër, elitës urbane, ish-komuniste, psikologjikisht të pareformuar, LDK-së. Me influksin nga fshatrat është shtuar edhe ndikimi i kriminalitetit dhe ekstremizimit. Që nga viti 1999, bizneset dhe shitësit e Prishtinës është dashur të përballen me reketim të kryer nga të dalurit nga strukturat komanduese të Zonave operative të Drenicës e Llapit. Ekstremistët gjysëm të shkolluar ndihen mjaft konfidentë sa të diktojnë kushte e t'u kërcënohen edhe intelektualëve më të dalluar shqiptarë që kanë ngritur zërin kundër sulmeve kundër pakicave. Një faqe në Internet, me lidhje me AKSH-në, në mënyrë të tërthortë ka kërcënuar me vrasje novelistin e vetëm shqiptarë me famë botërore, Ismail Kadare, për «shkarravitjet» dhe «vampirizmat» e tij pasi ky kishte botuar një artikull për nevojën për të shëruar Kosovën pas trazirave. Veton Surroi, pronar gazete e TV stacioni, kundër të cilit agjensia e lajmeve e UÇK-së kishte lëshuar kërcënim me vdekje poashtu të tërthortë, kah fundi i vitit 1999 kur ai ngriti zërin kundër valës së pastrimit etnik të serbëve dhe romëve që po zhvillohej atëherë, ka shkruar se nëse Kosova vazhdon t'ia lejojë vetes që të mbetet peng i qelizave të tilla ekstremiste atëherë «natyrisht, nuk mund të bëhet fjalë për jetë institucionale».¹⁰⁸

Në presion që nga viti 1960 nga shtimi rapid i popullatës dhe nga elementet banditeske të pakontrolluara, shoqëria e shqiptarëve të Kosovës ka demonstruar fenomene të vazhdueshme të dëbimit të komuniteteve tjera etnike dhe grupeve më të dobëta -

¹⁰⁸ "Tani tërë Kosova është peng", botuar në "Koha Ditore", më 19 mars, ribotuar e përkthyer në "IWPR Balkan Crisis Report", më 23 mars. Mund të gjendet në Internet në: http://www.iwpr.net/index.pl?archive/bcr3/bcr3_200403_488_4_eng.txt.

përfshirë këtu edhe vet shqiptarët. Kjo nuk do të thotë se mund të minimizohet fakti se disa herë që nga Lufta e Dytë Botërore, politikat shtetërore jugosllave kanë bërë presion mbi shqiptarët që të largohen nga vendi. Për herë të fundit kjo është parë gjatë viteve të nëntëdhjeta. Megjithatë, rrëfimet e serbëve që nga vitet e tetëdhjeta për shqetësime dhe frikësime në shkallë të vogël me qëllim që të detyrohen t'ua shesin pronat më strategjike shqiptarëve dhe kështu të cenohet integriteti dhe konfidenca e lagjeve serbe dhe të detyrohen në ikje si minoritet, paraqiten edhe në raportet e OSBE-së dhe UNHCR-së që folin për fenomente të ngjashme pas vitit 1999.¹⁰⁹ Që nga lufta, shqiptarë nga fshatrat kanë okupuar edhe prona të vet shqiptarëve. Ky ka qenë fenomen veçanërisht i përhapur dhe i rrezikshëm në verën e çmëndur të vitit 1999. Motive të tilla mund të supozohet se ka pasur edhe prapa disa të bëmave gjatë 17-18 marsit - me grafitet e shkruara në shtëpitë e djegura në Frashër/Svinjare turma ka sinjalizuar së paku dëshirën retorike që të përvetësojë për vete ato shtëpi. Pajtimin e shqiptarëve të Kosovës me politikën e bashkësisë ndërkombëtare për «integrim» dhe Kosovë multietnike disa e shohin si asgjë më tepër se sa lojë për të blerë kohë, kurth për serbët e Kosovës për t'i zënë ata në një vend të ndarë ku ata do të jenë pre e dëbimit gradual atëherë kur vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare të venitet. Dhëmbja e shqiptarëve të Kosovës rreth de facto ndarjes në vijën e Lumit Ibër në njëfarë mënyre paraqet edhe zemërimin dhe frustrimin e tyre me pamundësinë që të pastrojnë tërë territorin nga trupat e huaja - kjo ndoshta është më akute ndër elementet e varfëra rurale që do të përfitonin më së shumti nga vjedhjet.

¹⁰⁹ Shkaqet e emigrimit të serbëve e malazezëve nga Kosova që nga viti 1960 janë kontestuar dhe politizuar në mënyrë të zjarrtë, me serbët duke fajësuar frikësimin dhe presionin e shumicës shqiptare, dhe shqiptarët që insistonin se prapambeturia ekonomike e Kosovës dhe gjasat për punësim më të mirë jashtë Kosovës ishin shtytësit kryesorë. Ndoshta është më e drejtë të thuhet se që të dy faktorët kanë luajtur rol. Shih: (me kujdes, duke pasur parasysh atmosferën shoviniste në kohën në të cilën është shkruar) Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve, Departamenti i Shkencave Shoqërore, Studime demografike, Vëllimi III, Ruža Petrović, Marina Blagojević: "Migrimi i serbëve dhe malazezëve nga Kosova e Metohija: Rezultatet e anketës së bërë më 1985-1986"; Julie Mertus: "Kosovo: how myths and truths started a war" ("Kosovë: si e nisën luftën mitet dhe të vërtetat") (kapitulli 2, "Futja e shiheshes", rasti Martinović", 1985), University of California Press, 1999; dhe Vlerësimi i përbashkët OSBE/UNHCR i gjendjes së pakicave etnike në Kosovë, dhjetë nga të cilat janë botuar që nga viti 1999 - shiko për shembull raportin Qershor - Shtator 2000, pika 104, faqe 29.

Shtresa e vogël e shoqërisë civile në Kosovë nuk është në gjendje të absorbojë goditjet. Në të vërtetë, goditjet e tilla janë në gjendje të kalojnë menjëherë në dhunë. Pjesa më e madhe e shoqërisë civile është urbane, e mbajtur në jetë nga donatorë ndërkombëtarë dhe nuk është në gjendje të ushtrojë ndikim të vërtetë në masat e gjëra. Disa grupe me rrjet më të gjërë aktivistësh në të vërtetë i kanë shtuar goditjet e 17 marsit - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe tri «shoqatat e dala nga lufta». Shumica që mban gojën mbyllur tepër lehtë pranon që të dominohet dhe udhëheqet nga pakica e dhunshme. Një gazetar serb i Kosovës thotë: «Ekziston njëfarë fundamentalizmi ndër masat rurale shqiptare. Ata gjithnjë kanë menduar se serbët janë vrasës. Shumica e shqiptarëve nuk mendojnë më kështu por ata nuk ia dalin t'u bëjnë ballë atyre që ende mendojnë kështu. Ky është një nga lëshimet më të mëdha ndër shqiptarët. Individët kanë frikë të ngrejne zërin - kundër krimeve, kundër vrasjeve».¹¹⁰ Nga puna në terren bërë gjatë viteve nëntëdhjetë, antropologia Janet Reineck në mënyrë analoge konkludon se shqiptarët e Kosovës «ndihen të pafuqishëm që të përballojnë stigmën sociale që e përcjell jokonfirmimit. Asnjëri nuk mund të jetë i pari të bëjë ndërime».¹¹¹ Shoqëria e tashme e shqiptarëve të Kosovës nuk ka hapur ende në mënyrë bindëse kanalet e debatit introspektiv. Ekziston një monokulturë dominante në të shprehurit publik dhe një hedhje e përgjegjësive për çështjet më të rënda në botën jashtë: UNMIK, bashkësi ndërkombëtare, statusi i pazgjidhur i Kosovës, Serbi. Edhe pse pas 17 e 18 marsit u është sfiduar lidhshipi në nivel të rrugës nga ekstremistë dhe kriminelë, politikanët e shqiptarëve të Kosovës ende nuk ia kanë dalur që të hapin sytë para sfidave të brendshme. Në një debat me pjesëmarrje të lartë dhe transmetim direkt në televizion, i mbajtur më 13 prill, për të diskutuar rrugët përpara pas dhunës, asnjë nga figurat e shoqërisë civile apo IPVQ-së nuk iu adresua më seriozisht kërcënimet nga ekstremizmi

¹¹⁰ Intervistë e ICG-së me Branislav Krstic (me origjinë nga Gjakova/Djakovica dhe i rrjedhshëm në shqipe - e jo autori i "Kosovo Pred Sudom Istorije"), më 14 dhjetor 2003.

¹¹¹ "Seizing the Past, Forging the Present: Changing Visions of Self and Nation Among the Kosova Albanians", ("Ngërthimi i të kaluarës, farkëtimi i të ardhmes: Ndërimi i vizioneve për vetveten dhe kombin ndër shqiptarët e Kosovës"), Anthropology of East Europe Review, Vol. 11, Nos. 1-2, vjshhtë 1993.

dhe në vend të kësaj zbrazen tërë mllëfin e tyre në UNMIK-un dhe bashkësinë ndërkombëtare.¹¹²

Fijet që lidhin regjionet dhe pjesët e ndryshme të Kosovës në marrëdhënie të qëndrueshme me qendrën kombëtare janë jashtëzakonisht të holla. Në të gjitha nivelet mungon përvoja, shprehinë dhe aftësitë për punë shtetërore. Lojalitetet rajonale dhe rrjetet lokale të patronazhit kanë përparësi. Madje edhe grupet e kriminit të organizuar në pjesë të ndryshme të Kosovës duket se janë të specializuara për forma të ndryshme të kriminalitetit e që kërkojnë pak e plotësojnë njëra tjetrën.¹¹³ Vet UÇK-ja asnjëherë nuk ishte një trup kombëtar i koordinuar - vetëm personaliteti karizmatik i Agim Çekut, kah fundi i luftës, i dha lustrën e koherencës. Puna e ngadalshme dhe aspak e lehtë e konsolidimit të lojaliteteve të ish-njerëzve të UÇK-së nga niveli rajonal në atë kombëtar ka vazhduar edhe në TMK. Që nga fillimi, UNMIK-u është munduar që të thjeshtojë mozaikun e ndërlikuar Kosovar dhe të paramendojë një partner në nivel kombëtar që do të mund të «përfaqëson» tërë zonat e rezistencës dhe ato vendimmarëse të shoqërisë së gjërë të shqiptarëve të Kosovës. Kjo nisi me kooptimin e udhëheqësve të luftës në Strukturat e Përkohshme të Përbashkëta Administrative dhe arriti në sistemin e tashëm politik me tri parti politike «kombëtare» të shqiptarëve të Kosovës me pjesëmarrje të triave në koalicionin qeverisës. Kjo ka rezultuar me një elitë politike artificiale - që më tepër qëndron pezull në sipërfaqe të shoqërisë së shqiptarëve të Kosovës se sa të jetë e rrënjësuar thellë në të. Vendimi i paradokoshëm, vendim për keqardhje, i PSSP-së Holkeri që zgjedhjet e 23 tetorit 2004 të mbahen me lista të mbyllura të përcaktuara nga lidhshipi i tri partive të mëdha në Prishtinë vetëm sa do ta konsolidojë edhe më këtë fuqizim politik artificial dhe do të ushqejë iluzionet e politikë-bërësve ndërkombëtarë.

Pasiguria dhe ambivalenca që treguan hierarkitë politike kosovare përballë ekstremistëve duhet të analizohet. Deri në një masë, ekstremistët dhe kriminelët janë ata që ruajnë, mbajnë e mandej edhe forcojnë kufijt e veprimit të tashëm politik - tri-opolin mbi resurset që bëhet në kuadër të paqes së rëndë mes LDK-së dhe partive post-UÇK. Tri partitë politike në esencë kanë konsumuar qeverisjen duke

ndarë ministrinë dhe duke ia nënshtruar qeverisjen rrjeteve të tyre të formës patron-klient e duke lënë shumë pak hapësirë për lindjen e etosit të shërbimit civil të pavarur.¹¹⁴ Kur njëherë viresh në binarë të tillë nuk është lehtë të krijohet hapësirë për veprim tjetër dhe për të marrë drejtim tjetër. Edhe pse disa nga OJQ-të më të dalluara kosovare besojnë në zgjedhjet me lista të hapura si mjet për të ndalur tri-opolin që të konsolidojë edhe më dominimin e vet të pasfiduar, është e mundur që të ndodhë që nga tërë kjo të dalë se efekt kryesor i listave të hapura do të jetë vetëm lëvizja e marrëdhënieve patron-klient nga hierarkitë qendore në ato rajonale. Disa vëzhgues e kanë krahasuar këtë gjendje me atë në Italinë jugore dhe problemet kronike administrative atje, nivelin e ulët të besimit të ndërsjellë qytetar dhe marrëdhëniet klient-patron.¹¹⁵ Shoqëria e shqiptarëve të Kosovës ka karakteristika të ngjashme dhe dinamikat e saj të pavolitshme ndodh që do të kërkojnë angazhim të konsiderueshëm dhe të përqëndruar që të bëhen të ndërrojnë.¹¹⁶

Nevojiten ndërrime dhe përmirësime të thella në media dhe arsimim ashtu që të shtohen gjasat për sukses të ndërrimeve sociale. Sistemi arsimor e edukativ pas vitit 1999 ka dështuar që të lëvizë përpara dhe të shkëputet nga orientimi për mobilizim kombëtar dhe rezistencë që kishte sistemi edukativ e arsimor «paralel» apo «i nëntokës» i viteve nëntëdhjetë - që u ngritën pasi Milosheviqi nxori nga strukturat arsimore shtetërore mësuesit, nxënësit dhe studentët shqiptarë. Në vend se të jetë i hapur për ndikimet ndërkombëtare që nga viti 1999, sistemi edukativ e arsimor është mbyllur në vete, edhe pse resurset i janë shterrur: dhe përbëhet kryesisht nga

¹¹² Tryeza e "Forumi 2015" "Për një agjendë të re për Kosovën"

¹¹³ Figurat e kriminit tregojnë shkallë të ndryshme të krimeve sipas rajoneve. Intervistë e ICG-së me një burim nga policia e UNMIK-ut.

¹¹⁴ UNMIK-u duhet të pranojë një pjesë të fajit për këtë pasi nuk ia ka dalur që të themelojë një qendër trajnimit për shërbimet civile dhe një bord mbikqyrës të shërbimeve civile para se të formohej IPVQ-ja.

¹¹⁵ Shih Robert Putnam, "Making Democracy Work: Civic Traditions in Modern Italy", ("Ndërtimi i demokracisë: Traditat civile në Italinë moderne") Princeton University Press, 1993.

¹¹⁶ Disa nga karakteristikat më të admirueshme të shoqërisë shqiptare paraqiten të rrënjësura thellë. Dinamika ndërmarrëse me të cilën shqiptarët e Kosovës shumë shpejtë ndërtuan ekonominë private pralele në fillim të viteve 1990 që në shumë aspkete e tejkalonte sektorin shtetëror në shkatërrim e sipër prej nga i kishte dëbuar Milosheviqi, mund të shihet edhe në raste më të hershme. Edith Durham kishte vërejtur më 1908 se në Podgoricë, me tregti e afarizëm mendjeprehtë "shqiptarët, ngadalë dhe në mënyrë të qetë, po e ripushtojnë qytetin e tyre të humbur... të pushtuarit po e kapërdijnë pushtuesin". "High Albania", ("Shqipëria e lartë"), ribotuar nga Virago, Londër, 1985, faqe 152.

metodologjitë, dija dhe aftësitë që mbijetojnë në një formë të «ndryshkur» që nga 1980-at. Universiteti i Prishtinës veçanërisht u ka rrezistuar ndërimeve pasi lidhshipi akademik mediokër mundohet të mos lëshojë nga dora pozitat dhe privilegjet. Arsimit tani i duhet një revolucion me orientim ndërkombëtar i shkallës çfarë ishte ai i fillimit të viteve 1940, kur nën okupimin e Fuqive të Boshtit, Shqipëria dërgoi mësuesit e vet më të mirë në Kosovë, duke përfshirë me shpejtësi shkrim-leximin dhe vetëdijën «kombëtare».

Edhe mediat shqiptare në Kosovë kanë nevojë të përmirësohen dhe riorientohen në mënyrë drastike. Më 17-18 mars, mediat hynë në gjendje të mobilizimit kombëtar efektivisht duke i fryrë zjarrit të trazirave. Edhe në ditët e muajt më të qetë para trazirave këta nuk ia kanë dalur që të marrin qëndrim kundër pikëpamjeve ekstremiste. Një vëzhgues shqiptar nga Kosova vëren: «Sa herë ka pasur demonstrata ku janë dëgjuar ankesat e ish-UÇK-së, televizionet kanë raportuar për to sikur ato të ishin karneval. Cilindo që e intervistonin thoshte gjërat më të rënda e më ofenduese ndërsa gazetarët asnjëherë nuk i sfidonin».¹¹⁷ Njësoj sikur me sistemin arsimor, edhe mediat, e veçanërisht transmetuesi publik RTK, duhet të largohet nga rezistenca dhe mobilizimi dhe të ridrejtohet kah parimet edukative, të pavarura e etike të raportimit, redaktimit dhe bërjes së programeve. Deri sot, mediat kanë treguar pak gatishmëri për introspeksion dhe pranim të lëshimeve të tyre më 17 e 18 mars. Bordi dhe menaxhmenti i RTK-së kanë nevojë për lëvizje ndërsa donatorët ndërkombëtarë, që në emër të demokratizimit kanë përkrahur mediat e Kosovës në më shumë se katër vitet e fundit, duhet të kërkojnë më shumë për paratë e tyre.

Orientimi kah rezistenca vazhdon të formësojë ndjenjën e shoqërisë së shqiptarëve të Kosovës për vetveten dhe kjo shkon në dëm të ndërtimit të institucioneve të qëndrueshme shtetërore. Antropologja Janet Reineck ka konkluduar në fillim të të nëntëdhjetave se pasi trazirat e vitit 1981 bënë të qartë se shqiptarët e Kosovës në Jugosllavi do të mbeteshin me status më të ultë (e që u reduktua edhe më pas heqjes së autonomisë në 1989), shoqëria iu kthye traditës dhe simboleve sociale të së kaluarës për shkak të nevojës për siguri psikologjike. Ky orientim në vlerat dhe zakonet tradicionale - siç janë nderi, besa, mikpritja dhe sjellja e moralshme - mbetet edhe sot, njësoj sikur edhe nacionalizmi

romantik shqiptar i rrënjësuar në imazhet e të së kaluar heroike.¹¹⁸ Kur kah mesi i muajt shkurt UNMIK-u dhe deputetët serbë të Kuvendit të Kosovës ngritën zërin kundër muraleve në ndërtesën e renovuar të Kuvendit të Kosovës, që paraqitnin skena epike nga historia shqiptare, skena politike shqiptare nguli këmbë në të vetën, ndërsa kryetari i Kuvendit u shpreh kundër heqjes të styre duke thënë: «heqja do të ishte kompromis i pandershëm dhe dubioz».¹¹⁹

Edhe pse barën kryesore për të garantuar se shoqëria e tyre zhvillohet dhe pjeket nëpërmjet jetës institucionale më parë se sa duke u lëshuar në harbutëri në rrugë e kanë vet shqiptarët e Kosovës, edhe bashkësia ndërkombëtare duhet të ofrojë mbështetje konkrete. Riorientimi i identitetit social të shqiptarëve të Kosovës kah ndërtimi i shtetit do të zëjë vend vetëm nëse shihet qartë se do të lejohet shteti i Kosovës. Orientimi kah rezistenca dhe pranimi i qelizave të rezistencës/ekstremizmit do të reduktohet vetëm atëherë kur të hiqen shkaqet kryesore të rezistencës. Forcat potencialisht liberale e konstruktive në shoqërinë e Kosovës, që do të mund të ngritnin popullin kundër ekstremizmit dhe dhunës së turmës, do të ndihen të afta që të bëjnë këtë vetëm nëse u jepet mbulesë kredibile nga bashkësia ndërkombëtare, e kjo është: një rrugë e qartë përpara dhe drejt aspiratave të Kosovës për vet-vendosje, gjithnjë në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare. Ekstremizmit duhet t'i heqet nga dora letra që sot ia vërvitë para syve popullatës së pakënaqur dhe të frustruar të Kosovës - monopoli mbi rrugën «e shkurtë e të drejtë» kah vet-vendosja.

¹¹⁸ Janet Reineck, "Seizing the Past, Forging the Present: Changing Visions of Self and Nation Among the Kosova Albanians", *Anthropology of East Europe Review*, Vol. 11, Nos. 1-2, Autumn 1993.

¹¹⁹ Letra e kryetarit të kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, dërguar Holkerit, e përmbledhur në "VIP Daily News Report: Kosovo at a Glance", 16 shkurt 2004. Pozita e Dacit është përkrahur nga kolegët e tij nga LDK-ja, kryetari Ibrahim Rugova dhe të tjerë. Disa politikanë shqiptarë kanë folur kundër muraleve, nga të cilët është dalluar Xhavit Haliti i PDK-së: "Ky nuk është parlament mono-etnik... Nuk ka nevojë të shprehet patriotizmi në këtë mënyrë".

¹¹⁷ Intervistë e ICG-së, 8 prill 2004.

IX. RIFORMËSIMI I PRANISË NDËRKOMBËTARE

UNMIK-u nuk është më faktor efikas e stabilizues. Kjo edhe për shkak se është mishërim i politikës së mosndryshimit por edhe se për shkak të dështimeve të veta në implementim, të tonit të vet, mangësive organizative dhe në kuadro, po nxitë ndjenja armiqësore në shkallë alarmante. Prandaj, krahas ruajtjes së vazhdimësisë së dijes institucionale, do të ishte me mend që të vendoset një organizatë pasardhëse, me identitet e mandat tjetër.

Struktura e tashme «shtyllore»¹²⁰ që krijuar në një gjendje të paslutës, në vitin 1999, sa për të qenë në gjendje të merret me nevojat e Kosovës po aq edhe për t'i pajtuar ambiciet e aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë.¹²¹ Misioni i ri i OKB-së, për dallim nga UNMIK-u, duhet të ketë në thelb të mandatit të tij zhvillimin social, ekonomik e institucional të Kosovës, me BE-në me rol kryesor në këtë proces. Nuk ka nevojë për strukturë shtyllore; çështjet sociale e ekonomike duhet të jenë përgjegjësi vetëm e IPVQ-së, me Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare të tij duke luajtur rol këshillues e monitorues. Roli i PSSP-së së tashëm, Harri Holkeri, duhet të ndahet mes Administratorit Kryesor (Krye-Administratorit) që do të mbikqyrte zhvillimin e ekonomisë dhe institucioneve të Kosovës, duke integruar funksionet e mbetura qeverisëse të misionit të OKB-së me IPVQ-në, dhe atij të Negociatorit Kryesor (Krye-negociatorit) që do të trasonte rrugën për zgjidhjen e statusit final të Kosovës (kjo do të diskutohet më në detaje në seksionin e ardhshëm).

A. NEVOJA PËR ANGAZHIM NDËRKOMBËTAR NË EKONOMI

Që nga vrulli për rindërtim, pas luftës, bashkësia ndërkombëtare ka lënë anash ekonominë e Kosovës. Në dhjetor të vitit 2001, në një raport të vet, ICG ka argumentuar se bashkësia ndërkombëtare duhet të vazhdojë të ndihmojë Kosovën në mënyrë përmbytësore për deri sa progresi drejt pavarësisë ekonomike është i penguar nga mungesa e vendimit

për statusin final.¹²² Në vend të kësaj kemi parë tërheqje nga asistenca para se të arrihet një vendim i tillë. Për shembull, asistenca e BE-së për Kosovën ka rënë në 55-60 milion euro në vjet për vitet 2004-6, nga 336 milion sa ka qenë në vitin 2001 dhe 147 milion më 2002.¹²³ Si rezultat i kësaj, ekonomia e Kosovës ka filluar përsëri të tkurret - pesimizmi ekonomik është shtuar vazhdimisht, që nga korriku i vitit 2003¹²⁴ ndërsa importi konfirmohet të ketë kaluar në rënie në vitin 2003.¹²⁵ Kjo rënie shpjegohet me parë me rënien e fuqisë blerëse sa me shtimin e prodhimit vendor - aktivitetet bujqësore e industriale dhe investimet mbesin shumë të ulëta, me paratë dhe energjinë të përqëndruar në sektorin privat që përbëhet kryesisht nga tregtia dhe shërbimet.¹²⁶

Si mision paqeruajtës që është, UNMIK-u nuk është menduar të prodhojë zhvillim ekonomik - as strukturalisht por as me tendencë për këtë. UNDP-ja është lënë jashtë strukturës së tij prej shtyllave, ndërsa zyrtarët e lartë të UNMIK-ut kanë fokus politik afatshkurtë. Një zyrtar i lartë ndërkombëtar ankohej se sa herë që ka provuar të ngrisë çështjet zhvillimore në zyren e PSSP-së: «ata i hapnin sytë».¹²⁷ Një diplomat perendimor që shërben në Prishtinë pranon: «Sundimi i diplomatëve po e ngulfatë Kosovën. Zhvillimi nuk vie me dekretim të standardeve por nga ekonomia».¹²⁸

Derisa UNMIK-u në muajt e fundit ka bërë standardet projekt të vetin prioritar, në të njëjtën kohë shtylla e IV e tij e udhëhequr nga BE-ja po shëmbte shpresat ekonomike të shqiptarëve të Kosovës. Vendimi i papritur i shefit të shtyllës së katërt, Nikolaus Graf Lambsdorff, që të ndalë privatizimin erdhi si një goditje e pamatur. Është dashur të merret një qasje më subtile ndaj raportimit

¹²² Shih raportin "ICG Balkans Report N°123, *Kosovo: A Strategy for Economic Development*", 19 dhjetor 2001.

¹²³ Komunikim me postë elektronike mes zyrës së ICG-së në Prishtinë dhe Komisionit Evropian, 19 mars 2004.

¹²⁴ "Riinvest/UNDP Fast Facts on Kosovo Early Warning Report" #6, prill 2004 - rezultatet e anketave të qerekut të vitit.

¹²⁵ Nga 988,7 milion Euro më 2002 në 971 milion Euro më 2003. "Trade Policy for Kosovo 2004" ("Politikat tregtare për Kosovën, 2004"), dokument i përbashkët i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Shtyllës së BE-së, 8 prill 2004.

¹²⁶ Të dhënat e Autoritetit Bankar dhe Pagesave për kreditë komerciale në vitin 2003 tregojnë se kreditë për shërbime, turizëm, hotele/restaurante tejkalojnë ato për bujqësi dhe industri. Shih buletinin statistikor mujor, dhjetor 2003, faqe 11.

¹²⁷ Intervistë e ICG-së, Prishtinë, 30 mars 2004.

¹²⁸ Intervistë e ICG-së, nëntor 2003.

¹²⁰ Shih fusnotën 28

¹²¹ ICG ka tërhequr vërejtjen nga kjo; shih ICG Balkans Report N°66, "*Kosovo: Let's Learn from Bosnia*", 17 maj 1999.

të kësaj çështjeje që do të ishte më pak irrituese për opinionin dhe konfidençën e investitorëve. Njësoj sikur dështimet në fushën e sigurisë, ashtu edhe muajt e tërë të lëkundjeve dhe ngecjeve në procesin e privatizimit vetëm sa forcuan përshtypjet se administrata ndërkombëtare është një krijesë e plogshhtë që nuk ka «muskuj» dhe nuk është në gjendje - apo ndoshta nuk do - të sigurojë përkrahje nga jashtë, në formë të garancave por edhe vendosshmërisë politike që të shpiejë përpara një politikë thelbësore për të cilën ka shpenzar tri vite duke e përpiluar dhe duke u dakorduar rreth saj. Në sytë e investitorëve, UNMIK-u ka shumë pak kredibilitet si garantues i të ardhmes. Ndërsa është pritur që të dëgjohen nga shtresat e gjëra të shqiptarëve të Kosovës teori konspiracioni për Shtyllën e BE-së dhe zyrtarët e AKM-së që thonë se këta e bllokojnë procesin e privatizimit për të ruajtur interesat afariste të Evropës me Serbinë, është befalusë të dëgjohen, në biseda private, fjalë të tilla edhe nga zyrtarë të lartë të UNMIK-ut.¹²⁹

Edhe pse duhet të jetë motori i regjenerimit ekonomik të Kosovës, shtylla e BE-së ka probleme të shumta. Akuzat për korrupsion e kanë shoqëruar tash gati dy vite. Çfarëdo të jetë e vërteta e këtyre thash-e-thëmeve, kjo Shtyllë nuk ka të zhvilluara procedurat interne të mbikqyrjes nga një autoritet më i lartë që do të zvogëlonte gjasat për korrupsion. Një zyrtar i BE-së pranon se «shtylla IV e UNMIK-ut është një krijesë e çuditshme, pa nënë e pa babë».¹³⁰ BE-ja vetëm paguan faturat për të. Nuk ka lidhje institucionale me selinë e BE-së në Brussels e në të nuk ka zyrtarë të Komisionit Evropian. Për më tepër, Komisioni është kujdesur që të mos i përgjigjet aspiratës së kësaj shtylle që të «adptohet», duke preferuar që ta mbajë sa më largë.

Por, lëshime ka edhe qasja e IPVQ-së ndaj zhvillimit ekonomik. Korrupsioni, mungesa e madhe e aftësive dhe vizionit, së bashku me përçarjet politike, që të gjitha këto kanë penguar IPVQ-në që të luajë rol më pro-aktiv dhe prijëtar në planifikimin ekonomik. PDK-ja kontrollon Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ndërsa LDK-ja Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Bashkëpunimi i tyre më shumë karakterizohet me rivalitet se sa me koordinim.¹³¹

Edhe IPVQ-ja edhe UNMIK-u nuk janë treguar të aftë që të korigojnë disa nga dështimet më të mëdha në fushat kryesore të ekonomisë që rrezikojnë të cungojnë gjasat për zhvillim të Kosovës. Grumbullimi i të ardhurave buxhetore nuk po shkon si duhet - shumica e shqiptarëve të Kosovës, qofshin persona fizikë apo biznese, nuk paguajnë llogaritë e tyre apo tatimet. I vetmi sukses në grumbullimin e të ardhurave është shënuar në detyrën e thjeshtë të grumbullimit të taksave doganore në kufi. Në dhjetor të vitit 2003, konsumatorët i kanë pasur borxh Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) gati 150 milion euro¹³² ndërsa Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka vlerësuar se në vitin 2003 nuk janë vjelur rreth 200 milion euro të tatimeve në vend.¹³³ Nëse mbledhen këto dy shifra, do të japin një shumë që është sa gjysma e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës në nivelin që është tani.

Kështu, politikat ekonomike mbesin të fragmentuara, pa vizion, duke çaluar për shkak të dështimeve edhe në ambientin e brendshëm por edhe atë të jashtëm të Kosovës. Kërkesat e komunitetit të biznesit në Kosovë që të zbatohen taksa të ndryshme doganore për lëndën e parë dhe tjera për të mirat materiale nuk merren parasysh sepse përgjegjësia për këto politika është e ndarë mes UNMIK-ut dhe IPVQ-së por edhe për shkak se dallimi i taksave doganore do të kërkonte një shtresë të re të administratës që do të ishte e hapur për keqpërdorime dhe korrupsion.

Pasiguria dhe jostabiliteti që kanë shkaktuar trazirat e marsit vetëm sa i ka bërë edhe më bindëse dyshimet ekzistuese. Mungesa e statusit final të qartë për Kosovën ka ndaluar investimet në të gjitha nivelet. Bankat e Kosovës nuk mund të tërheqin depozite afatgjata prandaj as nuk mund të japin kredi afatgjata. Derisa çështja e statusit final të bëhet krejt e qartë, investimet private vështirë se do t'i biejnë kah

Tregtisë e Industrisë, Ali Jakupi, për zhvillimin ekonomik afatmesëm të Kosovës. Ideja qendrore e tij e zhvillimit të ekonomisë së Kosovës nëpërmjet programit të ndërtimeve masive është kritikuar rëndë nga ekonomistët lokalë. Edhe në modalitet e propozuara edhe në gjenezë, planit i mungojnë pikat e bashkëpunimit - edhe pse parashih investime në shkallë prej 5 miliardë eurosh në periudhën prej 4 deri 5 vjetë, supozon se kjo e tëra mund të bëhet pa ndihmë nga jashtë. Plani është zhvilluar pa konsultime ndër-ministore, pa e lidhur planin me planifikimin buxhetor apo çfarëdo procesi të ekzaminimit të legjisllacionit të ri që do të nevojitej për të mbështetur atë.

¹³² "KEK at a glance", citat i zëdhënësës së KEK-ut, Betty Dawson.

¹³³ Intervistë e IWPR-së me Andreas Wittkowsky, Shtylla e BE-së, 16 prill 2004.

¹²⁹ Intervistë e ICG-së, janar 2004.

¹³⁰ Intervistë e ICG-së, dhjetor 2003.

¹³¹ Përpjekja e parë për të dalë nga ky kurth nxori në sipërfaqe dobësitë e zakonshme - në dhjetor 2003, Zyra e kryeministrit (e dominuar nga PDK-ja) i dha përkrahje planit të Ministrit të

Kosova. Paqartësia kontinuele e bën të pamundur që të dihet se cilat ligje a rregullore do të mbeten në fuqi e cilat mund të ndërrojnë e kjo e bën të pamundur të llogaritet niveli i rrezikut dhe të merren vendime të qarta për investime. Edhe vet investitorët kryesisht vendorë apo nga diaspora që qëndruan prapa 180 ofertave për 18 NSH-të e tenderuara në valën e dytë të privatizimit që rezultuan me 137 milion euro të ofruara (ofertat e zgjedhura bëjnë gjithsej 25 milion euro) tani nuk do t'u qasen tenderëve të ardhshëm me të njëjtën ndjenjë besimi që kanë pasur.

Përveç paqartësive në investime, mungesa e statusit të definar mban Kosovën edhe jashtë shumicës së klubeve në të cilat mund të anëtarësohesh vetëm nëse je shtet. Kjo e kufizon në mënyrë të konsiderueshme punën e sektorit bankar dhe financiar. Pamundësia e Kosovës që të anëtarësohet në sistemin ndërkombëtar të transfereve bankare, SWIFT, vetëm sa e forcon statusin e saj të enklavës së marginalizuar - të mbetur jashtë rrjeteve financiare ndërkombëtare. Kjo e bën Kosovën joatraktive për grupet bankare botërore. Shumë pak prej tyre do të pranojnë të ndërrojnë procedurat e tyre vetëm sa për të afaruar me një territor kaq të vogël e ku ekonomia që funksionin me para të gatshme shton frikën nga mundësia për pastrim parash - dhe tërë kjo shëndrohet vetvetiu në një rreth vicioz. Madje edhe Autoriteti Bankar dhe i Pagesave, filizi i Bankës qendrore të Kosovës e menaxhuar nga FMN-ja, nuk është në gjendje të përdorë depozitat e veta në botë sepse nuk mund t'i bindë bankat e jashtme (përveç dy apo tri bankave të tilla që kanë pasur guximin të hyjnë në sektorin bankar në Kosovë) që t'i pranojnë paratë e saj.¹³⁴ Mungesa e sovranitetit shtetëror Kosovës ia cungon edhe qasjen në fondet në bankat zhvillimore për të rimëkëmbur infrastrukturën e vet.

Grupi i Kontaktit dhe vendet anëtare të BE-së duhet të angazhohen fuqishëm dhe të mbështesin zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në afat të shkurtër, ky angazhim duhet të pëqëndrohet në plotësimin apo riparimin e boshllëqeve dhe duke plotësuar atë që është humbur për shkak të pavendosshmërisë dhe ambivalencës së bashkësisë ndërkombëtare rreth statusit final - duhet të rregullohet çështja e privatizimit dhe anëtarësimit në klube. Iniciativa e Grupit të Kontaktit për formimin e Grupit për Përkrahjen e Kosovës, duhet të merret edhe me këtë.

Pa pasur adresë të vetën, Kosova duhet të mbulojë mungesën e anëtarësimit në klube të ndryshme botërore duke huazuar apo marrë me qera adresa të përkohshme - kodin për telefoninë mobile e ka marrë nga Monako, identitetin e aeroportit nga Islanda. Megjithatë, shumica e zbrazëtime mbesin të paplotësuara. Derisa nuk gjendet zgjidhje për statusin final të Kosovës, anëtarët e BE-së dhe vendet e Grupit të Kontaktit duhet të ndajnë mes tyre përgjegjësinë që të shërbejnë si garantë për anëtarësimin e Kosovës - në skemën e SWIFT kodit, të Kartës së Gjellbër të sigurimit të veturave e kështu me rradhë.

Njëkohësisht, ata duhet të përkrahin dhe këmbëngulin në kthimin e politikës aktive në raport me privatizimin që qe ndjekur nga udhëheqësia e mëparshme e UNMIK-ut e e Shtyllës së BE-së, para vjeshtës së vitit 2003. Privatizimi është ndërprerë për disa shkaqe që duhet të adresohen dhe korrigjohen - lidershipi në shtyllën e BE-së dhe AKM që duket se ishte i obsesionuar me gjetjen e arsyeve dhe mekanizmave për të shtyer privatizimin; dhe mungesa e përkrahjes nga ana e sekretariatit të OKB-së që nga tetori i vitit 2003, që u manifestua veçanërisht në refuzimin e dy kërkesave kryesore të AKM-së, që zyrtarëve të AKM-së t'u jepet imunitet çfarë e gëzojnë të gjithë të punësuarit në misionet e OKB-së, dhe kërkesa për një formulë të thjeshtë që do të shfuqizonte transformimin jashtëzakonisht të dyshimtë të NSH-ve në Kosovë në kohën e Milosheviqit (AKM-ja kishte sugjeruar që UNMIK-u t'i shpallë të pavlefshme tri ligje serbe sipas të cilave qe bërë transformimi i NSH-ve gjatë viteve nëntëdhjetë).

Nëse do të zgjidheshin këto dy nyje në të cilat ka ngecur privatizimi, atëherë korniza ligjore që ka përpiluar UNMIK-u në verën e vitit 2003 është mjaft e favorshme për të vazhduar me programin e privatizimit. Në vend të kompromisit aktual, jofunksional, sipas të cilit njëherë duhet hetuar transformimi i pronës gjatë të nëntëdhjetave për secilën nga përafërsisht 400 NSH-të kosovare dhe pastaj të anulohet transformimi - qoftë për shkak se transformimi është bërë me shkelje të ligjit të asaj kohe apo për shkak të elementeve diskriminuese - e pastaj të bëhet privatizimi, UNMIK-u duhet të prezentojë para Sekretariatit të OKB-së dhe para Këshillit të Sigurimit hulumtimet që AKM-ja ka kompletuar për 30 NSH-të e privatizuara deri tani dhe kjo të përdoret si mostër për të demonstruar se në çdo rast gjatë viteve 90-të, transformimi i pronës është bërë qoftë duke shkelur ligjin (për shembull,

¹³⁴ Intervistë e ICG-së me Donat Branger, Drejtor menaxhues i Autoritetit Bankar e të Pagesave, 5 dhjetor 2003.

nuk është bërë pagesa) apo me diskriminim (për shembull, fuqia punëtore shqiptare përnjëherë është zëvendësuar me atë serbe në vitet 1990 e 1991). Këto hulumtime duhet të shfrytëzohen si bazë që në nivel të OKB-së të vendoset të anulohen transformimet e pronës të bëra në kohën e Milosheviqit.

Besimi i bizneseve dhe investitorëve ka pësuar goditje të konsiderueshme nga trazirat e 17 e 18 marsit. Kjo e bën edhe më urgjente nevojën për angazhim të ri, më energjik, të bashkësisë ndërkombëtare në ekonominë e Kosovës. Përkrah paralajmërimeve për hapa në fushën e privatizimit dhe «anëtarësimit në klube» për Kosovën, duhet alokuar donacione të reja ndërkombëtare për të ndihmuar zhvillimin ekonomik e arsimor të Kosovës. Reformat duhet të bëhen këtu në Kosovë me qëllim që të unifikohen autoritetet paralele e të ndara përgjegjëse për politikën ekonomike dhe planifikim.

B. STRUKTURAT PARALELE

Bashkësia ndërkombëtare duhet të shfrytëzojë rrethanat e tashme që të sjellë strukturat paralele nën sistemin e gjërë qeverisës të UNMIK-ut - që të sigurojë, në njërin anë se IPVQ-ja i njih ato dhe, në anën tjetër, të sigurojë dakordimin e Beogradit se ato do të bëhen pjesë e strukturave të UNMIK-ut. Beogradi dhe serbët e Kosovës duhet të hyjnë në dialog të qëndrueshëm me UNMIK-un dhe vendet e Grupit të Kontaktit për një rregullim të tillë. Serbët e Kosovës duhet të marrin rol prijës në këtë, ndërsa Beogradit duhet t'i mbështesë ata e jo t'i udhëheqë e drejtojë ata. Serbët e Kosovës duhet të kërkojnë resurse nga UNMIK-u, Beogradi dhe IPVQ-ja, që këto së bashku të financojnë strukturat e tyre.

Një rregullim i tillë i strukturave paralele duhet të bëhet me qëllim që të trasohet rruga për decentralizim të qeverisjes lokale në vija të planit të Këshillit të Evropës (Plani i Civiletit) - duke synuar një formë më të lirë dhe më pak «të integruar» të koegzistencës se sa që parasheh modeli i tashëm i administrimit unitar të UNMIK-ut. UNMIK-u duhet të institucionalizojë dialogun mes liderëve të shqiptarëve të Kosovës dhe shoqërisë së tyre civile

si dhe homologëve të tyre ndër serbët e Kosovës rreth mënyrave të bashkëjetesës në Kosovë¹³⁵.

IPVQ-ja duhet të inkurajohet të marrë iniciativën në propozimin e infrastrukturës sociale për pakicën serbe në Kosovë: një kanal televiziv i ndarë mbarë-kosovar; përkrahje për ato që deri tani kanë qenë struktura paralele në arsim, shëndetësi dhe fushat tjera; hapa afirmativë për përmirësimin e ligjit për prokurim publik; dhe, ç'është më e rëndësishmja, të ofrojë modalitete të decentralizimit territorial që do të garantojnë sigurinë dhe prosperitetin e komuniteteve serbe në Kosovë. IPVQ duhet të pranojë këtë ndërsa bashkësia ndërkombëtare duhet ta bëjë të qartë se dështimi që të marrin iniciativën rreth decentralizimit do të rezultojë me atë që kjo punë do t'i merret fare nga duart.

Raportohet se Beogradi është duke bërë presion mbi liderët e serbëve të Kosovës që të bëhen gati për ndarje «të vrazhdë» të paraparë me agjendën për kantonizim - duke shfrytëzuar gatishmërinë ndërkombëtare për të bërë «decentralizimin», e me qëllim që të shpiejë përpara agjendën destabilizuese të ndarjes së një cope sa më të madhe nga Kosova dhe për t'ia bashkuar Serbisë. Beogradi duhet të mendojë mirë e shtruar nëse kjo vërtetë është në interes të serbëve të Kosovës, apo nëse taktikat e tilla dhe përqëndrimi i vëmendjes në territor e jo në njerëz është thjeshtë përsëritje e gabimeve të bëra në Kroaci e Bosnjë e që përfundimisht rezultuan me dëbim të dhunshëm të popullatës serbe.

Grupi i Kontaktit, ashtu siç duhet të bëjë presion mbi IPVQ-në që të ofrojë modalitete të decentralizimit territorial për serbët e Kosovës, ashtu duhet të bëjë presion mbi Beogradin që të heqë dorë nga përgatitjet për kantonizim destabilizues të Kosovës. Kushtëzimi i ndihmave duhet të përdoret si lloz. Njëherë për njëherë, bashkësia ndërkombëtare po lejon që ndihmat e saj financiare për Serbinë të ridrejtohen dhe të shkojnë në financimin e strukturave paralele në Kosovë, në masë prej së paku 80 milion eurove në vit.

Përfundimisht, nëse Beogradi dëshiron të ndihmojë jetën e popullatës serbe në Kosovë, veçanërisht atyre në jug të Lumit Ibër, duhet të fillojë të punojë për stabilitet në Kosovë e jo kundër tij, dhe të bëhet partner i UNMIK-ut dhe IPVQ-së e jo armik i tyre.

¹³⁵ Dialogu mes Prishtinës e Beogradit është i kufizuar në fushën e personave të zhdukur, kthim të të zhvendosurve, energjetikë dhe transport/telekomunikacion.

Beogradi duhet të punojë që të përmirësojë tonin dhe fjalorin racist kur flet për shqiptarët e që vjen edhe nga gojët e zyrtarëve edhe nga mediat dhe të bëjë shumë më shumë se sa po bën tani që të përgjegjet për krimet e luftës. Do të ishte gabim shumë i madh që të humbasen mundësitë e ofruara për të negociuar vetqeverisjen lokale për komunitetet serbe në Kosovë dhe atë në favor të agjendës tejet ambicioze territoriale që rrezikon të bëhet mallkom për këto komunitete dhe të shtyejë rajonin edhe njëherë në greminën e konfliktit të armatosur.

C. KOORDINIMI NË FUSHËN E SIGURISË

Edhe nëse ata që kanë ushtruar dhunë gjatë marsit 2004 nxjerren para drejtësisë (gjë që do të kërkojë edhe 100 hetues ndërkombëtarë dhe gjashtë prokurorë ndërkombëtarë shtesë)¹³⁶, në aparatin e sigurisë në Kosovë mbesin boshllëqe serioze.

Reagimi i policisë gjatë trazirave zbuloi lëshime të shumta si në forcën policore të UNMIK-ut ashtu edhe në koordinimin me organet tjera të sigurisë. Kjo ka hapur edhe çështjen e rëndë të së ardhmes së SHPK-së. Ndërsa qasja jo e njëjtë e KFOR-it në përdorimin e TMK-së gjatë trazirave ka ngritur çështjen se si do të zhvillohen marrëdhëniet mes misionit paqësor dhe këtij organi. Policia e UNMIK-ut së bashku me KFOR-in duhet të përpilojnë një plan të sigurisë për raste të jashtëzakonshme që do të ketë sigurinë e pakicave prioritet, në rast se përsëri eskalon dhuna kundër pakicave. Dështimi që të ketë një plan të tillë dhe ta zbatojë atë më 17 mars dhe niveli i ultë i koordinimit me KFOR-in nuk bën të përsëritet.

Duhet të rishikohet mënyra si udhëheqet dhe organizohet policia e UNMIK-ut. Edhe pa incidentin tragjik të 17 prillit, në të cilin u vranë tre e u plagosën njëmbëdhjetë policë ndërkombëtarë në shkëmbimin e zjarrit mes pjesëtarëve amerikanë dhe jordanezë të kësaj force, mënyra se si qe reaguat gjatë trazirave tregon se natyra multinationale dhe tranzitore e forcës policore të UNMIK-ut e bënë këtë shumë pak koherente. Aktualisht është një forcë policore amorfe, pa vlera të përbashkëta e pa ndjenjë identiteti e përkatësie. Nevoitet leadership i fuqishëm dhe energjetik për të vënë ndjenjën e orientimit dhe identitetit që tani mungon. Lejohet që forcën ta drejtojnë vlera politike e jo policore e kjo shpie përfundimisht në

rënim të forcës dhe korrupsionim. Si e tillë, policia e UNMIK-ut nuk është mësues shembullor për SHPK-në, çfarë do të duhej të ishte në të vërtetë.

Forca policore e UNMIK-ut duhet të forcohet duke kufizuar numrin e vendeve që kontribuojnë me forca të veta policore dhe këto të jenë vetëm vendet e zhvilluara që dallohen me respektim të të drejtave të njeriut, ndërsa kohëzgjatja e shërbimit duhet të zgjatet ashtu që të pakësohet natyra tranzicionale e forcës.

Morali i SHPK-së është ka rënë në nivel të rrezikshëm pas trazirave dhe duhet të ndërmeren hapa që të ngritet. Shumica e oficerëve të SHPK-së mendojnë se po u vihet barra e fajësisë për veprat e një pakice, apo se nuk po u jepet mjaft autonomi operacionale që të përballen apo pengojnë trazirat ashtu siç ata mendojnë se do të duhej të bëhej kjo. Elementet e SHPK-së që reaguat në mënyrë gjegjëse gjatë krizës duhet të pëkrahen, t'u njihen meritat dhe të lartësohen. Është me rëndësi që jo vetëm të hetohen, suspendohen apo edhe dënohen oficerët e SHPK-së që dështuan të kryejnë detyrën e tyre apo edhe u ndihmuan pjesëmarrësve në trazira, por edhe që paralelisht me këtë të hetohen dhe raportohen rastet kur është vepruar me sukses. Programi i kalimit gradual të përgjegjësive për sigurinë në duart e SHPK-së, që është ndërprerë pas trazirave, duhet të ridisejohet që të marrë parasyshë rezultatet e të gjitha këtyre hetimeve. Tranzicioni ndoshta do të duhet të bëhet më ngadalë se sa që është menduar, por me përgatitje dhe trajnime më përmbajtësore, ndërsa përparësi t'u jepet stacioneve policore dhe njërive që janë dalluar me reagime të mira gjatë trazirave.

Morali i SHPK-së nuk varet vetëm nga mënyra se si do të trajtohet nga UNMIK-u, por edhe nga mënyra se si do të perceptohen nga popullata e përgjithshme. Ka evidencë anekdotale se në disa vende, oficerët e SHPK-së qysh tani po përjetojnë vështirësi dhe po shikohen si lakenj të UNMIK-ut apo ngjashëm. E rëndësishme për përcaktimin e qëndrimit të popullatës shqiptare kundrejt forcave të sigurisë dhe pozitës së SHPK-së në këtë, do të jetë mënyra se si do të trajtohet TMK-ja.

Nëse SHPK-ja paraqet orientimin shtetëformues të shqiptarëve të Kosovës në sistemin e sigurisë, atëherë TMK-ja paraqet atë të rezistencës. Bashkësia ndërkombëtare është përpjekur që ta mbajë atë në kuadër të rolit të forcës për emergjencat civile dhe shpëtimtare, duke mos lejuar që struktura pasardhëse e UÇK-së të realizojë aspiratat e saja për

¹³⁶ Sipas "non-paper"-it të Sekretariatit të Këshillit të BE-së.

rol ushtarak e të sigurisë publike në Kosovën e re. Por, anketat tregojnë vazhdimisht se TMK-ja është organizata më e popullarizuar ndër shqiptarët e Kosovës, mu për shkak të rrënjëve të saja si organizatë e rezistencës dhe për shkak të potencialit të saj latent për të lujtur rol në fushën e sigurisë. Në kulmin e trazirave, dy brigada shumëkombëshe të KFOR-it hoqën tabutë e angazhimit të TMK-së në çështjet e sigurisë publike.

Ky precedan as nuk duhet të institucionalizohet por as të hedhet poshtë. Në vend të kësaj, secila brigadë shumëkombëshe e KFOR-it duhet të vëjë lidhje të forta partneriteti me TMK-në në rajonin e tyre, duke e ndihmuar me trajnime për gjendje emergjente që janë në mandat të TMK-së por edhe duke ngritur vet-besimin e tyre. Për shoqërinë e shqiptarëve të Kosovës që ende ndodhet në udhëkryqin mes rezistencës dhe shtetformimit, një partneritet i tillë me TMK-në do të shpiente drejt afrimit të këtyre dy orientimeve e me këtë do të lehtësohej edhe pozita e SHPK-së.

Implikimet në kuptimin më të gjërë të sigurisë, të dhunës së marsit janë mëse serioze. KFOR-i dhe NATO kanë humbur aurën e të qenurit të pacenueshëm dhe të pa-arritshëm. Kjo mund t'i bëjë ata cak i sulmeve në të ardhmen, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Bosnjë. Me forcë të pakësuar ushtarake në Ballkan, aftësia e NATO-s që me vendosshmëri të përdorë forcën në Kosovë apo Bosnjë në mënyrë simultane tani është vënë në pikëpyetje. Ballkani është ambient politik që nuk të falë: bindja se bashkësia ndërkombëtare është e dobët dhe nuk është e gatshme që të veprojë nuk do të fshihet nga mendjet e ekstremistëve nacionalistë në Kosovë dhe gjëkund, përfshirë këtu edhe nacionalistët e ringjitur në skenë në Beograd.

Nacionalistët e ringjitur në skenë në Beograd mund të kenë mësuar mësimet të gabuara në mars. Edhe në armatë edhe në polici, elementet nacionaliste, djathtiste, që qenë marginalizuar nën qeverisjen e DOS-it, janë trimëruar nga ngadhënjimi i nacionalistëve në zgjedhjet e dhjetorit. Largimi i kryetarit të DS-së (Demokratska Stranka - Partia Demokratike), Boris Tadiq, nga posti i Ministrisë të Mbrojtjes mund të sinjalizojë fundin e reformave edhe ashtu të pakta të bëra deri tani në kuadër të forcës ushtarake. Është e qartë se disa formacione ushtarake serbe kanë qenë në Mitrovicë më 17

mars.¹³⁷ Qeveria u gjet nën presion të madh nga elementet nacionaliste - në armatë dhe ministrinë e brendshme - që të intervenojë hapur. Elementët të caktuar nacionalistë në Parlamentin e Serbisë gjithashtu preferojnë një zgjidhje të tillë. Në rast të ndonjë përkeqësimi tjetër të gjendjes së sigurisë në Kosovë, forcat serbe të sigurisë mund të vendosin të hyjnë hapur në provincë. Kjo do të përballte OKB-në dhe NATO-n me një situatë të re e të rrezikshme: jo vetëm që Beogradi do të sfidonte me interpretimin për dështim të protektoratit të OKB-së, por do të rrezikonte edhe të niste një konflikt më të gjërë me popullatën shqiptare të Kosovës. Në këtë rast, KFOR-i dhe UNMIK-u do të gjindeshin mes dy zjarreve, duke u konsideruar armik nga secila anë.

Dhuna etnike në Kosovë do të përhapej jo vetëm në Serbi, dhe jo vetëm në Luginën e Preshevës me shumicë shqiptare, por edhe në Sanxhak, në pjesën jug-perendimore të Serbisë, me shumicë muslimane, por edhe në provincën me popullatë etnikisht të përzier, në Vojvodinë, ku kroatët dhe hungarezët kanë raportuar shtim alarmant të incidenteve gjatë dhe pas trazirave të marsit.¹³⁸ Të gjitha këto popullata pakicë frikësohen se nacionalistët e ringritur në pushtet në Serbi do të shrytëzonin dhunën në Kosovë si shkas për të pastruar Serbinë nga pakicat e mbetura. Ekziston mundësia që shpërthimi i dhunës në Kosovë të nxisë edhe serbët e Bosnjës që të provojnë të ndahen nga Bosna.

As NATO, as BE-ja, as OKB-ja, as bashkësia ndërkombëtare në përgjithësi, nuk janë të gatshme për kollapsin e përgjithshëm të sigurisë në tërë rajonin që do të mund të shkaktonte ndonjë pastrim i ri etnik në Kosovë. Shpërthimi i dhunës në disa vende, në të njëjtën kohë, do të rëndonte resurset ndërkombëtare diplomatike e të sigurisë deri në skajshmëri. Për të treguar se e ka seriozisht kur flet për rimarrjen e primatit në çështjet e sigurisë, KFOR-i duhet jo vetëm të shtojë vizibilitetin në përgjithësi në Kosovë, por edhe të shtojë prezencën në të gjitha vendkalimet kufitare në Kosovë - edhe në jug, t'u sinjalizojë të gjithë shqiptarëve keqbërës se nuk mund të presin të hyjnë e të dalin nga Kosova pa u kapur, por edhe në veri, që të pengojë çfarëdo avanturizmi të mundshëm të forcave serbe.

¹³⁷ Intervistë e ICG-së me burime serbe në Beograd dhe në veri të Mitrovicës, mars-prill 2004.

¹³⁸ Intervistë e ICG-së me grupet e të drejtave të njeriut në Serbi e Vojvodinë, mars-prill 2004.

X. RRUGA PËRPARA

Do të ishte gabim të shpërblehet dhuna e 17 e 18 marsit duke nisur negociatat për statusin final, apo duke marrë vendime të ngutshme rreth rivijëzimit të kufijve apo kantonizimit. Megjithatë, politika «standartet para statusit» ka nevojë për rikalibrim të menjëhershëm. Deri më sot, mesazhi i ardhur nga zyrtarët ndërkombëtarë ka qenë se nuk do të ketë diskutim për formën e statusit final të Kosovës para se të plotësohen në mënyrë të kënaqshme standartet; dhe se vlerësimi i kësaj përmbushjeje nuk do të bëhet para mesit të vitit 2005. Kjo përpjekje për të ndalë debatin, edhe pse ka pasur për qëllim që të kanalizojë energjitë diku tjetër, në të vërtetë ka bërë që të ngriten tensionet dhe të shtohet dyshimi ndër shqiptarët e Kosovës rreth qëllimeve të vërteta të bashkësisë ndërkombëtare.

Por, para se të mund të fillojnë negociatat mes Kosovës e Serbisë, me mbikqyrje ndërkombëtare, rreth statusit final, duhet të bëhet punë e vërtetë përgatitore që duhet të fillojë sa më parë. Siç u argumentua më lartë, më e mira do të ishte që kjo të bëhet nga një përfaqësues i lartë i OKB-së që, për dallim nga PSSP-ja aktual apo pararendësit e tij, nuk është i ngarkuar edhe me detyrat administrative. Në ndërkohë, Shtetet e Bashkuara duhet të ndjekin shembullin e Bashkimit Evropian dhe të emërojnë një përfaqësues special për Kosovën për të demonstruar përkushtimin e tyre ndaj procesit dhe për të siguruar koordinimin në nivelin më të lartë.

Para fillimit të bisedimeve, bashkësia ndërkombëtare mund të bëjë shumë që të përgatisë terrenin, veçanërisht duke bërë absolutisht të qartë se bazë legale për bisedat do të jetë Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që i jep OKB-së mandat të ndihmojë procesin politik me synim përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Kjo është me rëndësi pasi shqiptarët besojnë se shpallja e pavarësisë që kanë bërë më 1991 dhe lufta e më vonshme janë baza të shtetësisë; ndërsa serbët vazhdojnë të deklarojnë se Kosova mbetet pjesë e pandashme e Serbisë.

Potenciali i një Kosove kaotike që të destabilizojë tërë rajonin është diskutuar më lartë. Me qëllim që të sigurohen fqinjët e saj, duhet të gjenden mënyra që në procesin e përcaktimit të statusit final të inkuadrohen edhe vendet tjera të rajonit. Këta nuk duhet të jenë pjesëmarrës me të drejta të plota - kjo në fund të fundit duhet të jetë marëveshje mes OKB-së, Serbisë dhe Kosovës, dhe të fusësh në lojë si aktorë të barabartë edhe vendet tjera të rajonit

vetëm sa do të shtojë dyshimin se tërë ky proces në të vërtetë është një rivizatim i hartës së rajonit në kuadër të një plani më të madh ndërkombëtar. Kujtimet nga Kongresi i Berlinit, 1878, janë ende të freskta dhe të forta, si dhe kujtimet për intervenimet e mëvona të Fuqive të Mëdha, që në mënyrë arbitrare vizatuan kufijt e vendeve të Ballkanit duke mos çfarë kokën gati fare për kërkesat e popullatës vendore.¹³⁹ Në vend të kësaj duhet gjetur mënyra tjera për të forcuar besimin ndër vendet e rajonit, që shkojnë nga konslutimet me pjesëmarrësit në negociatat për Kosovën deri te statusi i vëzhguesit në vet negociatat.

Më shumë duhet të mendohet edhe për vet agjendën e bisedimeve, në veçanti për pozitën e serbëve të Kosovës. Garancat e shqiptarëve të Kosovës se pakicat do të gëzojnë siguri kur të fitohet pavarësia nuk janë aspak bindëse, sidomos tash pas dhunës së marsit 2004 (por edhe para kësaj) dhe pas dështimit të shumicës së liderëve të Kosovës që të reagojnë në mënyrë të duhur. Kjo është një prej pikave ku standartet do të jenë të lidhura me statusin - nëse IPVQ-ja ia del që të riparojë me të shpejtë dhe hapur dëmet fizike dhe nëse bën përpjekje të sinqerta, siq u përmend më lartë, që të përfitojë besimin e serbëve të Kosovës, atëherë nevoja për provizione speciale do të jetë proporcionalisht më e vogël. Megjithatë, bashkësia ndërkombëtare duhet ta bëjë të qartë se duhet të bëhen disa provizione speciale; çëshjta është se sa?

Sigurisht që është herët të sinjalizohet qoftë rishikimi i kufirit të Kosovës me Serbinë qoftë kantonizim i brendshëm i Kosovës. Çfarëdo ndërrimi i kufijve, në çfarëdo konteksti, do të rrezikonte të nxisë ndarje të reja në vija etnike në rajon. Për më tepër, në nivelin praktik, kjo do të lente komunitetet e serbëve të Kosovës që ndodhen në jug të lumit Ibër të izoluar në një Kosovë të cunuar, identiteti i së cilës do të jetë krejtësisht shqiptar, pa fille të identitetit qytetar, dhe pa qendër urbane në Kosovë për serbët e Kosovës ku ata do të siguronin përkahje dhe mbështetje në fushën e shëndetësisë, arsimit, mediave dhe sferave tjera të jetës. Do të nevojiteshin përf forcime të konsiderueshme të KFOR-it për të parandaluar vendorët që edhe një herë me anë të

¹³⁹ Ia vlenë të vërehet se Fuqitë e Mëdha të para një shekulli janë në fakt gati të njëjtat vende që përbëjnë Grupin e Kontaktit sot, përveç se në vend të Austro-Hungarisë tani aty është SHBA-ja.

dhunës të krijonë de facto ndarje në terren.¹⁴⁰ Kantonizimi, që për shumë vëzhgues ndërkombëtarë tingëllon si diçka pozitive për shkak se e asociojnë me Zvicrën, ndër aktorët në Ballkan më tepër ka kuptimin e asaj që tjetërkund në botë quhet «ballkanizim» - ndarje e territorit në njësi të vogla, etnikisht të ndara e në armiqësi me njëra tjetrën, pa qeverisje të vërtetë qendrore, me Federatën e Bosnjës e Hercegovinës si një locus classicus. Tani për tani, emërtimi gjegjës është «decentralizimi», edhe pse, siç u tha më lartë,¹⁴¹ ende duhet të punohet në artikullimin më të qartë të këtij koncepti.

ICG-ja për një kohë të gjatë ka argumentuar se mënyra më e mundshme dhe më e dëshiruar e zgjidhjes së statusit final është që Kosova të fitojë një formë të pavarësisë së kushtëzuar. Ndër kushtet duhet të jenë insistimi për arritjen e standardeve të duhura në fushën e të drejtave të pakicave brenda një kohe, para se të njihen beneficionet e pranimi të plotë ndërkombëtar. Në prizmën e ngjarjeve të fundit, rëndësia e këtij dimenzioni duket të jetë edhe më e qartë. Kushte tjera do të mund të ishin edhe që Kosova të heqë dorë nga çfarëdo bashkimi i mundshëm në të ardhmen me Shqipërinë dhe ndonjë formë e përkohshme e një trustshipi ndërkombëtar me fuqi vetoje.¹⁴²

Tërë kjo kërkon punë. Nëse bashkësia ndërkombëtare reagon në mënyrë konzervative, me politikë të konzervimit, dhe trajton pastrimin etnik të marsit 2004 si shkak për të shtyer edhe më shqyrtimin e statusit final të Kosovës, edhe përtej verës së vitit 2005, mund të pritët më shumë dhunë nga ana e shqiptarëve të Kosovës - edhe kundër serbëve të Kosovës, edhe kundër Misionit të OKB-së dhe forcave ndërkombëtare të sigurisë. Gjendja do të përkeqësohej gradualisht deri në luftë të nivelit të ultë, duke ngujuar prezencën ndërkombëtare përballë

popullatës shumicë të armiqësuar e të zemëruar, dhe me potencial që të destabilizojë tërë rajonin.

Pavendosshmëria nuk është opcion. Elementet ekstremiste dhe kriminale që përvetësuan, mbajtën gjallë dhe përhapën për dy ditë atë që filloi si dhunë spontane në Mitrovicë, në mëngjesin e 17 marsit, tani duhet të jenë duke u konsoliduar dhe duke u organizuar për shpërthime tjera të mundshme. Partneriteti gjithnjë e më i holluar mes bashkësisë ndërkombëtare dhe shqiptarëve të Kosovës, prospektet ekonomike gjithnjë më të errëta, tensionet dhe zymtësia e përditshme mund të nxisin një spirale dhune që do të shpie në një kollaps të plotë social e institucional. Koha po ikën.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 22 prill 2004

¹⁴⁰ Kjo natyrisht nuk përjashton mundësinë që një Kosovë e pavarur të merret vesh për ndërimin e kufirit me Serbinë, në vijë me parimet e Helsinkit.

¹⁴¹ Dhe më herët nga ICG; shih "ICG Balkans Report N°143, *Kosovo's Ethnic Dilemma: The Need for a Civic Contract*", 28 maj 2003.

¹⁴² Ideja e pavarësisë së kushtëzuar është shtruar për herë të parë në "The Kosovo Report", ("Raport për Kosovën"), Independent International Commission on Kosovo (Komisioni ndërkombëtar i pavarur për Kosovën) (bashkëkryesues Richard Goldstone dhe Carl Tham) (Oxford: Oxford University Press, 2000), dhe është përpunuar më tutje në "ICG Balkans Report N°108, *After Milosevic: A Practical Agenda For Lasting Balkans Peace*", 26 prill 2001, pp 127-128.

ANEKSI A

KRONOLOGJI E DHUNËS: 17-19 MARS 2004

DITA E PARË - 17 MARS

Mitrovicë

Demonstruesit ishin në rrugë, në dhe rreth Mitrovicës, qysh para orës 9 të mëngjesit. Një grup kishte bllokuar rrugën në dalje të qytetit, andej kah jugu. Në ndërkohë, mësimdhënës e nxënës shqiptarë të shkollave të mesme organizuan një demonstratë prej disa qindra pjesëmarrësve (të cilës iu bashkuan edhe punonjës të Shtëpisë së Shëndetit) para selisë së UNMIK-ut në pjesën jugore të Mitrovicës, për të protestuar kundër mbytjes së tre fëmijëve.¹⁴³ Mediat lokale menjëherë dhanë lajmin se po bëheshin demonstrata, kështu që rreth orës 9 e 30, aty arriti edhe një grup prej rreth 50 njerëzve të vendit (të njohur nga policia në Mitrovicës si huliganë e kriminelë). Këta mësyen drejtë urës, por atje SHPK-ja kishte ngritur barriera të metala. Këta njerëz brohoritën parrula për nja dhjetë minuta dhe u kthyen prapa - por, siç u pa më vonë, vetëm sa për të shtuar rradhët me përforcime.

Pak para orës 11 u rishfaq grupi i njëjtë, por tash me rradhë të shtuara, i udhëhequr nga një person që mbante një flamur shqiptar. Ata më të zëshmit në turmën prej disa qindra njerëzve i nxitën të tjerët drejtë urës kryesore. Vija e SHPK-së që u kishte dalë para provoi t'i qetësonte dhe t'i ndalte por vija e tyre u çap pas dy-tre minutave nën peshën e turmës më të madhe numerikisht. Gati në urë, një njësi e policisë speciale jordanëze nuk arriti të bëjë gjë dhe turma e anashkaloi atë njësoj sikur që anashkaloi tri autobllinda të policisë së OKB-së që nuk kishin arritur të bllokonin tërësisht rrugën. Rreth 100 shqiptarë që ia dolën të kalojnë urën për një moment u stepën, qartë të habitur që ushtarët e KFOR-it nuk shiheshin asgjëkund. Kur kaluan urën, ata sulmuan me gurë dhe Koktejtë Molotovi veturat dhe restorantin «Dolce Vita».¹⁴⁴ Policia e OKB-së hodhi gaz lotësjellës, tri autobllindat u kthyen në urë ndërsa

policia speciale jordanëze reagoi, gjë që shtyri shumicën e shqiptarëve që të tërhiqen. Brenda pak minutave, qindra serbë u mbodhën në bregun verior duke gjuajtur me gurë shqiptarët e mbetur të cilët më pas u tërhoqën përtej urës. Përleshja e parë zgjati rreth pesëmbëdhjetë minuta. KFOR-i erdhi pasi policia kishte stabilizuar gjendjen në urë. Në katin e pestë të selisë rajonale të UNMIK-ut që shikon kah ura, kishin dalur të gjithë zyrtarët më të lartë ndërkombëtarë dhe po vrojtonin. Ndër ta ishte dhe komandanti i Brigadës Shumëkombëshe Veri-Lindje, gjenerali Michel. Një nga ata që ishte prezent aty më vonë tregoi: «Gjatë atyre njëzet minutave ai shikonte si një spektator. Nuk e pashë të bënte as një telefonatë».¹⁴⁵ U pa aty edhe Halit Berani, «aktivist për të drejtat e njeriut», që po shikonte përleshjen duke folur në telefon celular nga kulmi i qendrës së kulturës, ndërtesë kjo mu pranë urës.¹⁴⁶

Një pjesë e turmës së shqiptarëve në bregun jugor filloi të sulmojë dhe t'ua vëjë zjarrin veturave të parkuara të OKB-së dhe beteja që tash zhvillohej në shetitoren e këmbësorëve ishte mes tyre dhe njësisë speciale polake, me këta të fundit duke hedhur gaz lotësjellës e duke shtënë me plumba gome dhe me ata të parët duke hedhur tulla e koktejtë mollotovi.

Në ndërkohë, duke lëvizur në parkun e qytetit, kah perendimi, 200 deri 300 shqiptarë kaluan urën e këmbësorëve dhe arritën në enklavën e Tre Soliterëve në bregun verior, të banuar kryesisht me shqiptarë, e të ruajtur tërë kohën nga KFOR-i. Edhe pse prezenca dhe postblloqet e KFOR-it tek Tre Soliterët qenë reduktuar vetëm një natë më parë, do të duhej të ketë qenë e mundur për ushtarët që të ndalin masën që të kalojë urën e këmbësorëve pasi aty mund të ecet vetëm një nga një.

Tek «Soliterat» nisi një betejë me gurë mes shqiptarëve e serbëve, me palët të mbajtura të ndara nga trupa të policisë së OKB-së dhe të KFOR-it. Këtu është hedhur një granatë që ka plagosur disa shqiptarë dhe trupa franceze. Për habinë e policëve ndërkombëtarë, ushtarët francezë tek soliterat refuzuan që të përdorin granatat tronditëse duke

¹⁴³ Demonstrata e fëmijëve në jug të Mitrovicës është përcjellur me një të ngjashme të mbajtur jashtë ndërtesës së qeverisë në Prishtinë. Kjo demonstratë poashtu duket të jetë organizuar dhe mbikëqyrur nga të rriturit.

¹⁴⁴ "Dolce Vita" mori nam të zi më 1999 si vend ku rrinin pjesëtarët e "Rojeve të urës", grupit paramilitar tash formalisht i shpërndarë.

¹⁴⁵ Intervistë e ICG-së.

¹⁴⁶ Intervistë e ICG-së me një zyrtar të UNMIK-ut.

thënë se nuk kanë leje për këtë ndërsa kur nga ta u kërkuar që të regojnë kundër dy shqiptarëve që u paraqitën në bregun jugor duke shtënë me kallashnjikovë, pa kontroll, mbi serbët në bregun tjetër, këta u përgjegjën se nuk si ta bëjnë këtë sepse nuk kanë municion.¹⁴⁷ Si kundërpërgjegje në zjarrin e shqiptarëve, zjarri i diciplinar nga armët e vogla, i serbëve, që deri atëherë qëllonin mbi kokat e turmës shqiptare në bregun jugor, tash u bënë të shtëna direkte, por edhe snajperët e forcave ndërkombëtare të sigurisë shtien nga aty afër urës në shqiptarët që shtienin me kallashnjikovë. Katër shqiptarë janë vrarë dhe dhjetra janë plagosur në bregun jugor.¹⁴⁸

Kah ora 1 pasdite, shqiptarët ishin shtyer përtej lumit ndërsa policia filloi të rivendosë kontrollin në parkun e qytetit. Në veri të Mitrovicës ishte një qetësi e rëndë. Turma e serbëve u shpërnda dhe vetëm vëzhguesit mbetën në disa pika. Në jug, përlëshjet sporadike nëpër rrugë mes demonstruesve shqiptarë dhe policisë vazhduan deri kur u errësua.

Prishtina dhe Çagllavica

Kur lajmet për pëleshjet në Mitrovicë arritën në Prishtinë, aty kah mesdita, shqiptarët e kryeqytetit të Kosovës e kishin të gatshëm cakun për të shprehur zemërimin e tyre dhe atë vetëm tri kilometra në jug të qytetit; bllokada e rrugës e ngritur nga serbët e Çagllavicës.

Turma e parë u mbledh «Te rrethi», udhëkryq komunikacioni në pjesën jugore të qytetit ku autobusët, furgonët dhe taksitë mbushen me pasagjerë, aty pranë spitalit dhe Shtabit të TMK-së. Vozitësit e taksive të parët bllokuan rrugën dhe duke tërhequr kështu vëmendjen e udhëtarëve por edhe të njerëzve në banesat aty pranë. Ata që u mbledhën aty filluan t'i thërrasin të tjerët edhe me telefona mobilë. Kur u bërë rreth 400, të mbledhurit filluan të lëvizin drejtë kodrës, kah Çagllavica.¹⁴⁹ Në të njëjtin drejtim lëvizi edhe një pjesë e atyre që morën pjesë në demonstratën e organizuar nga LDK-ja, para Teatrit Kombëtar, për të protestuar kundër hedhjes së granatës në rezidencën e Presidentit Rugova. Në Ajvali, fshat shqiptar afër Çagllavicës, raportohet se mësimdhënësit i kanë lëshuar nxënësit nga orët e mësimi që të shkojnë në Çagllavicë. Fjala u përhap dhe vargu i të rinjëve shqiptarë që shkonin nga

Prishtina në Çagllavicë vazhdoi tërë pasditen. Në Prishtinë, dyqanet filluan të mbyllen.

Turma e dytë përbëhej nga studentë të Universitetit të Prishtinës që banojnë në konvikte në lagjen Bregu i Diellit. Rreth 20.000 studentë sa janë në universitet vijnë kryesisht nga qytetet provinciale dhe fshatrat. Këta janë zakonisht më radikalë dhe më militantë se sa kolegët e tyre të kryeqytetit. Përafërsisht 4.000 prej tyre jetojnë në konvikte. Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës (UPSUP) ka histori të mobilizimit nacionalist, pasi ka organizuar protestat e tetorit 1997 kundër regjimit serb duke anashkaluar presidentin Rugova dhe LDK-në që atë kohë ishin shtyllat kryesore të rezistencës së shqiptarëve të Kosovës kundër Milosheviqit. Unioni ishte edhe në ballë të protestave të vona anti-UNMIK. Por, lidershpi i tyre që kontestuar në muajt e fundit. Që nga vjeshta e vitit 2003, një lëvizje e re studentore «Tjetërqysh» bënte fushatë kundër kontrollit politik, korrupsionit dhe stagnimeve në rektoratin e universitetit. Disa javë para 17 marsit kishte filluar edhe fushata e zgjedhjeve për unionin e studentëve.

Kur studentët u kthyen në konviktet e tyre atë pasdite të 17 marsit, gjetën afishe që i ftonin të dalin në demonstrata. Në emër të «këshillit organizativ», dikush u drejtohej në konvikte me anë të megafonit, duke i ftuara studentët të dalin dhe duke i quajtur tradhëtarë ata që refuzojnë. Udhëheqësia zyrtare e UPSUP-it u gjet e lënë prapa, pa ditur çfarë po ndodhë. Gani Morina, kryetar i saj, i ka thënë ICG-së se ka provuar që të kontaktojë me Këshillin organizativ por ishin «njëqind» njerëz që thonin se ata janë ky këshill. Mes 3.000 e 5.000 studentë marshuan nëpër qendër të Prishtinës. Ata u ndalën para ndërtesës së qeverisë ku folës të ndryshëm «luftuan» për vëmendjen e tyre. Zenel Kelmendi, rektor i universitetit, duket se pa këtu rastin që të forcojë kredencialet e tij nacionaliste. Këtu foli edhe Morina. Që të dy këta herë ngritnin emocionet herë qetësonin emocionet e turmës. Kah ora 5 pasdite, studentët marshuan drejtë selisë së UNMIK-ut duke brohoritur «UÇK, UÇK». Me të rënë muzgu, ata u nisën kah pjesa jugore e qytetit. Morina tregon se kur kanë arritur «Te rrethi», është habitur kur ka parë se nuk ka kurfarë pengesave të vëna nga forcat e sigurisë por vetëm vetura të djegura të policisë. Turma vazhdoi përjetë kodrës, ndërsa agjitorët dhe vrulli i saj e bënë atë gjithnjë e më agresive, sa më shumë që i afrohej Çagllavicës.

¹⁴⁷ Intervistë e ICG-së me burime në CIVPOL dhe UNMIK.

¹⁴⁸ Intervista të ICG-së me dëshmitarë; xhirime televizive; fotografi, burime nga policia.

¹⁴⁹ Intervistë e ICG-së me një dëshmitar, 20 mars 2004.

Burimet e KFOR-it e përshkruajnë ditën e parë në Çagllavicë si «betejë mesjetare» - përleshje fyt për fyt që nga pasditja e deri në mbrëmje vonë. Çagllavica u bë fushbetejë e këmbëngulësisë së turmës dhe forcave të sigurisë.

Në pasditen e hershme, turma e parë u pengua nga policia që ta arrijë turmën serbe në Çagllavicë. Shqiptarët u futën rrugëve anësore. Pak prej tyre ishin të armatosur por u «armatosën» rrugës me tulla e gurë. Përleshjet e para me serbët u bënë në anën e djathtë të rrugës kryesore, pjesë më e vogël e Çagllavicës. Këtu shqiptarët ua vënë zjarrin shtëpive. Vija e policisë në rrugën kryesore luftonte të ndalte turmën që të depëronte në pjesën më të madhe të fshatit, atë lindore. Të shtënat vinin nga të dyja palët, serbët e shqiptarët. Ndër turmën shqiptarë hynë agitatorët që e nxisnin të vazhdojë të sulmojë ndërsa u shfaqen më shumë armë.¹⁵⁰ Pasuan përleshje fyt për fyt me policinë dhe KFOR-in që mundoheshin ta mbanin vinë me çdo kusht, duke shfrytëzuar topa uji, gaz lotësjiellës dhe granata tronditëse derisa vet po sulmoheshin me shkopinj, gurë, koktejë molotovi e nganjëherë edhe nga zjarri i armëve të kalibrit të vogël. KFOR-i ka vrarë një shqiptar që provoi të çante me kamion vijën e tyre.

Kur po ngrysej, u duk se forcat e sigurisë po ia dilnin të shtyenin prapa turmën. Por, rreth orës 6 pasdite, andej po vinin studentët duke djegur veturat derisa marshonin përgjatë rrugës. Ata u përleshën me vijën mbrojtëse të CIVPOL-it dhe SHPK-së që mundoheshin të mbante pozitën e vet një kilometër larg Çagllavicës, afër udhëkryqit ku nis rruga që shpie në lindje drejt Ajvalisë dhe enklavës serbe më të madhe, Graçanicës. Policia u mund dhe u tërhoq në rrugën për në Ajvali/Graçanicë. Kërkonin përforcime, por përforcime nuk kishte më. Këta dhe dy autobllinda të KFOR-it që ruanin fillimin e rrugës u tërhoqën në bazën ushtarake suedeze (ishin larguar edhe trupat sllovaqe që bënë roje pak më lartë në rrugë), duke lënë kështu të hapur rrugën për në Graçanicë.¹⁵¹ Për fat të mirë, turma nuk provoi të nisej kësaj rruge. Marinsat amerikanë mbanin vijën në jug të Çagllavicës. Me të rënë nata, përleshjet u intensifikuan. Turma ia vuri zjarrin një autobllinde suedeze. Por, vija e forcave të sigurisë u mbajt

ndërsa turma nuk ia doli të depërtojë në pjesën lindore të Çagllavicës.

Turmat që u kthyen në Prishtinë atë mbrëmje vazhduan tërbimin në lagjet jugore të qytetit, duke ua vënë zjarrin veturave të OKB-së dhe duke sulmuar kompleksin e ndërtesave të «YU Projektit»¹⁵² në lagjen Ulpiana ku jetojnë shumë serbë që punojnë për UNMIK-un. Elemente brenda turmës e drejtuan turmën në këtë vend, ndërsa shqiptarë nga banesat fqinje raportohet të kenë nxitur turmën të sulmojë banorët serbë. Një grup më i regjur (ndoshta nga jashtë Prishtinës, ndoshta nga Kosova perendimore) sulmoi kompleksin e banesave. Veturat në parkingun aty përpara u dogjën zjarr. Së paku një banor serb është vrarë ndërsa një tjetër është therur shtatë herë me thikë por ka shpëtuar. Policia dhe KFOR-i që mundoheshin t'i shpëtonin banorët janë zbrapsur tri herë të sulmuar me gurë, koktejë molotovi por edhe me zjarr nga snajperët nga snajperistë të fshehur. Ishte policia kosovare që ia doli të depërtojë në tentimin e katërt, nxorri nga atje banorët që po «ecnin zvarrë për shkak të tymit që ishte çdokund»¹⁵³ e të cilët u larguan me autobllindat e KFOR-it derisa turma i gjuante me çdo gjë dhe bllokonte rrugët me kontenjerët e hedhurinave.¹⁵⁴

Në pjesët tjera të Kosovës

Pas shpërthimeve të para në Mitrovicë dhe Çagllavicë, demonstratat kapluan gati të gjitha qendrat urbane, shumica prej tyre duke eskaluar në dhunë. Pasdite vinin lajme për sulme në Pejë/Peçë, Prizren, Lilpjan/Lipjane, Fushë-Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Novobërdë/Novobërdo, Vushtrri/Vučitrn dhe lokacione tjera.¹⁵⁵

Në **Prizren**, njerëz «të panjohur» u kanë thënë qytetarëve që të mbyllin dyqanet. Rreth orës 3 pas dite, një turmë e madhe që mbledhur në sheshin e qytetit «Shadërvani». Në fillim, turma nuk e kishte të qartë se çfarë dëshironte të bënte duke marshuar

¹⁵⁰ Intervistë e ICG-së me banorë.

¹⁵¹ Vëzhgime të drejtë për drejta të hulumtuesve të ICG-së, duke parë Çagllavicën nga kodra në Veternik dhe në rrugë për në Ajvali.

¹⁵² Një nga shumë komplekse banesore kontraverse të ndërtuara nëpër Kosovë gjatë të nëntëdhjetave për të strehuar refugjatët serbë nga Kroacia dhe Bosna.

¹⁵³ Intervistë e ICG-së me burime policore dhe burime tjera.

¹⁵⁴ ICG-ja ka parë vet një autobllindë që largohet me shpejtësi duke tërhequr një kontenjer mbeturinash të ngujuar mes rrotëve, duke u fërkuar në asfalt e duke hedhur xixa.

¹⁵⁵ Që nga 17-19 marsi 2004, ICG-ja ka bërë disa udhëtime nëpër Kosovë dhe ka mbledhur informata nga dëshmitarë, zyrtarë, gazetarë dhe raporte të mediave të vendit dhe ndërkombëtare. Prandaj, përshkrimi i ngjarjeve këtu nuk është detyrimisht i plotë.

nëpër qytet (dhe duke gjuajtur gurë në ndërtesën e UNMIK-ut e duke ua vënë zjarrin veturave të UNMIK-ut kur kishin kaluar pranë tyre),¹⁵⁶ por më pas turma filloi të sulmojë dhe t'ua vëj zjarrin seminarit të vjetër ortodoks, kishave dhe manastireve në qendër të qytetit si dhe në periferi, duke rrethuar e duke izoluar trupat gjermane që i ruanin këto objekte. Janë djegur edhe shtëpitë e komunitetit edhe ashtu të reduktuar serb (disa serbë të moshuar janë rrahur, një ka vdekur në zjarrin në ndërtesën e seminarit ortodoks), por kanë pësuar edhe shtëpi shqiptare. Zjarrfikësit ose refuzuan që të reagojnë ose qenë penguar të bëjnë këtë nga ana e turmës që mbyllte rrugët, gjë që i kishte penguar edhe përforcimet gjermane që t'i arrijnë detashmentet e tyre të ngjuara nëpër qytet. Turmën u mundua ta shpërndajë me gaz lotësjellës njësia speciale argentiniane.¹⁵⁷ Megjithatë, tërbimi vazhdoi deri natën vonë, deri në mesnatë. Turma i ka vënë zjarrin edhe Manastirit «Sveti Arhangel» në grykën e Lumbardhit/Bistrica, duke detyruar trupat gjermane që e ruanin këtë vend dhe murgjërit që të ikin me autobllinda nëpër shtratin e lumit.¹⁵⁸ Pasi në bodrumin e manastirit turma kishte gjetur thasë me eshtra të njerëzve, një televizion lokal në Prizren shfaqti një intervistë me një zyrtar lokal nga drejtorati për mbrojtjen e monumenteve kulturore e historike i cili tha se këto ishin mbetje të shqiptarëve të vrarë nga serbët në vitet 1998-1999. U desh të pritej deri ditën tjetër që të hedhet poshtë kjo, kur historiani- arkeologu vendas, Muhamet Shukriu, u paraqiti në televizion duke treguar një libër të tij të botuar në vitin 1992 e ku ai përmend edhe eshtrat shumë të vjetër të gjetur në atë vend.¹⁵⁹

¹⁵⁶ Duket se caqet janë zgjedhur në mënyrë shumë selektive. Një gazetar gjerman i ka thënë ICG-së se ka parë një veturë të UNMIK-ut të bërë shkumb ndërsa një veturë e UNHCR-së pranë nuk ishte prekur.

¹⁵⁷ Sipas disa raporteve, u ishin mbaruar furnizimet me gaz lotësjellës. Turma besonte se trupat gjermane nuk përdornin gazin lotësjellës për shkak se ushtria gjermane nuk përdor gazra që nga koha e Holokaustit.

¹⁵⁸ Intervistë me ushtarin gjerman, "Mark Schneider" (emri i ndëruar për të ruajtur identitetin e tij) në "Rekonstruktion einer Niederlage", nga Joachim Kaepfner, op. cit.

¹⁵⁹ Intervistë e ICG-së me gazetarin Bashkim Susuri, më 28 mars. Derisa lajmi i dhënë mbrëmjen e 17 marsit 2004 ka shtuar mllëfin e disave në Prizren, të tjerëve kjo ua përkujtoi një mit tjetër të vonë i lidhur me eshtrat, që i bëri ata skeptikë. Rreth tri vite më parë janë gjetur eshtra në Hamamin e qytetit gjë që nxiti spekulime dhe mite edhe për origjinën e tyre, se janë nga lufta e viteve 1998-1999, edhe për prezencën e

Në **Gjakovë/Djakovica**, studentët e Fakultetit të Edukimit përbënin bërthamën e turmës prej disa qindra protestuesve që u mblodh pasdite. Rreth orës 5 sulmuan një oficer të CIVPOL-it (që u desh të hospitalizohet) dhe dogjën veturën e tij. Në mbrëmje turma sulmoi kishën ortodokse që kishte shpëtuar pa u djegur në vitin 1999. Trupat italiane të KFOR-it kanë hapur zjarr që t'i mbrojnë kishën dhe katër gra të moshuara, serbe, që jetonin aty. Nëntë pjesëmarrës në trazira janë plagosur. KFOR-i u largua së bashku me serbët, pas së cilës turma shkatërroi dhe dogji kishën.

Në qytetin e **Pejës/Peć**, në perendim të Kosovës, demonstrat filluan kah mesdita, kur disa njerëz ishin grumbulluar në qendër të qytetit. Një megafon është shfrytëzuar për t'i ftuar të tjerët t'i bashkohen demonstratës. Turma që në fillim nuk kishte më shumë se 100 njerëz u shtua në disa mijëra. Kjo lëvizje drejt ndërtesës së UNMIK-ut dhe ndërtesës së Komunës për të vazhduar dhe për të sulmuar fshatin Bellopojë/Belo Polje. Trupat italiane kanë evakuuar banorët për në bazën ushtarake aty pranë ndërsa një nga turma është qëlluar për vdekje nga një oficer i policisë së UNMIK-ut. Në vet qytetin e Pejës/Peć, një pjesë tjetër e turmës ka sulmuar veturat dhe ndërtesën e UNMIK-ut. Një valë tjetër e sulmeve kundër UNMIK-ut ka shpërthyer pas lajmeve të mbrëmjes; kur panë se UNMIK-u po sulmohej edhe tjetërkund në Kosovë, shumë njerëz vendosën të shfrytëzojnë këtë «të drejtë».¹⁶⁰

Një sjellje më e vrullshme po edhe më e menduar është parë në **Fushë-Kosovë/Kosovo Polje**, në perendim të Prishtinës. Në mesditë, atje gjendja dukej e qetë, pa shenja të zhvillimeve të jashtëzakonshme. Por, rreth orës 3 pasdite, aty u ndalën autobusë dhe furgonë e vetura tjera nga të cilat dolën shqiptarë që filluan të sulmojnë, duke ditur mirë ku po sulmojnë, ndërtesat që ishin bastione të strukturave paralele të mbështetura nga Beogradi: shtëpinë e shëndetit, ndërtesën e Administratës afër saj, ndërtesën e postës dhe telekomunikacionit¹⁶¹ dhe shkollën. Raportohet të jetë parë një njësi e SHPK-së duke qëndruar anash kur sulmet kanë filluar. Janë

këpuardhve helumuese që rriten në eshtra. Hulumtimet e bëra në Gjermani i hodhën poshtë që të dy këto mite.

¹⁶⁰ Intervistë e ICG-së me gazetare.

¹⁶¹ Në ndërtesë është lënë një flamur shqiptar. Javorja në gjuhën shqipe, "Java" më vonë botoi në ballinë fotografinë e një ushtari irlandez që hedhte në tokë flamurin. Gazetat tjera shqipe - veçanërisht *Epoka e Re* - e kanë ribotuar disa herë që nga atëherë.

djegur edhe shtëpi të serbëve. Dëshmitarët tregojnë për vetura tjera që ktheheshin, pasi kishin kaluar njëherë, për të marrë pjesë në sulme. Serbët në këtë vendbanim qenë kapur në befasi.¹⁶²

Në **Ferizaj/Uroševac**, degët lokale të KMDLNJ-së, tri «asociacioneve të dala nga lufta» dhe Shoqata e të burgosurve politikë kishin thirrur për pasdite një protestë kundër mbytyjes së fëmijëve. Deri në orën 6 pasdite, kur zyrtarisht u mbyll, protesta ishte paqesore. Por, turma pas kësaj u bë e dhunshme dhe u nis kah kisha ortodokse në qendër të qytetit, që ruhej nga ushtarë grekë të KFOR-it. Ushtarët u sulmuan me gurë njëherë e mandej edhe me mjete shpërthyes. Për tri apo katër orë, qindra shqiptarë kanë mbajtur të rrethuar detashmentin grek, duke i gjuajtur me tulla, gurë, koktejtë molotovi e granata. Shtatëmbëdhjetë ushtarë janë plagosur, njëri me djegie të shkallës së dytë në fytyrë e qafë. Ushtarët grekë u përmbajtën nga të shtënat. Disa personalitete të njohura në këtë vend, përfshirë Shukri Bujën, ish-komandant rajonal në TMK, apelan për qetësi por pa ndonjë rezultat. Mes orës 9 e 10 kanë arritur në vend përforcime amerikane të cilët filluan të bëjnë evakuimin e trupave greke, por duke përjetuar sulme edhe më të furishme me armë zjarri e koktejtë molotovi gjatë këtij procesi. U desh të intervenohej edhe me helikopterë që hedhnin gaz lotësjes për të bindur turmën që të shpërndahej dhe të reduktohej nga më shumë se 1.000 në rreth 150. Pas orës 22:00 u shpall ora policore dhe policia ushtarake e trupave amerikane dhe njësitë e SHPK-së siguruan kishën.¹⁶³

Në **Lipjan/Lipjane**, shtatëmbëdhjetë kilometra në jug të kryeqytetit, turma ishte nxitur nga lajmet konfuze që vinin nga Mitrovica dhe ishte mbledhur në qendër të qytetit rreth orës 3. Njëherë kishte provuar që të lëvizë drejtë fshatit serb Suhadoll/Suvi Do, por ishin penguar nga trupat e KFOR-it. Rreth orës 6 pasdite, turma është kthyer në qytet dhe ka sulmuar shtëpitë serbe në lagjen e përzier, Bestin. Forcat e sigurisë i kishin evakuuar serbët në lagjen serbe Kisha dhe e kishte siguruar me tela me gjemba. Gjatë natës, turma ka bërë shkatërrime në lagjen Bestin, me intervenim të paktë të forcave të sigurisë. Dikur më vonë në mbrëmje kanë filluar të dëgjohen të shtëna, së paku trembëdhjetë shtëpi

serbe janë djegur dhe së paku një serb e sipas të gjitha gjasave dy shqiptarë janë vranë. Me dhjetëra janë plagosur. Nga Ferizaji në Lipjan kishte ardhur Shukri Buja, që është parë në turmë. Mbetet e paqartë nëse ai provonte të qetësonte turmën apo ta nxiste atë. Ai është arrestuar më vonë nga KFOR-i.

Në **Gjilan/Gnjilane**, demonstratat filluan rreth orës 3 pasdite, pasi një grup i të rinjve shqiptarë ishte mbledhur në një udhëkryq për të bllokuar rrugën që shpie për në dy fshatra serbe. Demonstruesit u nisën drejt rrugës ku jetojnë serbët dhe ku gjendet edhe kisha ortodokse. Mësohet se këtu disa banorë shqiptarë i kanë strehuar fqinjët e tyre serb dhe se ka pasur përleshje edhe mes turmës dhe vet banorëve shqiptarë. Një serb 52 vjeçar është zënë dhe mbytur nga turma jashtë shtëpisë së tij. Trupat amerikane kanë intervenuar dhe kanë shtyer turmën drejtë qendrës së qytetit. Thuhet se në një çast ka ardhur në qendër të qytetit një njeri me një traktor përplot me gurë. Turma ka sulmuar ndërtesën e UNMIK-ut, duke gjuajtur gurë dhe duke djegur veturat e serbëve.¹⁶⁴ Trazirat kanë zgjatur deri kah ora 7 e mbrëmjes. Janë djegur disa shtëpi. Banorët e Gjilanit kanë njohur në krye të trazirave të ardhurit nga Presheva, në jug të Serbisë, që kanë qenë të involvuarnë kryengritjen e viteve 2000 e 2001 në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit.¹⁶⁵ Dy javë më vonë janë bërë arrestime të figurave të dalluara të UÇPMB-së. Më 29 mars, si pjesë e operacioneve të drejtuara kundër krimit të organizuar në zonën e Gjilanit/Gnjilane, policia ka arrestuar Shaqir Shaqirin, që tani është zëvendës kryetar i degës së Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së. Më 1 prill, trupat amerikane kanë ndaluar Jonuz Musliun në shtëpinë e tij në Gjilan/Gnjilane. Musliu është kryesues i Lëvizjes për Progres Demokratik në Luginën e Preshevës.¹⁶⁶

Në **Novobërdë/Novo Bërdo**, janë hedhur mjete shpërthyes në ndërtesën e Kuvendit Komunal dhe në shtëpinë e kryetarit të Komunës, serb - që të dy këto në fshatin Bostan. Nuk janë raportuar incidente tjera.¹⁶⁷

¹⁶² Intervistë e ICG-së me një dëshmitar.

¹⁶³ Intervistë e ICG-së me gazetarin vendas, Afrim Demiri, dhe artikulli në shërbimin e lajmeve të Armatës amerikane, "Rioters Attack Allied Soldiers in Kosovo", (Turma sulmon ushtarët e aleancës në Kosovë), 23 mars 2004.

¹⁶⁴ Shumë serbë të Kosovës ende shfrytëzojnë tabelat e regjistrimit të Serbisë në vend të atyre të lëshuara nga UNMIK-u gjë që i dallon veturat e tyre.

¹⁶⁵ Intervista të ICG-së me banorë lokalë dhe kryetarin e komunës, Lutfi Haziri.

¹⁶⁶ Shih "Raportin e ICG-së për Evropë N°152, Paqja e brishtë në Serbinë Jugore", op. cit.

¹⁶⁷ Intervistë e ICG-së me një gazetar të vendit, 21 prill.

Në **Podujevë/Podujevo**, turma e grumbulluar është ftuar nga «shoqatat e luftës» që të nisët për në Mitrovicë. Kjo më vonë është penguar nga vet organizatorët e protestës.

Gjatë natës, në tërë Kosovën forcat e sigurisë ishin të shkapërderdhura, të stër-shtrira dhe të dërmuara. Shumë fshatra e enklava serbe kanë mbetur të pambrojtura. Qendra e Prishtinës i qe lënë turmës së të rinjëve të inatosur shqiptarë që kërkonin veturat e OKB-së për t'ua vënë zjarrin dhe duke i gjuajtur veturat e herë pas hershme të policisë apo autobлиндat që nxitonin pa ndaluar. Pas mesnatës, energjitë e turmave filluan të shterrojnë dhe rreth orës 2 të mëngjesit, rrugët u zbrazën.¹⁶⁸

DITA E DYTË - 18 MARS

Në mëngjesin e 18 marsit, histeria e një dite më parë kryesisht ishte zbutur. Shumica e «ushtarëve» në demonstratat që kishin degjeneruar në pogrom si duket u zgjuan duke kupuar se sa dëm i kishin bërë Kosovës, imazhit të komunitetit të tyre dhe të ardhmes. Agjitorët dhe grupet kriminale që ditën e parë patën turma të mëdha për t'i «përpunuar», tani në ditën e dytë kishin të bënë me më pak njerëz dhe me shumë më pak zemërim nga i cili do të përfitonin. Numri më i vogël i sulmeve të dhunshme veçohej me pjesëmarrje të adoleshentëve që kërkonin avantura dhe grupe më ekstremiste e më këmbëngulëse të njerëzve të armatosur. Caqet janë zgjedhur në mënyrë më sistematike, ekstensive dhe cinike, ndërsa shkatërrimet ishin shumë më të mëdha. Shumica e qindra shtëpive të djegur gjatë dhunës janë djegur më 18 mars. Disa qytete, ku në ditën e parë ka pasur pak ose aspak dhunë, në ditën e dytë përjetuan pastrim etnik të shkallës së gjërë.

Brigada Shumëkombëshe Qendër

Dita filloi qetë, por që në mesditë, **Çagllavica** u shëndrua përsëri në pikë provuese për turmën. KFOR-i këtë herë ishte më mirë i përgatitur, kishte bllokuar rrugën me kordon të fortë përgjatë rrugës në majë të kodrës në të dalë të Prishtinës, të përforcuar me tela me gjemba përpara dhe mbrapa me trupa e autobлиндat, por tani edhe me rregulla më robuste të reagimit. Në Prishtinë, shumë mësimdhënës nuk janë paraqitur në vendet e tyre të punës në shkollat e Prishtinës, duke i lënë kështu nxënësit pa mbikqyrje dhe shumë nga këta shkuan lartë në kodër. Studentët

nga konviktet marshuan përsëri duke i rënë qark Prishtinës e duke u ndalur para Teatrit Kombëtar për të dëgjuar fjalimet e, ndër të tjerë, liderit të Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Faik Fazliu, dhe bijës së Adem Jasharit, Shqipës. Pasditja solli një përzierje konfuzie të nxënësve që e trajtonin këtë si një ditë jashtë shkollës; KFOR-it që shtiente me gaz lotësjiellës për të zbrapsur turmën dhe ekstremistët që shtenin në trupa apo që, siç dëgjohet, nuk i lejonin demonstratorët që nuk kishin armë që të vazhdonin përpjetë kodrës në Çagllavicë. Personeli mjekësor nga spitali ishte aty në kodër për t'u ofruar ndihmë atyre që prekeshin nga gazi lotësjiellës, e që në të vërtetë i vuri në pozitë të mjekëve të turmës. Dëshmitarët kanë folur edhe për njerëz të armatosur me emblema të AKSH-së dhe për auto-ambulanca që arrinin të mbushura me armë për turmën. KFOR-i ka qëlluar katër shqiptarë.

Me të ardhur nata, turma, tani më militante dhe më e armatosur, në Veternik po vazhdonte të testonte KFOR-in me të cilin ishte përleshur gjatë tërë ditës. Në Prishtinë, në mbledhjen urgjente të Qeverisë, kryeministri Bajram Rexhepi vendosi që të shkojë atje dhe të apelojë për qetësi. I shoqëruar nga ministrat Jakup Krasniqi, Ethem Çeku dhe Behxhet Brajshori, ai shkoi në kodër dhe u fut në turmë. Pas dy minutave, përleshjet u ndërprehen.

Disa nga turma më pas u larguan nga Veterniku dhe u kthyen në **Prishtinë** dhe zgjedhën kishën ortodokse për cak të tyre të ardhshëm. Shumica e këtyre duket të kenë qenë adoleshentë. Kontingjente të vogla të SHPK-së luftuan t'i ndalin ata të përparojnë në rrugët e ngushta të pjesës së vjetër të kryeqytetit. Këtyre nuk u qe tërhequr vërejtja kur u hedh gazi lotësjiellës në turmën e të rinjëve dhe gazi la oficerët e SHPK-të të trallisur ndërsa pati efekt të kufizuar në turmën që u tërhoq kah qendra e Prishtinës. Burime nga KFOR-i thonë se disa oficerë të SHPK-së u vunë në anën e pjesëmarrësve në trazira. Në këtë konfuzion, në vendin e ngjarjes arriti një detashment i policisë speciale italiane, nga të cilët një polic u qëllua me plumb në këmbë, sipas të gjitha gjasave nga një oficer i SHPK-së, ndërsa në të njëjtën kohë, një polic tjetër i SHPK-së është qëlluar gabimisht tri herë nga një koleg italian. Kur njësi italiane arriti në vend, turma e adoleshentëve u shpërnda. Megjithatë, forcat e sigurisë vetëm evakuuan priftin dhe u larguan, duke lejuar që turma të kthehet përsëri, e papenguar, në përpjekjet e tyre të ardhshme dhe më në fund të suksesshme që t'ia vëjnë zjarrin kishës dhe shtëpisë së priftit.

¹⁶⁸ Observime të hulumtuesve të ICG-së dhe IWPR-së.

Obiliqi, disa kilometra në perendim të Prishtinës, që sikur edhe Fushë - Kosova/Kosovo Polje, ka pakicë të dukshme serbe, rome dhe ashkali, në ditën e parë ishte kursyer nga dhuna. Por, nga mesdita e 18 marsit, turma po sulmonte, digte dhe po plaçkiste shtëpitë e serbëve. Forcat e sigurisë nuk shiheshin askund. Një njësit prej 20 apo 30 policëve të SHPK-së vërtitej pa krye afër vendeve ku ndodhnin trazirat. Thuhet se ia kanë dalur që t'i shpëtojnë disa serbë, por arrestimet e vetme që i kanë bërë janë të një apo dy serbëve që janë gjetur me armë me të cilat po mbroheshin. Barrën e djegieve dhe plaçkitjeve e mbante një bandë agresive e adoleshetëve dhe fëmijëve që poashtu penguan zjarrëfikësit që të arrijnë në vendin e ngjarjes. Shtëpitë e apartamentet serbe kërkoheshin në çdo anë të qytetit. Në fund të ditës, në zjarr ishin 90 shtëpi, 40 apartamente dhe 30 anekse.

Në **Lipjan**, dita ishte e qetë, por rreth orës 6 të mbrëmjes u sulmua përsëri lagja Bestin. Sikur edhe në Obiliqi, turma identifikoi shtëpitë serbe dhe dogji sa ma shumë që mundi prej tyre. Në mbrëmje janë dëgjuar shërthime të fuqishme, një edhe afër Kuvendit Komunal.

Në **Fushë - Kosovë/Kosovo Polje**, u përhapën thashethëmet se rreth orës 4 në qytet do të arrinin banda njerëzish. Turma u shfaq dhe filloi të sulmojë shtëpitë e serbëve, romëve e ashkalinjëve duke shkatërruar më shumë se 100.

Organizatorët e demonstratave në **Podujevë**, në ditën e dytë, ishin më anonimë se sa në ditën e parë. Në udhëkryqet e qytetit dhe në shkolla ishin shpërndarë pamflete. Në mesditë turma u mbledh dhe vendosi të ecë 6 kilometra deri në Merdare, në kufirin me Serbinë. Pjesëtarë të shoqatave të luftës dhe oficerë të SHPK-së u munduan të bindin turmën që të heqë dorë nga kjo dhe t'i bindë se ky është hap tepër provokativ dhe i rrezikshëm. Turma pastaj e shfryu mllëfin e saj në kishën ortodokse në Podujevë. Detashmenti i trupave çeke e sllovaqe që e ruanin atë u urdhërua që të tërhiqet kur turma prej 500 njerëzve çau murin e jashtëm. Pasi hyri në kishë, turma shkatërroi çdo gjë dhe ua vuri zjarrin gjërave të hedhura para portës së kishës, duke djegur edhe qendrën për komunikime të ushtarëve të KFOR-it. Në varreza i thyen gurët e varrezve ndërsa e hapën varrin dhe nxorën eshtrat e një serbi vendas të vrarë në luftën e viteve 1998-9, i njohur si pjesëtar i sigurimit shtetëror serb. Disi, turma ia kishte dalur të tërheqë këmbanën e rëndë 1.200 kilogramë, që thuhet

se besohej se do të mund të shitej mu 32.000 euro. Më vonë këmbana është gjetur në një shtëpi afër. Tymi që dilte nga kisha që digjej thuhet se është parë edhe nga pjesa serbe e kufirit në Merdare.¹⁶⁹

Brigada Shumëkombëshe Lindje

Në **Ferizaj/Uroševac**, rreth mesditës filloi të grumbullohej turma afër kishës «Shën Uroshi», që tani ruhej nga trupat amerikane. Paqeruajtësit amerikanë sollën komandantin rajonal të TMK-së, Imri Ilazi, dhe pjesëtarë tjerë të TMK-së për t'i folur turmës, që pastaj u largua, por vetëm për të sulmuar dhe djegur shtëpinë në të cilën jetonin dy plaka serbe (që ishin evakuuar nga trupat greke). Në zjarr pësuan edhe disa shitore në pronësi të shqiptarëve. Më pas, turma ka përdhosur varrezat ortodokse dhe ka sulmuar komunitet serbe në tri fshatrat përreth, duke djegur atje kishat ortodokse.¹⁷⁰

Në **Gjilan/Gnjilane**, poashtu në zonën amerikane, TMK-ja u përdor por me më pak sukses. Demonstratat filluan në qendër të qytetit pak pas mesditës. Rreth orës 1, emra të dalluar, kryesisht me kredibilitet nga lufta e UÇK-së, iu drejtuan turmës - kryetari i popullarizuar i komunës, Lutfi Haziri¹⁷¹ së bashku me përfaqësues të degëve të PDK-së e AAK-së dhe përfaqësues të TMK-së - por këta u pritën me fishkëllima ndërsa turma vetëm sa u zemërua edhe më. SHPK-ja dhe KFOR-i intervenuan dhe e zbrapsën turmën përtej qendrës së qytetit, nëpër sheshin kryesor, drejt periferisë. Nga ora 4 është shfrytëzuar gazi lotësjellës ndërsa në orën 6 është vënë ora policore. Kisha ortodokse është shpëtuar dhe pastaj është ruajtur bashkarisht nga KFOR-it dhe TMK-ja.¹⁷²

Në jug, në komunën kryesisht serbe, **Shtërpç/Štrpce**, një turmë e shqiptarëve ka arritur në mbrëmje në të hyrë të fshatit Drejkoc. Këta kanë trokitur në shtëpinë

¹⁶⁹ Intervistë e ICG-së me një gazetar të vendit, më 21 prill, dhe artikulli "Czechs hold line in Kosovo" (Çekët mbajnë vijën e frontit në Kosovë), nga Eva Munk, në "The Prague Post", 25 mars 2004.

¹⁷⁰ Intervistë e ICG-së me gazetarin Afrim Demiri, raportet televizive.

¹⁷¹ Haziri mendohet të ketë kredenciale me të mira nga lufta se sa kolegët e tij anëtarë të LDK-së së Rugovës, pasi ai qe burgosur nga serbët gjatë konfliktit në vitin 1999.

¹⁷² Intervistë e ICG-së me banorë, Lutfi Hazirin dhe burime policore.

e parë serbe dhe kanë shtënë duke vrarë babë e djalë, e pastaj janë tërhequr.¹⁷³

Brigada Shumëkombëshe Jug-Perendim

Në Kosovën perendimore, demonstratat lëkundeshin mes të mbeturit paqesore dhe zhytjes së sërishme në dhunë. Një turmë jo e vogël është grumbulluar në **Deçan/Dečani** por qe bindur që të mos marshojë tek manastiri historik nga ana e kryetarit të komunës, Ibrahim Selmanaj, dhe kryetari i degës lokale të Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së, Abdyl Mukshkolaj (i cili është arrestuar më 10 prill nga UNMIK-ut për siç u tha, rolin e tij në ditën e parë) e pastaj edhe nga adresimi me anë të telefonit nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, që foli nga Prishtina. Në **Pejë/Peć**, kryetari i komunës, nga LDK-ja, Ali Lajçi, u vua në krye të turmës që po grumbullohej e që përsëri shkoi në Bellopojë/Belo Polje, ku Lajçi dhe të tjerët vënë lule në vendin ku polici i UNMIK-ut kishte vrarë njërin nga turma (që po sulmonte serbët) një ditë më parë.

Në **Prizren** vazhdoi dhuna në shkallë të lartë. Studentët e Edukimit thuhet se kishin ndjekur shembullin e kolegëve të tyre në Prishtinë dhe tani përbënin bërthamën e turmës që bëri hata nëpër rrugë, duke demoluar dyqanet që i gjenin të hapura. Dy stacionet e policisë janë gjuajtur me gurë ndërsa janë djegur vetura të policisë dhe UNMIK-ut. Ndoshta si reflektim i konfliktit disa vjeçar mes autoriteteve komunale të kontrolluara nga LDK-ja (asnjë nga këta nuk ka dalur t'i flasë turmës) dhe shoqatat e UÇK-së rreth çështjes së disa statujave, u sulmua edhe ndërtesa e Komunës - e qëlluar me gurë, Koktejë Molotovi dhe armë zjarri. Në një çast, sulmuesit ia dolën të hyjnë edhe brenda në ndërtesë dhe të provojnë t'ia vëjnë zjarrin. Në rrugë shihej prezencë e KFOR-it dhe SHPK-së por policia e UNMIK-ut kishte vendosur të mos shihej në rrugë. Më vonë atë ditë në rrugë janë sjellur pjesëtarët e TMK-së për t'i folur dhe qetësuar turmën. Duket se kjo pat efekt dhe kah mbrëmja turma u shpërnda.

Brigada Shumëkombëshe Veri-Lindje

Në **Mitrovicë**, forcat e sigurisë penguan grupet e vogla të demonstruesve që të arrijnë në qendër të qytetit, duke i ndjekur me gaz lotësjellës. Pat përlëshje të vogla gjatë ditës e deri në mbrëmje: hedhje me gurë në veturat e OKB-së dhe të UNMIK-ut si dhe disa shpërthime. Zjarri snajperist kundër KFOR-it dhe serbëve në veri të Mitrovicës shkaktoi viktima. KFOR-i identifikoi disa nga këta në «Tre Soliterat» dhe shtiu në një apartament ku dyshohej se ishte një, duke vrarë një shqiptar. Një grup shqiptarësh bërthamën e të cilëve e përbënin të ardhurit nga Gjakova apo Drenica sulmuan kishën ortodokse në pjesën jugore të Mitrovicës. Vetëm disa ditë më herët, trupat franceze të KFOR-it kishin zvogëluar mbrojtjen e kësaj kishe, duke lënë aty për të bërë roje një grusht ushtarësh marokienë që nuk ishin në gjendje të pengojnë dëmtimin. Nuk ndihmoi as pozita e kishës ngjitur me bazën e KFOR-it, me të cilën e ndanë vetëm një mur.¹⁷⁴

Pasdite, elementë të turmës së njëjtë që sulmuan kishën ortodokse u sulën në fshatin **Frashër/Svinjare**, rreth 600 metra afër kampit «Belvedere», bazës kryesore logjistike të trupave franceze. Disa vetura të policisë së UNMIK-ut provuan të nxitojnë të arrijnë para turmës dhe ta pengojnë përparimin e saj, siç bëri edhe një kamion me ushtarë marokienë që po ruanin hyrjen veriore të fshatit, afër bazës. Turma i vuri zjarrin disa shtëpive në pjesën veriore të fshatit para se postblloku me policë e ushtarë nuk e ndali përparimin e saj. Këta u tërhoqën ndërsa në vend arritën përforcime të forcave të sigurisë: njëzet ushtarë tjerë dhe 50 trupa të njësisë speciale polake. Por, në vend se të konsolidonin pozitat e tyre, këta u urdhëruan që të evakujnë fshatarët në bazën ushtarake dhe të tërhiqen. Gjatë mbrëmjes turma shqiptare u kthye e papenguar dhe plaçkiti e dogji çdo shtëpi dhe objekt tjetër serb në fshat.¹⁷⁵

Më tutje në jug, në **Vushtri/Vučitrn**, dy turma sulmuan dhe lanë të shkretë lagjen e ashkalinjve. Turma, ndër të cilët kishte edhe veteranë të UÇK-së, sulmoi dhe dogji kishën ortodokse nga e cila ishin

¹⁷³ Intervistë e ICG-së me banorë të Shtërpces.

¹⁷⁴ Intervistë e ICG-së me burime nga SHPK-ja, UNMIK-u dhe CIVPOL-i.

¹⁷⁵ Intervistë e ICG-së me zyrtarë të UNMIK-ut; Nicholas Wood, "Kosovo Smoulders After Mob Violence" (Kosova në tym pas dhunës së turmës), "The New York Times", 24 mars 2004.

larguar trupat marokene që po e ruanin. Turma përdhosi varrezat madje edhe duke hapur varre e duke nxjerr eshtrat e të vdekurve, ndërsa më pas kjo turmë iu bashkua turmës tjetër, që udhëheqej nga kriminelë lokalë, që po sulmonte, plaçkiste dhe digjte shtëpitë e ashkalinjve. Oficerët e SHPK-së tregojnë se kanë evakuuar një kasap ashkali që po shtiente me armë në turmë si dhe familjen e tij. Përfaqësuesit e ashkalinjve më vonë kanë thënë se SHPK-ja i ka arrestuara ata duke i ndihmuar kështu turmës. Më pas atë pasdite, komandanti lokal i policisë së OKB-së ka dërguar SHPK-në që të evakujë të gjithë ashkalinjt (më shumë se 200) në shkollën policore. Më shumë se 70 shtëpi të ashkalinjve janë djegur.¹⁷⁶

Në jug-perendim të Mitrovicës, në Drenicë, është djegur manastiri mesjetar i Deviçit. Kur nxënësit e ndërrimit të parë të shkollës së mesme në **Skenderaj/Srbica** përfunduan mësimin ndërsa ndërrimi i dytë bëhej gati për mësim, aty kah mesdita,¹⁷⁷ këta bënë një turmë të madhe që filloi të lëvizë në perendim, jashtë qytetit. Mësohet se mësimdhënësit e tyre, zyrtarë të komunës, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe gazetarë kanë provuar që t'i bindin që të kthehen, por këta janë anashkaluar. Pak para se të arrinin, KFOR-i ka evakuuar të gjitha murgeshat, përveç njëres, dhe është larguar. Të rinjt që plaçkitën dhe dogjën manastirin, e mbajtën murgeshën derisa nuk erdh dikush me kamerë që të inçizojë gjestin e tyre «humanitar» të dorëzimit të saj policisë.

19 MARS

Gjatë natës arriti një batalion i ushtarëve britanikë dhe në mëngjes këta po patrullonin rrugën e Prishtinës nga të cilat ishin larguar një ditë më parë trupat suedeze të KFOR-it. Dyqanet u hapën ndërsa dukej se Prishtina po i kthehej normalitetit.

Përpjekjet e agjitorëve në disa vende në Kosovë që të nisin trazira nuk patën sukses. Organizatat, pjesëtarët e të cilave u dalluan në trazira - UPSUP-i dhe tri «shoqatat e dala nga lufta» (të veteranëve,

invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve të UÇK-së) - lajmëruan ndërprejen e «protestave» dhe shpallën lista të kërkesve, duke kërcënuar me «protesta» tjera nëse këto nuk përmbusheshin brenda tetë ditëve. Ndër kërkesat ishin edhe transferimi i plotë i kompetencave qeverisëse tek IPVQ-ja, lirimi i të gjithë luftëtarëve të UÇK-së nga burgjet (pa marrë parasyshë për çfarë krimi janë dënuar) dhe «heqja» e enklavave serbe.

Konfrontimi më i dalluar më 19 mars ishte mes trupave franceze dhe policisë, në Mitrovicë, që është shpjeguar më lartë.

¹⁷⁶ Qenda për të drejtat e romëve në Evropë, "Ethnic Cleansing of 'Gypsies' in Kosovo" ("Pastrimi etnik i "magjupëve" në Kosovë"), 24 mars 2004; Intervistë e ICG-së me burime nga SHPK-ja, dy hulumtues vendorë.

¹⁷⁷ Shumica e shkollave të stërngarkuara në Kosovë duhet të punojnë me ndërrime që të mund të punojnë me numër aq të madh të fëmijëve. Varësisht nga ky numër, shkollat punojnë me dy, tri apo madje edhe katër ndërrime ndërsa disa nxënës bëjnë jo më shumë se tri orë mësimi në ditë.

ANEKSI B

HARTA E KOSOVËS

Kosova / Kosovo

Produced by




The boundaries and names displayed on this map do not imply official recognition by the United Nations